ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues · Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 19 KORRIK 2025 · NUMËR 344 · VITI VIII I BOTIMIT · ÇMIMI 50 LEKË · WWW.EXLIBRIS.AL · EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL · BOTIM I ONUFRI SHPK

Një pasdite të nxehtë të këtij fillim korriku 2025, mbërrita në hyrje të katedrales së Santa Maria Maggiore-s të qytetit të Trevizos. Brenda saj në heshtjen e paqtë pashë vetëm tre-katër besimtarë të moshuar të ulur në ndenjëset e drunjta, të cilët i përcillnin në heshtje lutjet e tyre hyjnores... Pa i shqetësuar, fillova të kërkoj, duke filluar nga fundi i sallës së madhe, në faqet e mureve, në pikturat mesjetare murale, në kthinat e asaj godine të hershme, gjurmët e emrit të Mërkur Buas.

Si e gjeta Mërkur Buan në një basoreliev në Katedralen e Trevizos, në Itali

Nga Irakli Koçollari

Shënim mbi romanin e Rita Petros "Lindur së prapthi"

Rrëfimi i fëmijës brenda vetes...

Nga Agron Tufa

"Sa më pëlqente kur shtriheshim mbi tapet dhe bënim ushtrime për elasticitetin e trupit. Momenti kur trajnerja na thoshte të pushonim, unë rrija shtrirë duke parë tavanin, i cili ishte në formën e një kubeje. Mbyllja sytë dhe më kujtohej ajo figurë si në ëndërr. Isha shumë e vogël kur më sillte gjyshja në kishë. Tërë kohën e mbaja kokën lart. Në kubenë e kishës ishte një burrë gjigant me krahë të hapur, me pëllëmbën e dorës së djathtë lart, sikur na përshëndeste. (fq. 4)

Një homazh për ndarjen nga jeta të Alma Radovicka-Zadesë, gruaja e jetës e kompozitorit Çesk Zadeja

Nga Vasil S. Tole (fq. 5)

SHËNIME MBI LIBRAT

Modernia dhe klasikja në poezinë e Kadaresë

NJË RILEXIM I VËLLIMIT POETIK "SHEKULLI IM"

Nga Sadik Bejko (fq. 6)

Një nga gazetat më të mëdha italiane, "Avvenire", shkruan për romanin "Në emër të nënës dhe të birit".

Në emër të nënës dhe të birit – Rrëfim i Besnik Mustafajt

Nga Gianni Santamaria (fq. 14)

85-vjetori i lindjes

Frederik Rreshpja, shkrimtari përtej melankolisë dhe trishtimit

Nga Jola Tasellari (fq. 11)

"NËNQYTETI"/ Pogradeci i rikujtuar nga mjeshtri Taso

Nga Ylli Drishti (fq. 8)

ARTI DHE IMITIMI I NATYRËS

(fq. 20)

Nga Prof. as. dr. Anton Papleka

Tetë arsye për të (ri)lexuar "Lehtësia e padurueshme e qenies" nga Milan Kundera

Nga Gloria Maria Ghioni (fq. 23)

Albert Kamy, një klasik i madh, njëkohësisht një artist modern

Nga Andre Morua (fq. 22)

Sollzhenicini japonez, si mbijetoi komunisti japonez në Gulag

Nga Oleg Jegorov

(fq. 17)

BIBLIOTEKË

Ballsor Hoxha (fq. 10)
Kjo galaktikë tensioni

Imri Demisai (fq. 12)
Një thirrje e largët
Me një shënim nga Resul Shabani

Artur Baku (fq. 13)
Zero absolute

Dhurata Hoti (fq. 14)
Befasia e ditëlindjes

Sadedin Mezuraj (fq. 15)
Triptik

Klara Kodra (fq. 15)
Fjala që s'u tha

Edgar Allan Poe (fq. 16)
Zemra rrëfyese
Përktheu: Noel Boci

Irwin Shaw (fq. 21)
Vajzat me fustane verore
Përktheu: Rudolf Marku

Arben Meksi (fq. 24)
Karikatura e së shtunës

Botim i ri nga "Trishtil"

Agnes Ravatn *Gjyqi i zogjve*

(fq. 18)

Përktheu nga origjinali në dialektin nynorsk të norvegjishtes: Aristidh Shqevi

Si e gjeta Mërkur Buan në një basoreliev në Katedralen e Trevizos, Itali

Nga Irakli Koçollari

Për Mërkur Buan pata shkruar herë të parë në vitin 1993, ndërsa kisha përfunduar librin "Arvanitët". Aso kohe nuk më kishte shkuar në mend se, vit pas viti, për këtë shqiptar të çuditshëm do të gjeja vazhdimisht e vazhdimisht material të shumtë, të pasur dhe mjaft interesant historik. Aq më pak, nuk do të imagjinoja se mbas 30 vitesh do të shkoja të gjeja memorialin dhe mjaft artefakte interesante të këtij burri të ngarkuar me plot bëma, ngjarje, legjenda dhe lavdi.

Sigurisht, për të kam gjetur materiale pafund të depozituara në Arkivat Veneciane, në ato Napolitane, në Vatikan, në arkivat Gjermane, Franceze dhe gjer ato Spanjolle. Ato janë ende të paprura tek historiografia dhe lexuesi shqiptar. Por, ndërsa tërë historia e jetës dhe luftërave të tij gjendet ende në radhojtë e panjohur të arkivave, emri i tij prehet madhërishëm ne nje memorial në Trevizon e largët, në Italinë veriore.

Para pak ditësh isha enkas në këtë qytet, Trevizo, për të gjetur të tjera të panjohura me vlerë për këtë luftëtar të famshëm, që nuk e teprojmë të themi se për gati gjysmë shekulli tronditi frontet e luftërave nëpër Itali dhe më gjerë akoma të Europës dhe u bë tmerr i kundërshtarëve të tij. Nuk ka, apo nuk gjejmë asnjë disfatë, veç fitore! "Çfarë kishte më shumë Aleksandri i Madh, nga komandanti im, - Mërkuri?", shkruan në një poemë kronisti i panjohur arbëror Xhani, bir i një mërgimtari arbëror, lindur në Koroni.

Mori pjesë në shumë beteja, ndoshta si askush tjetër në shekujt e XV-XVI. Numërohen të paktën 47 beteja nëpër territoret italiane dhe ato europiane. Por, nuk pati fatin e shumë syresh që mbetën në luftimet e përgjakshme. Mërkuri vdiq në shtratin e pleqërisë, në kushte normale, në këtë qytet – Trevizo.

Në këto rreshta nuk do të flasim për bëmat dhe gjurmët e thella që ai la në kronikat historike të kohës, as për medaljet e shumta si asnjë ushtarak tjetër nëpër Europë, as për vlerësimet unike që ai mori nga analistë, historianë, shkrimtarë apo poetë të kohës. Të gjitha këto i trajtojmë në një botim të afërt.

Në këtë shkrim do të flasim për gjetjet e veçanta që hasëm në qytetin ku ai kaloi vitet e fundit të jetës, ku një memorial mermeri përjetëson aktet më të rëndësishme të jetës dhe të lavdisë së tij.

NË KATEDRALEN E SANTA MARIA MAGGIORE-S

Një pasdite të nxehtë të këtij fillim korriku 2025, mbërrita në hyrje të katedrales së Santa Maria Maggiore-s të qytetit të Trevizos. Brenda saj në heshtjen e paqtë pashë vetëm tre, katër besimtarë të moshuar të ulur në ndenjëset e drunjta të cilët i përcillnin në heshtje lutjet e tyre hyjnores... Pa i shqetësuar, fillova të kërkoj, duke filluar nga fundi i sallës sa madhe, në faqet e mureve, në pikturat mesjetare murale, në kthinat e asaj godine të hershme, gjurmët e emrit të Mërkur Buas. Me kërshëri fillova të këqyr fytyrat e shenjtorëve për ndonjë ngjashmëri me portretin e Mërkurit, të punuar nga piktori i njohur italian i Rilindjes, Lorenzo Lotto, por ata asgjë nuk më thoshin.

Në këto raste është e natyrshme të rritet ankthi i një zhgënjimi të mundshëm. Megjithatë, vazhdova me këmbëngulje kërkimin nëpër sallën e madhe të katedrales dhe anekset e saj.... Papritur, ndërsa kisha mbritur pranë apsidës së Katedrales, në krahun e majtë, pashë një kompleks monumental mermeri të mbushur me skena biblike dhe në bazamentin e saj një platformë mermeri unike me një epigrafi, të gdhendur bukur, ku dallova të shkruhej: "MERCURIO BUA COMITI E PRINCIPIBUS PELOPONNESI....."

Pa e kuptuar kisha marrë frymë thellë! Kërkova rreth e rrotull miqtë e mi t'u tregoja se e kishim gjetur Mërkur Buan, njeriun e gjakut tonë të memorizuar në një basoreliev të madh mermeri, brenda një vendi të shenjtë – në Katedralen e Santa Maria Maggiore-s, në Trevizo, shumë larg vendit të origjinës së tij.

Fillova të fotografoja me të shpejtë të gjithë memorialin, por nuk kisha kuptuar se me lëvizjet e mia të nxituara kisha tërhequr vëmendjen e lutësve të moshuar. Ktheva kokën dhe pashë se ata kishin ndërprerë të shqetësuar ritin e tyre të lutjeve dhe po shikonin nga unë, si një njeri i çuditshëm, që kishte prishur monotoninë engjëllore të heshtjes së tyre. Pak më tej po qëndronte në këmbë një prift i habitur....

Foto 2. Prangat që përdorte Merkur Bua për robërit në beteja

Foto 4. - Epigrafia Mortore e Merkur Buas

PADRE BRUNO

Ibëra shenjë me dorë priftit dhe për çudi ai m'u bind dhe u afrua me shumë kujdes tek unë. Ndërsa vinte ngadalë dhe urtësisht, i kërkova të më bënte disa foto krah me relievin e madh mortor të mermertë të Mërkur Buas. I thashë, duke I treguar me gisht emrin e "Mërkur Buas" gdhendur në mermer, se ai ishte patriot i imi. Se unë me të ishim njerëz të një gjaku dhe gjuhe.

- Jemi të dy shqiptarë!- thashë me zë të ulët.

Padre Bruno (kështu quhej prifti), i habitur më pyeti:

- Pse edhe Bua edhe Ju jeni shqiptarë?

- Po - i thashë.

Ndërkohë, Padre Bruno filloi të më tregonte se ai dinte faktin se Mërkur Bua ishte ndër "Condotjerot" (komandantët forcash stratiote) më të shquar të fushëbetejave jo vetëm në Itali, por në mbarë Europën, por nuk dinte që ai ishte "di origine albanese"!!!

Mbasi, me shumë edukatë, Padre Bruno më bëri fotot që unë dëshiroja, në krah të Mërkurit, edhe unë bëra një sërë fotosh basorelievit me hollësi. Më tej Padre Bruno më ftoi, në një aneks, dhomë pritjesh, brenda ambienteve të Katedrales.

DISA RELIKE TË ÇUDITSHME TË MËRKUR BUAS

Në bisedat e mëtejme e pyeta priftin e urtë se nga shkrimet kisha mësuar se diku në atë qytet gjendeshin disa relike të çuditshme të Komandantit bëmashumë, Mërkurit.

"Përse e ke fjalën, - më pyeti ai.

I thashë se diku ruheshin prangat dhe zinxhirët me të cilat Mërkuri kishte lidhur një prej kundërshtarëve më të njohur të fushbetejave Girolamo Miani, të cilin në vitin 1517 e kishte zënë rob.

Për çudinë time, Padre Bruno më tregoi se ato ruheshin në një vend të veçantë brenda në katedrale. Shkuam bashkërisht drejt një kuartjeri mjaft impozant, ku brenda dy kutish të mbyllura prej xhami ishin vendosur dhe ekspozuar disa pranga dhe zinxhirë për të lidhur në këmbë dhe të tjera më të vogla, për të lidhur duart e robërve apo të burgosurve. Mes tyre qëndronte një sferë e madhe çeliku e cila varej në prangat e këmbëve të të burgosurve, e cila pengonte lëvizjen e të burgosurit apo arratisjen e tij.

"Këto janë prangat me të cilat Mërkuri pati lidhur Girolamo Miamin, por që mbas dy muaj burgimi vetë Shën Mëria kishte bërë mrekullinë. Ajo i pati dërguar çelësat e prangave dhe e kish liruar të burgosurin…", përfundoi Padre Brubo.

Në fakt disa zëra thoshin aso kohë se të burgosurin e kishte liruar vetë Mërkuri, por të mos merrte përsipër barrën e tolerancas dhe faljes së një kundërshtari, ishte përhapur falën se atë e kishte zgjidhur nga hekurat vetë "mrekullia e Shën Mërisë…" Një gjë ishte e vërtetë se që nga ajo ditë Girolamo nuk ishte shfaqur më në fushat e betejave.

Me Padre Brunon

Mbasi bëra disa foto me vetë Padre Brunon, i cili shprehu sinqerisht kënaqësinë për vizitën e një shqiptari të largët, u damë miqësisht nga njëri tjetri.

BASORELIVI MORTOR KUSHTUAR MËRKUR BUAS

Që përpara se të vdiste, Mërkuri kishte lënë një sasi të konsiderueshme dukatë floriri për të bërë varrin e tij. Sigurisht, është i njohur fakti që brenda ambienteve të Katedraleve kanë qenë dhe janë shumë të rrallë rastet e varrosjes në sarkofagë monumentalë të individëve të caktuar. Ata duhet të ishin njerëz shumë të shquar, personalitete më kontribute të rralla. Vetë fakti që në Katedralen e Santa Maria Magiores në Trevizo gjendej vetëm basorelievi dhe epigrafia mortore e Mërkur Buas, është shprehje e qartë e madhështisë së këtij njeriu.

Me një përkushtim të admirueshëm, një prej stërnipave të tij, Francesco degli Agolanti, pasardhësit e të cilit janë edhe sot një familje e njohur treviziane. Memorialin dedikuar Mërkurit e punoi Agostino Busti, i quajtur Bambaia, një skulptor i famshëm në kohën e vet.

Pa u futur në hollësitë e përshkrimit të këtij memoriali funebër, pasi ato i trajtojmë në botimin e afërt që kemi nëpër duar për Buan, mes të tjerave, basorelievi ka;

- disa skena biblike të punuara në miniaturë, me një art mjeshtëror.

- Mes tyre gjendet edhe një shtatore me dimensione të vogla e Perëndisë së Luftës – Mërkurit. Megjithëse kjo figurë është pagane, ajo ishte punuar dhe vendosur brenda një institucioni monotheist, sikundër ishte Katedralja e Santa Maria Maxhores.

- Poshtë tyre në dimension 2 me 2 metra gjendet Epitafi i gdhendur më shumë kujdes, me germa latine dedikuar jetës dhe heroizmave të Mërkur Buas.

- Përmbajtja e tij është:

"Pusho në paqe këtu, për të mos vdekur kurrë Konti Mërkur Bua, Princ i Peloponezit, Komandant i kalorësisë Epirote. Ti i admirueshmi për përvojën tënde ushtarake, shpesh mundi francezët, kur ata luftuan kundër arragonezëve, dhe i dëboi ata nga Mbretëria e Napolit. Ai u dha lirinë Pizanëve. Ai e ktheu Ludovico il Moro në Dukatin e Milanos. Ai vuri në arrati Trivulzion dhe mori Novarën. Ai e mori Pavian si një furtunë, prej ku mori një pre, të këtij monumenti të denjë për një mbret. Ai i ktheu Bolonjës Julius II dhe nënshtroi bavarezët e Mbretit Maksimilian. Në Marinjano ai shpëtoi nga Zviceranët, Francisin I – Mbret i Francës dhe aleat i Venedikut. Më në fund Komandant i gjithë ushtrisë venecjane, pas vdekjes së Alvianoit. Ai mundi spanjollët pranë Veronës.

Francesco degli Agolanti, fisnik trevizian, stërnip – i lindur nga nipi (i Mërkurit), e ngriti këtë monument më 1637."

Foto 5. - Shqiponja mbi epigrafine mortore

Ajo që të bën përshtypje në tërë kompleksitetin e këtij monumenti është se në krye të dedikimit epigrafik gjendet e gdhendur edhe një shqiponjë, si simbol heraldik identifikues i tërë jetës dhe veprës së Mërkur Buas. Ajo ishte ngjyrosur me ngjyrë kafe në të kuqërremtë, por e parë me vëmendje dukej se ajo ishte rilyer. Përpara, duket se ajo kishte pasur një ngjyrë tjetër, ndoshta të zezë.

Kjo shqiponjë duket qartë se i ngjan po asaj shqiponje që është gjendur në faqen e apsidës së kishës së Kastriotëve, e cila ndodhet pranë Kepit të Rodonit.

Duke e mbyllur këtë shkrim na duhet të themi se brenda dokumentacionit mjaft të pasur arkivor (një pjesë ende i panjohur) të Mërkur Buas, gjenden kronika, personazhe, ngjarje dhe artefakte me vlera të veçanta, të panjohura për historinë e shqiptarëve të mesjetës dhe kontributet e tyre kudo nëpër Europë. Gjurmimi dhe vlerësimi i tyre do të sjellë me siguri pasuri nga thesaret tona historike ende të pandriçuara.

Shënim mbi romanin e Rita Petros "Lindur së prapthi", Onufri, 2022

RRËFIMI I FËMIJËS BRENDA VETES...

Nga Agron Tufa

Foto: Rromir Imami

"Sa më pëlqente kur shtriheshim mbi tapet dhe bënim ushtrime për elasticitetin e trupit. Momenti kur trajnerja na thoshte të pushonim, unë rrija shtrirë duke parë tavanin, i cili ishte në formën e një kubeje. Mbyllja sytë dhe më kujtohej ajo figurë si në ëndërr. Isha shumë e vogël kur më sillte gjyshja në kishë. Tërë kohën e mbaja kokën lart. Në kubenë e kishës ishte një burrë gjigand me krahë të hapur, me pëllëmbën e dorës së djathtë lart, sikur na përshëndeste. Veshja e tij ishte e kaltër dhe me rrudha. Flokët e gjatë. Sytë të butë dhe me vështrim ngultaz mbi ne, që e shihnim nga poshtë. Ai qëndronte madhështor mbi kokat tona dhe unë sa herë dëgjoja fjalën Zot mendoja se Zoti mbi qiell kishte pikërisht këtë pamje. Edhe kur mblidheshim në oborrin e pallatit, loja ime e preferuar ishte të qëndroja mbi shpinën e një shoku ose të shoqes me fytyrë nga qielli. Atëherë ua ngulja sytë reve, të cilat herë më dukeshin si dele, kur ishin të bardha dhe herë si ujq, kur nxiheshin. Dhe, papritmas, ja ku u shfaq Zoti me figurën e tij madhështore në kubenë e qiellit. Ai qëndronte me shpinë nga hapësira dhe me fytyrë nga toka. Zoti i ndante delet nga njëri krah dhe ujqit nga krahu tjetër. Por ujqit i kalonin prapa shpine dhe, fap, i rrëmbenin ndonjë dele. Skuqej qielli nga gjaku. Zoti nxehej dhe lëshonte bubullima dhe vetëtima. Pastaj derdhte lot, që ndonjëherë ishin si kokrra të mëdha rrushi të bardhë. Zoti lëshonte dhe erë të fortë që i zhdukte ujqit e zinj. Mbeteshin vetëm delet e bardha që kullotnin të qeta në qiellin e kaltër.

Por tani, pikërisht aty mbi kube, ishte figura e Udhëheqësit të Madh. nuk e kuptoja se si mbi fytyrën e tij më dilte përpara fytyra e Zotit. Sytë e tyre ngatërroheshin dhe shihja katër palë sy. Edhe krahët e hapur dyfishoheshin.

- Pse u hutove? – më pyeti trajnerja.

- Hë, më fal, hiç. Ja po shoh Udhëheqësin e Madh.

- Së shpejti vjen dita e madhe kur do të japim shfaqje para tij, - më tha ajo.

- Mezi po pres, mësuese, - i thashë dhe e largova fytyrën e Zotit nga fytyra e Udhëheqësit të Madh. Tani e shihja fare qartë. Sa i bukur ishte! Më i bukur se Zoti. Madje ishte dhe gjallë. Mund ta preknim. Mund t'i flisnim. Zoti ishte shumë lart atje në qiell."

* * *

"Lindur së prapthi" është romani i parë, proza e parë e gjatë pas disa vëllimesh poetike të Rita Petros, e njohur dhe si botuese e "Albas" dhe si autore e teksteve dhe altertekstëve të gjuhës dhe letërsisë së shkollave dhe gjimnazeve, pas viteve 2000. Romani i saj, i shkruar në traditën e rrëfimeve me nota të thella autobiografike, ka vlerë të jashtëzakonshme sepse paraqet pa stisje e poza një autoportret kolektiv të brezit që jetoi realitetin e dy dekadave të fundit të diktaturës. Nuk është nga ato rrëfime që priren as për heroikë qëndrestare, as viktimizuese; mungon patosi i drejtpërdrejtë therës, kundërvënës e fshikullues bardhë e zi. Jo, Rita është besnike e përthyerjeve të këtij realiteti në vetëdijen dhe psikikën emocionale të fëmijërisë dhe adoleshencës, të habisë dhe trandjeve, të mistikës dhe misticizmit të botës përreth, për aq sa perceptimi i çiltër e infantil i prek dhe i rrok këto relitete. Ajo që e shtyn fëmijën të rritet e të ngutet të shijojë gjërat e ndaluara, janë tabutë me të cilat rrethohet bota e një fëmije në kryeqytetin e një diktature, çmitizimi i ngadaltë i kësaj "parajse" të propaganduar. Gjithmonë etja për jetë paraqitet si një rrjedhe instinktive, si një rrymë onirike e erotike që rrjedh nën lëkurë. Përditshmëria, thamë, nuk del bardhe e zi, por me plot nuanca e njolla që shpejt kalojnë nga e hirta në të murrëtyer. Kaleidoskopi fëmijnor drithërohet nga ngjyrat shpërndërruese, nga ambienti shtëpiak, apartamentet socialiste, rruga, shkolla, aktivitetet sportive e kulturore, ku përveç propagandës dhe sllloganeve ka një etje të sëmurë lëngate për posedim, një epsh egresiv herë të fshehtë, herë shpërthyes e herë të kastruar. Nuk ka dallim, nëse është i burimit familjar, farefisnor, shkollor, apo shtetëror. Por gjithashtu, krahas, ecin e përthyhen në vetëdijen fëmijnore fate njerëzish të zhdukur apo të internuar misteriozisht, mbërrin si e përlargët jehona e dhunshme dhe e luftës së klasave, sikundërse lufta e pandërprerë e ligësisë me stërkëmbsha, bërryle, spiunime, survejime.

Për këtë arsye, rrjedha introspektive e rrëfimit fiton jo notën e dëshmisë, por notën besnike të një shpirti fëmije dhe adoleshenti që përpiqet të shfaqë vullnetin, talentin dhe mbijetesën për gjërat që do e për gjërat që ëndërron të mbërrijë, brenda një kozmosi gjithnjë të pasigurtë, gjithë në transformim, thuajse të pa vënë re. Dhe duke qenë në qendër të këtij kozmosi të rrudhur, shpesh të mbyllur në vetvete, pavarësisht karakterit rebelues, fëmija krijon perceptimet dhe përfytyrimet e veta mitologjike, sipas një metafizike krejt të personalizuar. Dhe Rita Petro ka arritur të na e japë magjinë e këtyre perceptimeve infantile, përplot sharm e poezi ta dëlirë, në shumë pjesë të romanit të saj.

Shkrimtarja i ka besuar fëmijës brenda vetes në këtë rrëfim autobiografik, duke zgjidhur kësisoj shumë detyra dhe dilema njëherësh: fëmijëria, adoleshenca dhe rinia e një brezi, është pjesë e fatit dhe martirizimit njëherësh, e treguar si një bisedë e gjatë monologuese përmes lenteve të po atij fëmije me rritjen e tij, por gjithsesi, pa ndërhyrjen e gjykimit të vetëdijes së pjekur të të rriturit, pa censurë...

Kam lexuar shumë romane, madje me pretendime të mëdha, që na paraqesin rrëfime të trupëzuara biografike me antagonizma të tejskajshëm, sikundërse të tjerë, madje të superlëvduar, që shkruhen vetëm sa për t'i bërë kornizë autoportretit të tyre me ambicie kombëtare e ndërkombëtare (siç, për shembull, "Të lirë" i Lea Ypit), por nuk i shpëtojnë dot notës false dhe qëllimësisë.

Prandaj realiteti socialist i diktaturës, që pasqyron Rita Petro në romanin e saj "Lindur së prapthi", na ngjall shumë herë më tepër alergji e neveri, se sa i këtyre veprave të shkruara me qëllim të synuar haptazi, së paku për faktin se autorja as që e çan kokën për të tilla "kurime" e "tualete". Është besnike me fëmijën brenda vetes dhe, çka është më e rëndësishmja, ka përparësinë e dhuntisë letrare, siç mund ta vëreni nga fragmenti ilustrues më sipër.

Një homazh për ndarjen nga jeta të Alma Radovicka-Zadesë, gruaja e jetës e kompozitorit Çesk Zadeja

Nga Vasil S. Tole

Në vitin 1967, kompozitori Zadeja dhe balerina Alma Radovicka përfundojnë me martesë. Ishin njohur së bashku në vitin 1965, kohë kur Alma 28-vjeçare ishte balerinë në Teatrin e Operës dhe Zadeja 38-vjeçar kryente detyrën e udhëheqësit artistik të TOB. Sipas saj Çesku ishte një njeri i jashtëzakonshëm të cilin ajo e donte dhe *për një vit e gjysmë, me Çeskun kemi mbajtur marrëdhënie shoqërore. Kurrë nuk mendoja se Çesk Zadeja, kompozitori i madh, do të ishte më vonë babai i fëmijëve të mi. Çeskut i kishte lindur një ndjenjë dashurie për mua, por, si gjithnjë, ata që duhet, e marrin vesh në fund. Ai kishte shprehur dashurinë që kishte ndaj meje në rrethin shoqëror, ndërsa mua nuk më kishte thënë asnjë fjalë. Megjithëse të dy e dinim se ndërmjet nesh kishte lindur dashuria, përsëri u skuq kur ma shprehu. Ka qenë një nga çastet më të lumtura të jetës sime.*

Pas fejesës erdhi më pas dasma si në çdo rit shqiptar të martesës. Dasma e madhe u bë në Tiranë. Siç kujton znj. Alma: ... *kemi bërë një dasmë madhështore, ku ishin të pranishëm gjithë njerëzit tanë. Madje nuk mungonin as miqtë tanë të njohur, si Tonin Harapi, Panajot Kanaçi, Avni Mula apo Agron Aliaj. Por kemi bërë një dasmë edhe në Shkodër*. Dasma në Shkodër u mbajt në kushte specifike. Më 8 korrik të vitit 1965 ishte ndarë nga jeta mamaja e Zadejës, nënë Luçia dhe familja mbante ende zinë për humbjen e parakohshme. *Drita* e saj qe shuar, por jo kujtimi për këtë grua e nënë të rrallë. Siç dihet, në familjet katolike zia mbahej nga e gjithë familja. Aq i ngulitur ishte respekti për të vdekurin sa edhe në kohën kur festoheshin Pashkët dhe Kërshëndellat, të parat vizita që priteshin ishin ato për të vdekurin edhe mbahej zi duke mos dalë me shëtitë nëpër miq. Sipas Bushatit, njerëzit e shtëpisë, meshkujt, *zakonisht vejnë një shenj zije në krah ose në parzëm dhe e mbajnë një vjet rresht* etj.

Pas humbjes dhe vajtimit të *pikuleshave* për nënën Luçie, në familjen Zadeja erdhën njëra pas tjetrës dy gëzime: martesa e motrës Marie më 5 shtator 1965 dhe martesa e Çeskut me Almën, në vitin 1967. Ritmi i jetës nuk mund të ndalej. Në këto kushte, duke e ndier thellë humbjen e nënës, dasmat e tyre u bënë në rreth të ngushtë familjar dhe të kushtëzuara nga rrethanat. Është për t'u shënuar që në respekt të nënës, vajza e saj Marie nuk doli nuse nga shtëpia prindërore e Zadejave në Shkodër, pre nga duhet të dilte në rrethana të zakonshme, por doli nga shtëpia e Zadejës, vëllait të saj në Tiranë. Po ashtu, në darkën e dasmës së Zadejës, theksojmë se përveç familjarëve morën pjesë vetëm disa të ftuar me gishtat e dorës nga miqësia profesionale e Zadejës, kryesisht kolegë kompozitorë dhe këngëtarë dhe jo të tjerë të ftuar të shumtë siç e donte zakoni. Nëse zia nuk do të ishte, ahengu shkodran natyrshëm do të shoqëronte martesën e tyre, gëzimin e kryemuziktarit shqiptar me balerinën bukuroshe nga jugu i Shqipërisë dhe Shkodra me siguri që do t'u këndonte këngën:

Sa bukur na ka dalë nusja,
marshalla marshalla
e bukur për bukuri-e, “ “
paska shtatin-o si selvi-e “ “
paska ballin perishan-e “ “
paska vetllën-o si gajtan-e “ “
paska synin-o si filxhan-e “ “
paska hundën-o miskalli-e “ “
paska faqet-o gurabi-e “ “
paska gojën-o si kuti-e “ “
paska dhamët-o si inxhi-e “ “
ma gëzofsh-o dhandri ri-e “ “

Referuar traditave të dasmës shkodrane, dasma gjithmonë bëhej më e madhe te burri se te nusja. Kënga dhe vallja në shtëpinë e dhëndrit nuk pushonte asnjëherë, duke shoqëruar hyrjen e nuses në shtëpi, nusërimin, hapjen e dhuratave që ka sjellë, pritjen e krushkave dhe darkën festive. Nuk duhet lënë pa përmendur fakti se zia për nënën preku edhe krijimtarinë e Zadejës. Nëse i referohemi krijimtarisë së tij të vitit 1965, ai vit mbetet viti me më pak krijimtari në krahasim me të gjitha vitet e aktivitetit të tij krijues. Boshllëku shpirtëror i humbjes së nënës ishte shfaqur në mungesën e frymëzimit për të shkruar muzikë në atë vit.

I pari nga fëmijët lindi Albani më 1968 dhe e dyta vajza, Delina më 1975. Që të dy fëmijët morën emrat e personazheve të dashura për të nga baleti “Delina”, libretin e të cilit Zadeja e kishte shkruar vetë. Alma thotë se të dy fëmijët janë artistë, vajza ka mbaruar Akademinë e Arteve për piano, ndërsa djali për vegla frymore. Ata ecin në gjurmët tona. Albani, djali i Zadejës e kujton atë si një baba të përkushtuar për familjen, që për çdo problem komunikonin lirshëm dhe si një ndihmesë të madhe në profesionin e tij. Albani pohon gjithashtu se *është shumë krenar për veprën që ka lënë dhe për vlerësimet nga muzikantë e kolegë dhe publiku i gjerë shqiptar dhe ai i huaj. Pa dyshim, kur dëgjoj ose luaj vepra të tij kam një emocion të veçantë,* – thotë Albani.

Alma Zadeja i qëndroi pranë Zadejës për mbi 30 vjet, deri në frymën e tij të fundit, duke qenë mbështetja më e fortë si për rritjen e fëmijëve, ashtu edhe në pikëpamje të qetësisë dhe inkurajimit aq të domosdoshëm për të përballuar ngarkesën e madhe fizike dhe emocionale që Zadeja kishte në veprimtarinë e tij të përditshme. Alma ishte gruaja ideale tek e cila Zadeja u mbështet për të krijuar muzikën e tij, e po ashtu zonja e shtëpisë e cila priste me dhjetëra e qindra artistë e njerëz të thjeshtë të cilët i lidhte puna me aktivitetin e Zadejës si krijues, pedagog, muzikolog, drejtues institucionesh dhe personalitet i jetës artistike të vendit. Shtëpia e Zadejës ishte faktikisht një institucion i pashpallur artistik në Tiranë, pasi prezenca e Zadejës e bënte atë të tillë dhe unike.

Në intervistën fundit që Zadeja ka dhënë vetëm 2 muaj para ndarjes nga jeta, pyetjes sime *“Profesor, cilat janë specifikat e marrëdhënieve që krijohen nëpërmjet Jush, kompozimit, aktivitetit tuaj të shumanshëm artistik dhe shkencor dhe familjes Suaj”,* ai u përgjigj: ... *Familja është e shenjtë dhe nuk duhet “vlerësuar” nga burrat si hotel qëndrimi dalje e hyrje. Por nuk them asgjë të tepërt kur shtoj se posaçërisht familja është një frymëzim i veçantë për krijuesit. Në të vërtetë qenia ime është marrë me artin skenik koreografik, ashtu edhe fëmijët i kam në rrugën e artit të interpretimit. Unë kam pasur gjithnjë një mirëkuptim dhe mbështetje të përzemërt në punën time krijonjëse e studimore.*

Pas vdekjes së Zadejës, zonja Alma dhe fëmijët e saj, Albani dhe Delina, kanë bërë dhe po bëjnë gjithçka që nevojitet për t'u kujdesur për trashëgiminë muzikore dhe artistike të Zadejës. Ndarja e saj nga jeta mbyll një kapitull të rëndësishëm të kësaj familjeje të madhe të muzikës sonë, që kishte në qendër të saj Zadejën dhe bashkëshorten e tij Alma, e cila der isa mbylli sytë thoshte *E kujtoj me mall, ç'do ditë e kujtoj. Për mua është gjithmonë i gjallë kur dëgjoj muzikën e tij!*

Modernia dhe klasikja në poezinë e Kadaresë

NJË RILEXIM I VËLLIMIT POETIK "SHEKULLI IM"

Nga Sadik Bejko

Në çdo moshë ka libra që u kthehemi e u rikthehemi jo një herë. Rileximi e mban gjallë kujtesën mbi librat më të mëdhenj të njerëzimit ndër kohëra.

Ndonjëherë rikthehemi dhe për nostalgji, a për një çudi që mund të kemi provuar dikur në leximin e një libri.

Më poshtë do të flas për rileximin e librit "Shekulli im", poezi dhe poema të vitit 1961 nga Ismail Kadare.

Në një kohë të sotme, kur nga të gjithë flitet për prozën e tij, po i rikthehem një libri që mbase nuk e mban mend gjithkush. E kam blerë atë libër kur isha nxënës në vitin e tretë të shkollës së mesme në Elbasan. Kishte një kapak kuq e zi, që tani nga përdorimi nuk është më. Janë grisur dhe dy tre fletët e fundit të librit. Por në mbi 60 vjet atë nuk e kam ndarë nga biblioteka ime. Më 1961 kam bërë dhe një fotografi me këtë libër, foto që s'më kujtohet se si e kam humbur.

Libri ka 43 poezi dhe katër poema, më të shumtat janë shkruar në vitet 1958-60, gjatë viteve kur studionte në Institutin Gorki, në Moskë. Më shumë se gjysma janë poezi dashurie. Poema e fundit, "Rrugëve të Moskës" është një kolazh me poezi për dashurinë. Dy poezi "Komunizmi" dhe "Razliv" (për Leninin) janë vjersha drejtpërdrejt politike. Me një tematikë që afron nga ajo politike janë dhe katër nga pesë poemat e librit: "Shënime për brezin tim", "Shekulli XX", "Paqen do ta imponojmë", "Vdekja e turistit", 'Ëndërr industriale".

1. Arti i poezisë

Veç të tjerash, ky libër më jep edhe të dhëna mbi atë se si ka evoluar arti i shkrimit të poezive nga Ismail Kadareja. Dhe jo vetëm ndryshimet tematike, por edhe ato stilistike të poezisë së tij.

Poezia 'Pizhamet dhe aeroportet' përfundon me këto vargje:

Mos më ler kurrë, o moj botë e madhe!
Mbi pistat e pizhameve të mia,
Të ulen aeropanët!
Pas dritares sime të varen në tela

E të tunden nga era
Kanatjeret e reve;
Në portollampën e abazhurit tim
Të montohet dielli.

Në këtë poezi dhe në gjithë librin ndjehet rebelimi tronditës, brutaliteti i një të riu, i një autori që e ndjen forcën, titanizmin e talentit të tij. Vetëndjerja se ai ka prekur në botën e madhe të artit, është si e thënë pak hutueshëm, e pashpjeguar, prapë ajo shoqërohet me thirrjen që dielli le të montohet në abazhurin e tij. Ai tashmë do t'i përkiste një bote të ndritshme, planetare. Autori e ka parandierë se bota e madhe e artit do të ishte jeta e tij, e ardhmja e tij. Siç edhe ndodhi.

Çfarë ka ndodhur me poezinë e tij në këtë libër?

Në një poezi të vitit 1956, "Në tavolinën e studimit", Kadareja, student universitar i vitit të tretë, pranon se është nipi, trashëguesi i "të vjetërve famullitarë", i Budit, i Bardhit dhe i Bogdanit. Poezia "Në tavolinën e studimit" është e shkruar më një varg 11-rrokësh që të çon edhe më shumë te kultura klasike e etërve famullitarë të cilët ai atëherë na thotë se "i lexon çdo natë".

Kjo poezi ndër të tjera dëshmon se Kadareja e zotëronte teknikën e vjershërimit klasik që në fillimet e tij. Papritur tani në librin "Shekulli im" ai pranon që vjershërimin e tij e udhëheqin Majakovski, Uitmani, Migjeni.

Rrugës në pjekshi Migjenin, Majakovskin apo Ullt Uitmanë

"Salut!" u thoni dhe ktheni me ta nga një gotë birrë.
(Shekulli im, Përcjellje e vargjeve, faqe 4).

Autori e ndien dhe është i përgatitur për atë që rruga e artit është e vështirë: Udha ka diell, ujqër dhe natë, vetëtima të rrema lavdie, netë me ulërima çakalli.

Veç pengesave të tilla tokësore janë dhe armiq të tjerë fare të pamëshirshëm: konkurenca me autorë në përmasa ndërkombëtare dhe përballja me… kohën.

Do të kini fat në udhëtimin botës tejembanë, apo ujqërit e shkretëtirat do t'u shqyejnë, goja plot rërë, vdekur në varre të panjohur nën tufane. Ndaj vargjet i mëson të jenë trima të marrë, të shtegtojnë me kokën lart, të forte, të patrembur, të dlirë. Në betejën me kohën i nxit të ikin më larg dhe skelete të gjymtuar, të sakatuar, le të ikin më larg, për atë çka vdes, mëkati le t'i mbesë autorit…

Kjo përcjellje vargjesh sot tingëllon, si përcjellje për gjithë trashëgiminë e tij në prozë e në poezi. Kjo trashëgimi u vu në garë në kohëra dhe në hapësira pa fund, brenda e jashtë Shqipërisë.

Por si erdhi të ai poezia?

"Babai" dhe pse nuk ia lexon poezitë, pi nga hidhërimi në një klub plot tym se atij po ia kritikojnë poezitë e të birit.

"Poezia" vjen fare papritur: qyteti me kalldrëme të gurtë… nëna i shkruan letra pa pikë e pa presje, i riu është i hapur 'citta aperta' për shumë dëshira…. Por, më së fundi, tani ai e ndien se poezia (letërsia) është stacioni i tij i fundit.

Programin e tij të mënyrës se si duhet shkruar poezia e shpall kryesisht te dy vjersha: "Poezija e deklasuar" dhe "Fjalët e rimuara".

Thirrja për hapje rruge është e ashpër dhe plot ironi e sarkazëm: "Hapeni udhën, poetë të poezisë së deklasuar"…

Cilët janë këta? Ky "Fis i demoduar i poetëve" thurin vargje psherëtimash me kilometra, si hekurishte të vjetra. U tmerrohen formave të reja, gatuajnë poezi me fjalë të zgjedhura, rima të zgjedhura, poetë bimorë, luleshqerrakë, poetucë të mjerë ku "Fjalët e rimuara ç'i ha vreri/ kur s'u pajtohet karakteri, kur… "zënë në flagrancë rimën me ndonjë asonancë"…, ndaj "Rimë ku kalle kokën, të rënçin rrokjet…".

Për këta poetë bimorë, dmth të vdekur, në qyteti i ri industrial do të ketë dhe një "Ofiçinë të riparimit të soneteve të demoduara".

Poetëve të demoduar që pijnë me prostituta honoraret e dashurive të pastra, autori u kundërvihet: "…si kujtim nga vajzat mbaj/ jo një lule të tharë,/ a një frazë albumi plot psherëtimë,/ po numurin e saktë të telefonit/ me shifra të përcaktuara mirë". (Shekulli im, fq 85).

Poezia që vjen më poshtë, me detaje të gjalla nga jeta, me vargje eliptike, të lira, të ashpra, me fjalë të gjuhës së përditshme ishte shembull i kundërvënies ndaj artit demode me fjalë të zgjedhura e tema poetike në vetvete:

Fëminia

Fëminija ime me gishtat lyer me mellan.
Në mëngjes këmbanat,
Myezini në muzg.
Koleksione paketash e pullash të vjetra
Shkëmbimi i një Ceyloni
Me dy Luksemburg.
Kështu iku ajo
Kohë e fëminisë
Vrapoi duke ngritur pluhur pas një topi lecke,
Top lecke
Nga leckat e thinjura të Shqipërisë.

Shekulli im, fq 25.

Me këtë libër poezia e tij shkëputet në stil nga veprat e tij të mëparshme dhe do të jetë edhe më konceptuale në vazhdimet e saj. Do të priret nga sintezat. Nga vargu i lirë. Një teknikë që nuk ishte fare e panjohur në letrat shqipe. Me këtë teknikë 'të rinjtë' u kundërvunë me 'të vjetrit' në vitet '60 dhe politika e kohës u tha "afirmohuni më vargun tuaj". Dhe… të rinjtë Kadareja, Agolli, Arapi "fituan".

Një poemë si "Përse mendohen këto male" që nuk i shmangte mesazhet propagandistike, afirmimin e partisë komuniste si shpëtuese e Shqipërisë, nuk u pranua dhe nga një autoritet i studimeve si Shuteriqi, i cili në rininë e tij kishte shkruar poezi me prirje që e vinin afër simbolistëve.

Arësyeja e mospranimit të poemës "Përse mendohen këto male" ishte artistike: poema nuk përtypej për artin e saj. Që në vargjet e para të poemës jepet tabloja e maleve që janë aq të zymtuar në mendime përballë një muzgu të frikshëm. Një malësor ecën me pushkën e gjatë dhe një intelektual me mendimin "në kokë diku". Mendimi dhe pushka i përplasen muzgut, për ta ndalur.

Mendimi teorik mbi poezinë i asaj kohe nuk ishte i përgatitur t'i pranonte abstraksionet e kësaj natyre.

Më tej në këtë poemë vjen imazhi i malësorit me një pushkë të ngulur në kolonën e tij vertebrale, si një vazhdim që shtatin ia bënte më të gjatë, por që jetën ia shkurtonte. Këtu Kadareja veçse sintetizon atë malësor që në poemën e Fishtës "Lahuta e Malcisë" vizatohet konkretisht.

2. Poetizimi mitik i qytetit, i industrializmit

Prirja për nga një poezi e futurizmit, e surealizmit, e mitizimit të qytetit si realitet që emancipon dhe iluminon mjediset po më shumë ndërgjegjen shoqërore, pirja nga një mistikë e industrializmit dhe e apoteozës së metalit, të radarëve, të lazerit, të energjisë atomike, ashensorëve, televizorit, metrove, aeroporteve planetare, trolejbuzëve u vu re për herë të parë te lënda poetike e librit "Shekulli im", 1961.

Ky është një libër unikal për nga prurjet në gjuhë dhe për nga idetë që përçojnë nga një shoqëri e lirisë së njeriut

të epokës së shkencës dhe të industrializimit. Ky "ëndërrim" do të sillte një shoqëri të lartësuar, të shkëputur nga një qytetërim bujqësor plot me kanune mesjetare drejt një njeriu me liri individuale e deri… te pranimi i çvirgjërimit të femrës para martese, pranimi i abortit, i lindjes së fëmijës jashtë martese, pra, drejt një lirie të plotë edhe të jetës seksuale.

Fjalët… që s'kanë paragjykime,

që bëjnë dashuri
Me njëra tjetrën si t'u teket
Se s'është më kot shekulli XX.

(Shekulli im, faqe 55).

Shqipëria ndërkohë ishte vendi ku fëmijët luanin me topa lecke, shoqëri thellësisht patriarkale, puritanisht e rreptësisht komunisto-feudale.

Liri kërkohet për vargun, për rimën, për gjuhën, për figurën e për fjalën.

Në këtë libër ka aq shumë terma nga jeta urbane, nga pejsazhet e modernes, sa në kohë nuk i gjeje as në prozën e as në publicistikën e ditës. Është një libër që dhe sot mund të zgjonte kureshtjen për atë rebelim të shëndetshëm ndaj një shoqërie shqiptare të prapambetur, shoqëri që ende i punonte tokat me buaj, që ende në kryeqytetin e saj, Tiranën, nëpër rrugët në vend të makinave vozisnin pajtonët ku mbreheshin kuaj e transportohej me qerre të tërhequra nga qetë.

Dehja poetike dhe fantazmagoria e shprehjes së çlirët, e thirrjes për daljen te një shoqëri e emacipuar, nuk ishte domosdoshmërisht thirrje për afirmimin e një shoqërie komuniste.

Shënojmë se me redaktime disa nga këto poema Kadareja i ka përfshirë në librin e tij me poezi të zgjedhura Vepra 7, Poezi dhe Poema, Onufri, 2008. E ashtuquajtua poema sintezë e periudhës së realizmit socialist, frymëzuar nga Majakovski, Uitmani, jo gjithmonë dha poezi të arritjeve më të mira të autorëve që e ushtruan. Madje shpesh ato janë të një nivel të ulët estetik.

Pavarësisht nga çfarë ndodhi me këtë strukturë të artit, me poemën sintezë, të braktisur nga autori në ecurinë e tij të mëtejshme poetike, në këto poema vjen një vetëdije e viteve '60 të shekullit që shkoi, vetëdija e një kohe kur mendohej se shkenca dhe teknologjia do të ndryshojnë të ardhmen e njerëzimit.

3. Poetika me dritë, spontane, rinore e dashurisë

Në libër flitet për jetë dashurore ku "miliona dashuri ndahen, takohen miliona". Jepen skicime portretesh të vajzave moskovite, të cila Kadareja nuk i hiqte nga kujtimet edhe në bisedat e fundit me miqtë.

Poema e fundit "Rrugëve të Moskës" sjell vazhdimësinë e temës së dashurisë: një i ri në një qytet të madh, në shoqëri me vajza të bukura që japin e marrin dashuri lirshëm, shpengueshëm në gjerësinë e pamasë të një metropoli… që është i hapur dhe për të huajin nga Shqipëria e largët.

Poezitë e dashurisë janë të mbështetura mbi fakte reale, disave prej vajzave autori u vë inicialet e emrave. Në botimin e veprës së zgjedhur ai i ka botuar poezitë duke plotësuar emrat, mbiemrat, inicialet. Në këtë jetë dashurore gjithëçka është e shpejtë dhe e shkurtër. Atë që e ke sot, mund ta humbësh nesër. Kjo klimë përkohësie përjetëson te subjekti lirik rrjedhën e pandalshme të kohës, fikson çastet, takimet, ndarjet, fragmentet kohore me të dashurën e radhës.

Fytyra jote mermer nën të puthurën e parë
Dhe befas më rëndove në gjoks
Më rëndove për jetë
Si statujë e bardhë.

Autori në sipërfaqe gjasme qesh me ndarjet, humbjet e dashurisë nga aq shumë të njohura, por thellë- thellë ato si situata shpirtërore mbeten, gdhendin në kujtesë fragmentet e një lumturie efermere dhe… autori i shndërron në poezi. Poezi të shkruara si në ecje e sipër, derdhur thjesht e shpejt në një grusht fjalësh të ngjeshura. Vargje të tejdukshme si akuarelet: "Pikat e shiu na feskonin të puthurat" Poeti e zhdramatizon ndarjen: nesër iki. Një cigare, një limonatë, tunelet na gëlltën si gojë harrimi.

Vajza shpejt atë do ta zëvendësojë me një djalë tjetër…
Asgjë e jashtëzakonshme
Veç ndonjë natë
Gishtat e ndonjërit do të pleksen në flokët e tu

Me të largëtit gishtat e mi me kilometra të gjatë.
(Edhe kur kujtesa).

Poezitë më të mira sjellin jetë, atmosferë, ndjeshmëri që nuk kanë qenë të njohura më parë në poezinë shqipe.

Poetizohet situata e një çifti të përqafuar, të përgjumur …një mollë e kafshuar përgjysmë mbi komodinë.

Kjo gjysmë mollë… atij do t'i mungojë në një kohe tjetër, kur të jetë qetësuar në shtëpi, me grua, me komfort… larg në vendin e tij.

Vjen një mitizim absolut i dashurisë së lirë, dashuri të cilës i mjafton vetvetja, çasti kur ajo përmbushet pa kohë e pa hapësirë tjetër, pa të nesërme a të ardhme…

Jemi katër sy' një buzëqeshje./jemi një kinoafishe e dashurisë që ka marrë era,/ jemi dy libra me fletët e bardha të grisura/lexuar nga të tjerë…

S'po të premtoj fejesën …
Dhe as martesën
Me ditët e mërzitshme si pizhame.

Poema "Rrugëve të Moskës", 1958-60, Rigë-Tiranë.

Freskia, befasia e ndërrimit të situatave të çojnë te një moshë e pasioneve të vrullshme që këmbehen, mbulojnë njëra-tjetrën. Krasitjet, lëniet përgjysmë, humbjet, ndarjet… bien si thyerjet nga stuhitë e pranverës që i shpërthejnë e i harlisin më shumë bimët e njoma. Është një moshë djaloshare 22-24 vjeç që nuk e pranon dhembjen.

Në poezitë e mëpasme, në ato të periudhës së fundit të shkrimtarit, në poezi si: Mall, Kristal, Në studion dimërore, Pas darke, etj, skalitja metrike e vargjeve, ndërtimi klasik i strofave, materia poetike luksoze është e ngjeshur dhe ndjeshmëria e humbjes, e dhembjes humnerojnë në pakthim, në brengosje që i mbetet e pandarë qenies.

Ndarja është e rëndë, a nxin, ta nxjerr shpirtin: "Të ndërtosh një ndarje për të qenë/ Është më e zorshme se të ngresh një piramidë..."

4. Modernia brenda formave të klasikes

Po pikërisht në këtë libër, libër manifest të çlirimit nga format klasike të poezisë, vijnë dhe disa balada, të cilat të prijnë nga një gjuhë e rreptësisë skrupuloze, nga një optikë e tragjikes që të çonte te autorët e përjetshëm të klasikes.

Baladat e Ismail Kadaresë japin një çelës për atë se si format e poezisë klasike mund të martoheshin me ekspresionin stilistik të modernizmit, të paradoksit surreal: herë mërzia zbardh/ herë nxin mielli. Në baladën "Këngë e millonait" nën një ritëm të shpejtuar e plot muzikalitet, brenda vargjeve të rregullta gjashtërrokëshe, vjen historia e trishtuar e dashurisë së pafat të millonait që bluan miellin me të cilin do bëhen bakllavatë, pitet në dasmën e të dashurës së tij: Mes trokashkave/ të duket sikur/i gërnetës vaji/mu në gjoks t'u ngul./Hedh atje tani/dhëndri një shaka,/qeshje e vjehrrës/ thikë: ha ha ha!

Te balada "Ikja e Moisi Golemit" vjen një përfytyrim sa klasik shekspirian aq dhe modern e kinematografik. Makbethi vrau gjumin, Moisi Golemi vret ndërgjegjen që e ndjek prapa dhe ia kap frerët e kalit që të mos i jepet rrugës së tradhtisë.

Balada "Varrimi i Skënderbeut" me të vdekurin e hedhur jashtë varrit, me kockat që u grabitën nga otomanët, jep imazhin e një të pavarosuri të përjetshëm. Atë nuk e mbante varri, ndaj hidhet prapë mbi kalë në fushat e luftimeve. Kockat i mbillen nëpër kontinente, në dete, shkretëtira, lumenj, male atje ku vdiqën ata që i mbajtën në qafë si hajmali. Një mistikë e vdekjes së shpërndarë në gjeografi e në kohëra, një pasvdekje, një mosvdekje.

Te balada e mëvonshme për Ali Pashë Tepelenën imazhi "të shtrinë Ali Pasha, të shtrinë" nuk domethënë të shtrinë në tokë, të vranë, por dhe një tërheqje gjer në shqyerje më dysh e qenies fizike dhe e staturës së figurës së tij historike (lavdi dhe mizori), e personalitetit të tij, një përmasë që mund t'ia jepte kjo lloj vdekjeje, ky zgjatim motor në dy kontinente, trupi në Europë e koka në Azi. Imazh mitik, gati shekspirian.

Kjo ishte teknika e ruajtjes së jashtme të formës klasike, por me inovacione të brendshme, teknikë e lëvruar mjeshtërisht tek poezia e rusit Boris Pasternak.

Kjo prirje e modernes brenda formave të klasikes mori kryet e vendit në krijimet e periudhës së fundit të Kadaresë. Shembull, ndër shumë të tjera është poema e tij "Tirana në dimër" (2005) ku vargu 11-rrokësh strofa katërshe japin kllapinë e në jete të hallakatur "dantealigershëm" të Tiranës së tranzicionit të sotëm.

Dikur e kam lexuar librin "Shekulli im", poezinë e librave të Kadaresë, i mrekulluar nga risitë e befasitë, në formë e në përmbajtje, por e lexoj dhe tani mbas gjashtëdhjetë vitesh dhe prapë e përjetoj poezinë e tij si një çudi letrare je vetëm për kohën kur u shkrua.

Ka shumë që sot mendojnë se Kadareja nuk ka qenë gjë si poet.

Mendoj se Kadareja veç prozator i nivelit botëror, është dhe poet, poet me prurjet e veta krejt origjinale në poezinë shqipe, poet me shumë novacione për kohën e tij. Rileximet e poezisë së tij nuk janë vetëm arratisje në nostalgji.

Tetor 2024

Kumtesë e mbajtur në Shkup në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve

"NËNQYTETI"/ POGRADECI I rikujtuar nga mjeshtri Taso

Nga Ylli Drishti
Historian & Kurator Arti, Tiranë

Kush e ka vizituar Pogradecin këtë sezon turistik siguristi ka ndjerë, se përveç magjisë së peizazhit, ajrit të freskët, ka admiruar nga afër kujdesin e përditshëm të Bashkisë për një qytet të pastër e të gjelbëruar. Ajo që tashmë është bërë traditë në çdo sezon turistik është respektimi i natyrës duke ndërtuar struktura portative druri për: Kafe – Bar – Restorante që në mbrëmje mes luleve dhe dritave - krijojnë një atmosferë magjike. Në këtë këndvështrim qyteti i Pogradecit zë një vend të veçantë si në mikpritjen e vizitorëve, kulinarisë, pastërtisë, rregullit por edhe të veprimtarive artistike & kulturore. Kështu gjatë muajve maj-korrik në këtë qytet të vogël vogëlushët ndoqën nga afër festivalin e kukullave "Xinxifillo", gjatë 24 – 30 Qershorit, u zhvillua Edicioni i 21 – të i "ALBAMONO" - International Monodrama Festival - një event kulturor ndërkombëtar, që mblodhi së bashku artistë profesionistë të skenës nga 8 shtete të ndryshme, USA. Shqipëria, Ukraina, Greqia, Kroacia, UAE, North Macedonia, Polonia. Në vazhdimësi në Odeonin e qytetit u zhvilluan e zhvillohen koncerte të vazhdueshme me këngëtarë lokalë. Në Pogradec dha shfaqje Cirku Kombëtar si dhe grupet e të rinjve të Pallatit të Kulturës. Gjithashtu u zhvillua dhe "Ring - show" me nxënësit e gjimnazeve të qytetit. Ndërkohë dhe Galeria e Arteve e qytetit në kalendarin e saj ka renditur disa ekspozita arti. Më 12 korrik u përurua – Projekti (ekspozita) me titull: "NËNQYTETI" i artistit të njohur Anastas Kostandini "TASO", më tej do të ekspozohen veprat e kolonisë së artistëve të ftuar në Pogradec si dhe do të çelet ekspozita vetjake e piktorit të njohur Agron Polovina.

Piknisja e një Projekti – "NËNQYTETI"

"...Kështu nis dhe ky projekt! Bisedat për Pogradecin e vjetër me babin janë të shpeshta; herë të befta, herë të ngeshme, por gjithmonë të pasura dhe emocionale. Ato burojnë nga dëshira për mos harruar dhe nevoja për të kuptuar. Diku në këtë shkëmbim nisi të ndërtohej Nënqyteti... Bisedat për Pogradecin e vjetër me babin janë të shpeshta; herë të befta, herë të ngeshme, por gjithmonë të pasura dhe emocionale. Ato burojnë nga dëshira për mos harruar dhe nevoja për të kuptuar. Diku në këtë shkëmbim nisi të ndërtohej Nënqyteti. Bota e Tasos është e mbushur me imazhe të jetuara e të dëgjuara. Kërkimi i tij artistik është i lidhur ngushtë me temat që burojnë nga historia, marrëdhëniet njerëzore dhe natyra e Pogradecit. Njohuritë e mbledhura ndër vite, repertori vizual që ka ndërtuar dhe arkiva e shumëllojshme janë një burim i pashtershëm drite. Ai e mat qytetin me copëza kujtimesh.Por pavarësisht ndjeshmërisë së thellë, gjykimi i tij nuk bie pre e nostalgjisë. Bisedat i shoqëron me një revoltë të heshtur për atë që humbet dita-ditës, dhe një dashuri të thellë për vlerat që brendashkruan Pogradeci. Taso flet gjithmonë në emër të dashurisë! Ndaj figura e tij është qendrore në këtë projekt, jo thjesht si artist, por si bartës i një kujtese të gjallë. Qyteti është një temë edhe mes miqsh! Flasim për çfarë mbetet dhe çfarë zhduket. Për ata që ikin dhe ata që vijnë. Për ata që harrohen dhe ata që na harrojnë. Qyteti shpesh duket si i zbrazët, megjithëse njerëz ka. Jeta është e ngadaltë. Banorët e Pogradecit kanë një butësi që ngjan me liqenin. Janë të thjeshtë, të qetë, me shpirt të pastër dhe një mister të brendshëm. Edhe natyra ka të njëjtat tipare. Cilido që ka sadopak ndjenjën e përkatësisë, është mbrojtës i saj. Kujdesi për natyrën është si kujdesi për njëri – tjetrin..."

Nga Ledia Kostandini (pjesë nga teksti në Katalogu i Ekspozitës)

Ekspozita e çelur para pak ditësh (më 12 korrik) në GA, Pogradec (Shtëpia e Kulturës Lasgush Poradeci) e artistit TASO (Anastas Kostandini) ka tërhequr vëmëndjen e publikut artdashës si një ngjarje e veçantë në konceptimin e saj, por edhe në vizionin modern të trajtimit. Ekspozita titullohet: "NËNQYTETI" dhe paraqet në fakt një koleksion prej 31 punimesh në vizatim në format A3 me imazhe nga qyteti i vjetër i Pogradecit. Ekspozita është realizuar si një projekt mes artistit TASO dhe vajzës së tij artistes Ledia Kostandini, e cila këto punime i ka transformuar në QR kode të vendosuara kudo në qytet, pikërisht aty ku janë realizuar imazhet e vizatimeve nga mjeshtri TASO. Pra, është krijuar një hartë poetike e Pogradecit që nuk egziston më, por që mund ta admirosh nëpërmjet kësaj ekspozite dhe më e veçanta në këtë projekt është vendosja e Hartës Orientuese e shtrirë në hyrje të ekspozitës, e cila të fton që pasi të vizitosh ekspozitën të ndihmon të orientohesh dhe ti lidhësh ato vizatime pikërisht me vëndet ku ato objekte të vizatuara kanë qenë prezent si pjesë e qytetit vite më parë, por që tashmë nuk janë më. Projekti "Nënqyteti" është një iniciativë (koncepti & realizimi nga Anastas Kostandini, Taso) e komisionuar nga COSV Albania, në kuadrin e Projektit "Liqenet e Shqipërisë", financuar nga AICS Tirana / "Agensia Italiana per la Cooperazione allo Sviluppo" – Cooperazione per lo Sviluppo COSV Albania VIS Albania. Koncepti dhe drejtimi artistik - Ledia Kostandini dhe komunikimi & kurimi nga Paola Iljazi. Në veprat e këtij koleksioni vizatimesh mjeshtërore, ndjehet që Taso ndërton apo më saktë i thur "poezi" në art qytetit të tij të lindjes real dhe imagjinar, si në një skenografi realiste, magjike, që mjafton ta shohësh vetëm një herë dhe e dallon që është qyteti i vogël i Pogradecit. Anastas Kostandini - Taso, ja ka kushtuar jetën me artin e tij, këtij qyteti, i ngritur në bregun shqiptar të liqenit të Ohrit. Taso është piktori bashkëkohor shqiptar më interesant i Plain – Air, duke mbetur ndër piktorët e pakët që krijon sipas traditës impresioniste "natyrë – natyrë - studio". I mbështetur mbi një koncept "arkeologjik" të pikturimit të peizazhit, ku një "objekt i gjetur"ndihmon në zbulimin dhe ndërtimin imagjinar të historisë dhe qytetërimeve (jetës ekonomike–sociale të shoqërisë),Taso, preferon tematikën e jetës tradicionale të qytetit: qilarët e vjetër të verës, brendi familjare në banesat e vjetra, njerëz të thjeshtë që ecin apo rrinë ulur në rrugët & rrugicat e qytetit, sheshet e vjetër simbol të qytetit, Berberhanën e njohur buzë rrugës, gratë tek burimi tradicional duke mbushur ujë, gratë e qytetit që hapin petët e petkave dhe trahanasë për dimër, burra që pinë kafe në klub dhe mijra e mijra episode nga jeta e përditëshme të fiksuara nga piktori.

Koleksioni i 31 vizatimeve të Tasos i përket cikleve të pafund të tij (me mijra vizatime), me kohëzgjatje mbi 50 vjeçare. Ai i realizoi vizatimet e këtij projekti të veçantë me një përkushtim dhe pasion brenda 2 muajve në fillimin e këtij viti (shkurt-mars).

Vajza e artistit Ledia Kostandini bashkautore e këtij Projekti të veçantë, evidenton se në realizimin e ciklit prej 31 vizatimesh Taso, citoj: "...ka punuar në tri – madje katër – nivele kohore. Në nivelin e parë, ai shkon në thellësinë e kohës: aty ku kujtesa nuk është personale, por e lidhur me rrëfime të trashëguara, dëshmi të të tjerëve, fragmente dokumentesh apo foto të rralla. Është koha që nuk e ka jetuar vetë, por që e ka përthithur si përfytyrim, si në rastin e pazarit të vjetër i cili u dogj në 1943-shin. Niveli i dytë është koha e përjetuar në

Xhamllëku / Berberhana



Burimi i Toplecit

fëmijëri dhe rini të hershme — një kohë që rikthehet me ndjeshmëri të lartë, por edhe me një lloj mjegullimi emocional. Në këtë pikë, kujtimet vijnë më shumë si gjendje sesa si fakte. Kjo është ndoshta zona më e ndjeshme e kujtesës së tij. Niveli i tretë është ai i moshës së pjekur, tashmë me një vetëdije më të qartë për atë që ka humbur. Kjo kohë sjell me vete racionalitet, qëndrim kritik dhe një qasje më analitike. Vizatimet bëhen më të përqendruara në përkufizimin e hapësirës dhe strukturës. Ai kujton tashmë jo vetëm për të rikthyer, por për të dëshmuar, dhe dëshmia e tij është e kthjellët dhe e përpiktë.

Përmes teksteve që shoqërojnë vizatimet, Taso përfshin edhe një nivel të katërt kohe: atë të së tashmes...".

Piktori me mjaft mënçuri e vizaton qytetin e tij në dy mënyra të ndryshme që përbëhen nga dy rrathë brënda njeri – tjetrit. I pari është rrethi i jashtëm që e sheh (vizaton) qytetin nga periferia, nga larg dhe rrethi i dytë dhe më i rëndësishëm është koleksioni i punimeve që zbulojnë jetën e brendëshme, shpirtin e qytetit dhe rrugicat, lagjet që tashmë ruhen vetëm në memorien e brezit të tretë. Kostandini – Taso, në peizazhet urbane kujdeset që pika e shikimit të jetë sa më afër (horizontale): mbi ndërtesat në lagjet tradicionale, tek krojet e vjetër të qytetit, brenda qytetit dhe buzë & pranë liqenit.

Piktori – Artisti TASO ka derdhur me mjaft delikatesë dhe dashuri shpirtin e qytetit të tij të vogël provincial. Nga ky cikël i madh dhe në përgjithësi nga vepra e mjeshtrit - piktorit Anastas Kostandini, Taso, njihesh me jetën e përditëshme, zakonet, bisedat, thashethemet, dashuritë, dasmat dhe vdekjet. Piktori edhe pse pikturon në natyrë në vazhdimësi si dhe në studio, adhuroi dhe eksperimentoi sipas magjisë piktorike të mjeshtrave si: Picasso, Chagall, Leger, Durer të cilët pas viteve 1990 i kontaktoi direkt në muzetë e mëdhenj (Francë, SHBA, Hollandë, Gjermani, Itali etj).

Peizazhi për Tason është një formë e veçantë e komunikimit dhe e dialogut me publikun e tij. Në realizimin e tablove të qytetit të Pogradecit, TASO "zgjedh" dy mënyra të ndryshme e mjaft interesante shikimi. Një pjesë e vizatimeve të tij kanë "shijen" e realizimit të një piktori "poet" romantik të qytetit dhe natyrës, ndërsa në vizatimet e tjera arrijmë të "zbulojnë" qytetin tjetër ashtu siç vetëm artisti e njeh. Qyteti i tij, i cili nuk fle, por "gjallon heshturazi" me thashetheme, biseda e kontradikta, intriga e dashuriçka të fshehta, varfëri, magji e mister. Mënyra e vizatimit të rrugicave të lagjeve të qytetit të tij me detajet e çative me tjegulla, dyerve të vjetra, mureve me suva të rënë e shkallëve të drunjta të mbeshtetura në mur, ku flenë macet dhe maçokët nën diell, japin një kronikë realiste e magjike, të papritur që nuk e shohim në asnjë piktor



tjetër shqiptar. Peizazhi për Tason është një formë e veçantë e komunikimit dhe e dialogut artistik që ai bën çdo ditë me veten dhe me publikun e tij. Aty ai ka të plazmuar shpirtin e tij poetik, muzikalitetin dhe fantazisë krijuese në variacionet shprehëse që të entuziazmojnë. Pogradecin - Taso - e realizon me shumë dashuri e mjeshtri artistike, duke zbuluar hijeshinë, bukurinë e brishtë dhe magjinë e tij delikate. Pogradeci është memorizuar thellë në koshiencën e tij dhe në ekspozitë vemë re punime ku ai i ka lënë liri kujtesës, fantazisë dhe interpretimit modern & realist të jetës dhe arkitekturës së qytetit. Në realizimin e vizatimeve mbi qytetit të Pogradecit, Taso këtë herë na fton ta "zbulojnë" ashtu siç vetëm artisti e njeh dhe e ndërton qytetin e tij duke theksuar graficitetin e arkitekturës, apo dhe të personazheve të tij të shumtë që të krijojnë idenë e "boceteve kompozicionale". Në disa vizatime ai e rikrijon qytetin si në një skenografi teatri ku mund të gjesh të gjithë personazhet e dashur e të zgjedhur prej tij. Pogradeci, i cili duket i heshtur, i qetë dhe sikur fle, në fakt "gjallon" nën vizatimet magjike të mjeshtrit Taso. Pra 31 vizatimet e Tasos mund të konsiderohen dhe si: "Ditari i madh" - "Kujtesa" e qytetit, pasi nuk ka rrugë e rrugicë që të mos jetë vizatuar disa herë. Ekspozita e Tasos me titullin e veçantë: "NËNQYTETI", i jep vizitorit mundësinë e privilegjin që si në përralla të jetë në një qytet që tashmë ka "humbur" – nuk egziston më. Pra - mund të gjendesh papritur në Pogradecin e vogël e të qetë si dikur, por i bukur e i mbuluar me magjinë e peizazhit të tij unik. Artisti nuk është rastësi që e mendoi ta quante kështu ekspozitën e tij vetjake, pasi ai ka rikrijuar një "Qytet Përrallë" që duke shëtitur në rrugët e tij mund ta shohësh vizatimet në telefonin celular falë zhvillimit të sotëm të teknologjisë dhe bashkpunimit me vajzën e tij artisten konceptuale Ledia Kostandini. Patjetër aty ne zbulojmë shpirtin krijues të artistit, por nëse ndalojmë pak më gjatë në çdo vizatim të tij do të ndjejmë, apo më mirë do të zbulojmë përveç arkitekturës edhe "muzikalitetin" e poezinë e jetës së "fshehtë e të harruar" të banorëve të tyre. Në punimet e ndryshme të artistit Taso, që kanë përfshirë kryesisht të gjitha lagjet e vjetra dhe jetën e dikurshme të qytetit, do të ndjejmë mjaft qartë qëndrimin artistik, mbi të gjitha mjeshtrinë e tij si vizatues i klasit të parë dhe dashurinë e pafund që ai si piktor mban ndaj vendlindjes – Pogradecit. Vizatimet e Tasos mbi sipërfaqen e tyre janë „të mbuluara" me tinguj muzikorë dhe me dashurinë e një talenti të veçantë. Ekspozita shoqërohet dhe nga një Katalog cilësor i cili përfshin të gjitha vizatimet dhe shoqërohet me tekste mjaft interesante të disa autorëve: Ledia Kostandini, "Nënqyteti — një kalim i brishtë", Amanda Cici "Pëlhura e nënqytetit" dhe Dejvi Dauti "Midis përshkrimit dhe mbishkrimit: mjetet e memories grafike"

Tiranë më 16.07.2025

Rruga "24 Maji"

Xhamllëku / Berberhana

"...Në krye të rrugës "Naim Frashëri", aty ku dikur niste pazari i vjetër, rrinin rresht dyqanka të vogla prej druri. Të gjitha këto dyqane të improvizuara nisën të ngriheshin pak nga pak pas vitit 1943, kur pazari u dogj. Pikërisht në këtë zonë ishte berberhana e vogël, një qoshe plot gjallëri e humor. Batutat, thashethemet dhe humori i çliruar e bënin jetën më të durueshme për njerëzit e thjeshtë. Berberi njihej për pasionin ndaj vitrinave prej xhami, dhe ndoshta prandaj vendi u quajt më vonë "Xhamllëku". Prej andej mund të sodisje gjithë nyjën e qytetit, njerëzit që ndalonin për të blerë diçka, ata që ngrohnin shpatullat në diell, etj. Ishte një vend ideal për të parë e komentuar. Këtu, rrinin lloj-lloj personazhesh të veçantë për nga humori e temperamenti: Maqo Pelivani, llustraxhiu i vogël që këndonte me pasion teksa punonte. Gjorgji Gusho, një lloj shpikësi i lagjes, që përpiqej të lëshonte një "sputnik" në qiell. Sotir Zderja, gjithmonë i veshur shik dhe me humor të pashtershëm, ishte mjeshtër në ndërtimin e puseve të thella të ujit (çdo shtëpi kishte nga një që mbante vulën e tij)..."

Nga Taso

Burimi i Toplecit

Topleci dhe "Kroi i fshatit tonë" janë dy burime të afërta, të vendosura në të njëjtën lagje. Janë ujëra të lashta dhe të gjalla. Thuhet se fillimet e jetës së banuar në Pogradec kanë nisur që këndej. Ujërat rrjedhin ngado, madje edhe në themelet e shtëpive. Kështu është krijuar një intimitet i rrallë, ku komunikimi mes fqinjëve ndodh si brenda një familjeje. Dikur, uji rrëshqiste nëpër rrugica e derdhej në lumë. Edhe vetë lumi ka qenë po aq i pastër e i pijshëm sa burimet. Lagjja është e dendur me banesa të periudhave të ndryshme. Gjatë luftërave, këto rrugica kanë shërbyer si strehë për të fshehur, mbrojtur dhe mikpritur njerëz. Rruga e Toplecit sot ngjan me një oborr të madh shtëpie. Banorët ndjekin jetët e tyre të përditshme, me zakone, rituale dhe besëtytni. Dritaret, të shumta e përballë njëra-tjetrës, qëndrojnë pezull mbi ujë. Ajri është i freskët, i mbushur me aromën e pyllit të gështenjave, që nis vetëm pak më sipër.

Nga Taso

Rruga "24 Maji"

Mëhalla ime e dashur, dikur ishte plot gjallëri. Oborret e vogla ishin fushë-lojë, mikpritëse e bujare për gjithë shoqërinë gazmore të mëhallës, dhe jo vetëm. Në shtator, kur binte ai behari i vogël qytetar, ndodhte një tjetër ritëm i njohur: përgatitja e zahireve të dimrit. Petkat e trahanaja përgatiteshin me kujdes, traditë e thjeshtë që ndihmonte një jetë me pak mundësi. Gratë i shtronin petkat në tavolina, e i nxirrnin në rrugicë për t'i tharë në diell. Rrugica shndërrohej në një panair të gëzueshëm, plot aromë, diell dhe jetë. Personazhet e kësaj rruge ishin si figurat e një libri që vazhdon të shkruhet. Regjisori Tomo Mato sillte humorin e teatrit në përditshmëri. Një fotograf, një mekanik, një piktor, një plak që fliste pak, por mbante mend gjithçka, të gjithë jetonin aty. Ka ndodhur shumë: e bukura dhe e trishta, zhurma dhe heshtja. Sepse kjo rrugicë, e vogël sa për t'u harruar, është pikërisht ajo që të mëson rrugën e jetës: fillon me hapat e një fëmije dhe përfundon me hapin e një plaku.

Nga Taso

BALLSOR HOXHA

Kjo galaktikë tensioni

Tregim

... zgjidh jetën. Zgjidh një punë. Zgjidh karrierë. Zgjidh familjen. Zgjidh një televizor të qimë, zgjedh lavatriqe, vetura... zgjidh shëndet të mire, kolesterol të ultë, dhe sigurim dental...
(NGA FILMI TRANSPOTTING)

Sapo isha martuar, dhe blinim, blinim çdo gjë, por blinim edhe gjëra që na duheshin, si që, sapo kishim blerë dhe po e endnim me gruan, një lavatriqe, dhe pikërisht ndërsa po e vendosnim atë në këndin më të përshtatshëm në banjo, se si më vinte në mendje një kompleks, një çështje kyçe lidhur me gjërat që po bëj, dhe lavatriqja, krejt në absurd, mendoja, më dilte kryesorja në këtë çështje. Disi vezullonte e fanitej si figurë, në këtë vezullimë si aliene e kësaj jete të re, absurd. Por, edhe pyetesha, me shumë seriozitet, nga të qenit i përhumbur disi nga të gjitha gjërat e reja, dhe pasi ishte qetësuar vezullima e bardhë e lavatriqes, nëse jeta që jam duke bërë dhe aq më shumë duke e projektuar për ta jetuar, në martesë, është zgjedhje apo domosdo. Më përhihej, krejt nga larg, si njëlloj *junky* jetë, e re, në këtë jetën time, të re po ashtu. Paraprakisht martesës, së bashku me gruan e sapomartuar kemi qenë, edhe, kishim eksploruar edhe ne me droga. Por, ia arsyetoja vetes, kohë më parë kisha arritur kontratë të majme, jam mirë, po ecin punët mbarë, gjë që më bënte të kuptoj pse po blinim çdo gjë që shihnim, duke qenë se ishim të sigurt, së paku financiarisht në ardhmërinë tonë, gjë e rrallë në Kosovë. Pastaj, vazhdoja arsyetimin... kontrata kishte edhe sigurim dental... por përnjëherë kjo, beson ose jo, me të kujtuar sigurimin dental, sikur lavatriqja, në të vërtetë të dyja bashkë, sikur më zënë frymën disi në këtë përhumbje, më bëjnë të shoh të tërën si njëlloj bartje nomade e re, të zgjedhur, si premtim për jetë më të mirë, dhe, në këtë, i them vetes, ose e kam nga kolesteroli i lartë, jam majmur pak nga farmako-terapia, ose nga blerja e gjërave të reja në hapësirën jo aq të madhe por të mbushur tejmase me po të njëjtat. Në të vërtetë, sipas këtij arsyetimit tim që vazhdon, të dyshimit, dilemës, të cilën e kuptoja edhe si pasiguri e të sapomarturarit etj, në këtë nomadizëm të bartjes, endjes, e strehimit në një jetë të re, sipas një paranoje të lehtë e të errët që po më përfshinte, qoftë edhe kjo "arritja më e madhe" e imja, si martesa me të gjitha këto blerje, janë, vetëm, njëlloj shkyqje, refuzim, braktisje e tërheqje nga jeta vetë, dhe zgjedhje e jona. Televizori, lavatriqja, kolesteroli i ulët janë zgjedhje në fund të fundit. Ka edhe më ndryshe e ka edhe më mirë e edhe më keq në tërë këtë, dhe, mendoj, nën të zinë e paranojës, janë të gjitha zgjedhje, edhe më e keqja jetë (mu sikur që kishte thënë Paris Hilton – të varfër ndaloni të jeni të varfër), por, si zgjedhje më e mirë, mendoja krejt i kurthuar në paranojë.

Lavatriqen, me shportën e re të shtrenjtë të mbeturinave, me mbajtësen krejt origjinale të letrës së tualetit, e me shumë gjëra të mëdha e të vogla në tualetin tonë të ri, në banesën e re në martesën e re, e pse jo edhe të jetës së re, tashmë i kishim vendosur përgjithmonë, si që vendosen gjërat, e mobiliet në shtëpi, e si që ndodh në shtëpi, e në martesë, çdo gjë, përgjithmonë. Jetonim, kalonte koha, kënaqeshim, ndërsa e errëta paranoja e lehtë, rrallë përhapej e shpërhapej në mua, në çdo gjë që bëja, por kishte krisur krejt fuqishëm e ndjeshëm dhe thellë, kur kisha kontraktuar implantimin e disa dhëmbëve të rinj me një dentist të njohur, sigurisht përmes sigurimit shëndetësor nga kontrata e majme e punës, kisha pasur një krizë, krejt të ndjeshme, gati se të rënë të fikët, sepse, ndërsa, dentisti më kishte pyetur nëse do të zgjedhja ndërmjet implanteve të përimtuara, (kishte thënë disi kështu sepse nuk e kuptoja dhe aq mirë), apo të zgjedhja implante estetike, artistike, më ishte kthyer ajo paqëndrueshmëria nga post efekti i drogave, si *flashback*. Të them drejt, unë edhe besoj në gjëra të argumentuara dhe të bukura por edhe të çmendura si sinkronia sipas psikologut të njohur Jung, dhe edhe më ndodhin që nga eksplorimet me droga, këto sinkroni, por, ndërsa po pija kafen duke pritur radhën në klinikën e dentistit, kisha qenë duke menduar se si, për të zgjidhur paranojën e errtë dhe të lehtë nga pasiguria prej filleve të martesës, po përimtoja mundësitë, e me këtë zgjedhjet. Po mendoja saktë kështu "Le ta marrim në konsiderim se zgjedhja në përimtimin e jetës në individë po ashtu të përimtuar, që jemi unë e gruaja ime, me gjithë teprinë e kësaj të thëne, është vetë përimtimi i zgjedhjes. Apo për ta thënë saktë, përimtimi i njeriut në zgjedhje. Por ka edhe një konsideratë tjetër këtu, që e vë në kundërshti, paradoks, vetë filozofinë ekzistencialiste mbi – zgjedhjen -, e ajo është parimi i kënaqësisë. Sipas këtij parimi ne jemi me automatizëm, të gjithë *Junky*, jemi të gjithë luftëtarë terroristë, dhe atë në kërkim të kënaqësisë së besimit terrorist. Në këtë arsyetim timin të – përimtimit të zgjedhjes – me të cilën mundohesha të shpëtoj veten nga paranoja e fillimit të martesës, më dilnin të gjithë bashkë, terroristët të cilëve po i bashkoheshin kosovarë të mjerë, *junky*, e unë me gruan time, dentisti e qeni që sapo kemi blerë në banesën tonë të të sapomartuarve, jemi, dhe janë kërkim dhe përmbushje për kënaqësi". Ndalem dhe mendoj, kjo është të menduar i çmendur paranojë.

Ditët kalonin, martesa po bëhej, që do të thotë në seks gjenim gjëra dhe pozita të reja, në gatim kishim atë 'përimtimin" e individit, herë duke gatuar ajo, gjëra, e herë unë, po bëhej martesa. Por, po bëhej edhe paranoja, tashmë e saktësimit të të pas zgjedhurit të kësaj ikje nomade të re, pikërisht në martesë, në vallëzimin e gjërave që blinim e bënim në martesë, edhe kënaqësia, si shenjë e re përmbajtjeje të paranojës time, por, si varësi, si pamundësi ikjeje, askund në botë, pa qoftë agun e mugët të netëve si *junky* që i kisha kaluar në jetën e braktisur kohë më herët. Hyja në shtjellime aq të thella, serioze, të rrezikshme, sa që më habiste një njohuri e re e imja në këto gjëra, që dilte nga kjo e errtë e paranojës. Kësaj paqëndrueshmërie të jetës, së re, ta quaj. "Le ta marrim në konsiderim" thosha dhe filloja këto shtjellime gjithmonë me një 'Le ta marrim në konsiderim...', "luftën, në të vërtetë Xhihadin jo atë religjioz, por të terroristëve, për të luftuar në Siri dhe Irak. Persona krejtësisht të thjeshtë në jetët e tyre, të zakonshëm në bindjet e tyre, ngritur nga, le të themi, Kaçaniku me gra e fëmijë për të shkuar në po këto vende. Në një mohim të shumfishmërisë së interpretimeve, dhe sidomos të dhunës në relacion direkt me bindjen e kësaj fryme, kjo është gati se identike me revolucionin në Spanjë për rrënimin e fashizmit atje".

"Le ta marrim", pastaj vazhdoja net të gjata e të ngadalshme në jetët tona që kishin filluar të kalonin në përditshmëri, vazhdoja tutje, zakonisht, si netët kur nata ishte e rrezikshme pikërisht për shkak të të qenit pazakonshëm e qetë, net pa probleme me gruan, gjëra që kishin filluar të ndodhnin në masë të madhe në martesën tonë, në të vërtetë ajo më akuzonte tërë kohën me "të qenit i vetmuar timin deri në humbamendje..., dhe më ndëshkonte me ndalim apo refuzim të seksit, këtë natë, këto net sidoqoftë, unë vazhdoja "Le ta marrim në konsiderim, atë që njihet edhe në sociologji, si – reatreatism – (mënyrë jete e tërhequr përmes drogave, kryesisht), i *drogirashave*, *heroinashëve*", *Junky*, etj. Me një fjalë atyre që me zgjedhjen e tyre vendosin të jetojnë një jetë të shkyçur, të shkëputur dhe të veçantë prej globales dhe universales. Dhe vazhdoja, sikur në ndonjë ligjeratë, le të pyesim këtu, çka kanë të përbashkët këto dy lloje të të jetuarit, atij sipas frymës së terroristëve dhe të *reatreatism*? Duke e vazhduar këtë konsideratë, të pyetemi rreth diçka që është krejtësisht dhe rrënjësisht blasfemuese: se ka diçka aq të ngjashme dhe aq të mohuar (blasfemuese) ndërmjet faljes në kolektiv dhe vallëzimit në një klub nate. Një kolektivizim i qeniesimit, por vetëm përmes thellimit të personales - dhe sa më e thellë personalja aq më e madhe - përmbushja/kënaqësia -. Aq më shumë që vallëzimi në klub tanimë ka marrë edhe trajtën më ekstreme të tij. Atë të të varurve nga heroina të cilët e bëjnë këtë me vetëdije, me administrim dhe me qëllim, gjë që edhe ka arritur pikërisht tek ajo që e morra në konsiderim si *reatreatism*".

Gjërat, më pengonin, më pengonte e qara e foshnjave, e qeshura e tyre, më pengonte vetura ime e shtrenjtë, e madhe dhe e gjerë, sepse nuk kisha ku ta parkoja dhe ishte tejet vështirë të manovroje me të, më pengonte edhe tërheqja seksuale që kisha ndaj asistentes në punë, gjinjtë e mëdhenj joshës e më ngjanin përplot qumësht epshi që do të derdhej secilin moment, e shihja në ëndërr, e ëndërroja në pritje në kolonat e pafundme të trafikut, e shihja në fytyrat e grave rrugës, secilës, më pengonte edhe më shumë gruaja ime, seks nuk bënim, por tani, ajo blinte, unë prej reflektimeve të mia, kisha filluar të përmbahem, nga shfrimi në jetë mundësuar nga kënaqësia e çdo gjëje, përmbahesha nga kacafytja më së shumti me njerëz, rrugës, njohur e panjohur, e sidomos me hoxhën që në vendin e punës ku punoja thërriste lutjen në mesditë me një zë krejt të dashur e disi të mjaftuar në vete, sikur të ishte i mjaftuar me jetën e tij, me Zotin e tij, e me të gjitha, "Le ta marrim në konsiderim", vazhdoja të reflektoj për gjërat që i reflektoja tërë kohën në të vërtetë, dhe kisha vazhduar tutje duke blasfemuar ndërmjet agjërimit dhe *reatreatism*, "më tutje në një mënyrë, dhe në një konsideratë më tutje, agjërimi dhe *reatreatism* (tërheqje ose strehë) kanë një gjë të përbashkët: kënaqësinë nga të abstenuarit nga jeta aktuale. Është paradoksale, derisa religjioni ka për qëllim pastërtinë morale dhe arritjen e një jete me qëllime më të larta, të ketë të përbashkëta me përdoruesit e heroinës. Por, edhe përdoruesit e heroinës e shohin veten brenda asaj që është quajtur në sociologji *reatreatism* pra njëlloj agjërimi prej aktuales, për qëllime revolte dhe rebelimi ndaj po të njëjtave. Shikuar nga prizmi i kënaqësisë, njeriu merr kënaqësi në çdo gjë në jetë: prej të pirit ujë, injektimi i heroinës dhe deri tek të qenit luftëtar në Siri. Por, është, edhe, një pyetje krejtësisht e tmerrshme, si mund të jetë kënaqësia nga heroina, kënaqësi? Apo, për të qenë edhe më të guximshëm të shtrojmë pyetjen kryesore: nëse ke marrë pjesë në luftë, apo në luftën e Sirisë nën besimin, bindjen dhe bashkëqeniesimin se do të arrish dhe aq më shumë ke arritur parajsën, e ke siguruar atë, a mund të ketë diçka më të fundme se kjo? Cili është dallimi ndërmjet kënaqësisë religjioze sipas terroristëve, dhe kënaqësisë nga heroina, në momentin më aktual. A nuk është po e njëjta kënaqësi që e shndërron disi njeriun deri në një zgjedhje të fundme, prej të cilës më nuk ka kthim."

Sytë të mpirë tanimë, bashkë me shpirtn, disi mbetur në vëmendjen time krahu i majtë i rënë nga mbajtësja e kauçit, si gjë në vdekje e sipër, qeni i rritur tanimë i rënë në depresion për mungesë loje, një nga netët, pasi që kisha gjetur pak qetësi, të cilës, çuditërisht nuk i frikësohesha, as nga e cila nuk kisha ndonjë shqetësim, po shikoja filmin e regjisorit Jim Jarmusch, "Only lovers left alive", ndërsa filmi shfaqte një grup prej tre vampirësh, që kishin jetuar nëpër gati se të gjitha epokat e civilizimit të njerëzimit, e jetonin edhe sot, duke siguruar gjakun e domosdoshëm për jetën e tyre nga laboratorë të gjakut, dhe që ishin vampirë krejtësisht human, duke u përmbajtur nga gjakpirja e njerëzve të gjallë, unë në të vërtetë e shihja tërë filmin si vampirësi të njeriut për kënaqësi. Filmi, në tërë bukurinë e tij, të cilën e kapja rrallë për shkak të mpirjes së mendjes sime, metaforizonte në një mënyrë diçka si të ishte bukuria e kësaj jete, e qeniesuar, apo shikuar nga vampirët. Por gruaja, kishte vendosur të dilte. Ishte paksa vonë, e dija edhe për lidhjen që kishte filluar me një kasap, nga të gjithë burrat e mundshëm, lidhja e saj ishte një kasap. Dhe, sigurisht, edhe i qetë, por edhe i mësuar me daljet e saj me kasapin, ndërsa unë ëndërroja asistenten time në gjumë e në jetë, filloj, "Le ta marrim në konsiderim të abstenuarit përmes asaj që quhet agjërim (gjë që nuk i përket vetëm religjionit të fesë Islame por është pjesë e të gjitha religjioneve që ekzistojnë, dhe për më shumë, forma shumë më rigoroze njihen në religjione të tjera) apo të "abstenuarit" nga qëllimet e jetës aktuale përmes të konsumuarit të heroinës, nga prizmi i hedonizmit, krijon në të dy rastet *dehje* të administruar. Dhe nuk është problemi tek të qenit i dehur (*high*) nën cilëndo influencë - kjo është fjalë e shkëputur nga terminologjia, shkencore e mjekësore që do të thotë "high energy" por problemi është në atë që kjo *high* konoton tek njeriu.

Të qenit *high* nën influencën e heroinës, apo nën administrimin e kësaj substance, për aq sa zgjatë, është status tej konvencionales që konoton përvojë të pashembullt.

Të qenit *high* nën adrenalinën e luftës në Siri është po ashtu status që konfirmon përvojë të pashembullt nën administrimin e religjionit (sigurisht tmerrësisht të keqkuptuar). Është status tej konvencionales. Është status i të qenit më i thellë në çdo gjë, dhe status që konfirmon një pozicion të pakthyeshëm (lexo: të paarritshëm) të njeriut.

Dhe, është paradoksale, të dyja, edhe pjesëmarrja në luftën në Siri p.sh., edhe pjesëmarrja në luftën kundër komercializmit pra "retreatism", kanë të njëjtin qëllim: refuzimin e aktualitetit bashkëkohor.

Dhe edhe më paradoksale është ngjashmëria në atë se në të dyja jeta aktuale është sekondare, në raport me jetën shpirtërore të personit religjioz dhe të *Junky*. Në përvojën e personit religjioz ne të tjerët jemi të gjithë "qafirë" sipërfaqësor që së shpejti do të digjemi në zjarrin e kiametit të afërm, dhe në përvojën e *Junky* ne jemi tërësisht "zombie" sipërfaqësor që kënaqemi në "junk" (bërllokun) e komercializmit. Por në të dyja ne, që jetojmë aktualen, jemi të padijshëm për kënaqësitë e "asaj" bote. Dhe mu këtu buron shtresa e statusit të paprekshëm të tyre, në mosdijen tonë ndaj, dhe në përvojën e tyre", kisha përfunduar i zgjuar tashmë nga mpirja prej frymëzimit që më jepte ky reflektim imi.

Ka një gëzim, pas një kohe të gjatë në jetën tonë me gruan time, ajo e lodhur me kasapin e saj, nga lidhja e tyre, dhe unë duke pas kaluar nëpër miliona projektime seksuale fizike të asistentes, dhe asistentja më në fund edhe ishte martuar e kishte emigruar në Shtutgart, kishim vendosur, që të zgjidhnim, them të zgjedhurit e kësaj jete, do të ishte, zgjedhja më e mirë përmes të pasurit e një fëmije në martesën tonë, të kishim fëmijë, ishte zgjedhja jonë. Bënim seks, shpesh, e pafre, të zgjidhur disi kompleksesh e dhembjesh të të pas qenit të kufizuar në jetën e kaluar, apo me premtimin se do të bëheshim njerëz të kësaj galaktike, me të lindurit të një fëmije. "Nomad?!", për një moment, ndërsa po zgjidhnim rroba për vajzën tonë që ishte në muajin e shtatë të shtatzënisë së gruas, po zgjidhnim emrin, dhe jetën e ardhshme të saj, kisha dëgjuar t'i them vetes, pikërisht aty. Pa një pa dy, të njëjtën natë të kësaj dite zgjedhjesh, i isha kthyer pas disa viteve, në momentin e lënë të reflektimit tim, dhe kisha vazhduar, shtrirë në krevat me listën e këngëve të zgjedhura, si prindër të kujdesshëm, për të na mbajtur në frymën e të kaluarit në prindër, "Le ta marrim në konsiderim se ka një të metë në të dyja, nëse ju kujtohet nga reflektimi i fundit" po i thosha vetes në shumës, dhe vazhdoja "në agjërim përmes besimit, dhe në agjërim përmes kënaqësisë së heroinës, dhe, në të gjitha ekstazat: kur besohet ëndrra dhe përfundon realiteti. Apo kur i tërë realiteti është sakrifikuar në kurriz të ëndrrës." Pastaj, në po të njëjtën natë, kisha ndalë muzikën, shumë serioz, pa një pa dy e kisha lexu, tërë shembullin markant të kësaj, që është, autobiografinë e Thomas De Quincey "Confessions of an opium eater", një rrëfim personal i harrimit të aktuales dhe përfundimit në ferr, e që është si në të gjitha ekstazat, dhe të gjithë, si njeriu i religjionit dhe ai i *reatreatism*. Nëse *reatreatism* është, edhe kjo, po ashtu, vetë-zgjedhje; pastaj edhe zgjedhja për të terrorizuar njeriu njeriun në emër të religjionit si vetë-zgjidhje (me qenë se religjioni në të vërtetë e ndalon këtë), ndoshta këtu flitet për kënaqësinë, kënaqësinë prej dhunës dhe prej shkyçjes, jo si përvojë njerëzore, por ndoshta edhe si njëlloj influence, apo në këto dy raste, tërësisht ekstreme, si njëlloj braktisje ekstreme, dhe, aq më shumë, amputim, kolektiv si i terroristëve, i të ndryshmes, qoftë edhe si e njohur, por edhe për të shkyçurit e *reatreatism*". Dhe këtu kisha lëshuar prapë muzikën, herët në ag tashmë, herët në agun e jetës sime të perënduar në të gjitha zgjedhjet, dhe pamundësinë për t'u ikur, duke përfunduar, atë paranojën e errtë të lehtë, të thelluar zi përjetë, tanimë. "Kjo ngjanë si njëlloj frike nga kënaqësia, në të dyja këto masa sociologjike: jashtë, të përbashkëtës, jetës, të ikurit në këto ekstreme, dhe brenda në atë që shndërrohet në ekstrem".

Në lumturinë, dhe herë herë ankthin, e ardhjes së përgjegjësisë prindërore, po të njëjtin mëngjes, kisha braktisur, sidomos këtë fushë të pasionit tim, të të qenit i punësuar dhe të vëzhguarit të gjërave, të gjithave. Dhe kur e pyes veten pse dhe si, e tëra më del në atë vezullimën e lavatriqes së sapo blerë në fillim të martesës sonë.

FREDERIK RRESHPJA, SHKRIMTARI PËRTEJ MELANKOLISË DHE TRISHTIMIT

Nga Jola Tasellari



Në historinë e letërsisë shqipe, pak zëra kanë mbetur kaq të ngjizur me përfytyrimin e trishtimit poetik sa ai i Frederik Rreshpjes. Emri i tij mbart me vete hijeshinë e errët, melankolinë e trishtimin, që shpesh janë parë si damka dalluese e krijimtarisë së tij. Poezia e Rreshpjes, e mbushur me imazhe të mjegullta, figura dhe ndjeshmëri gati onirike, ka ushqyer për vite me radhë një mit të ndërtuar mbi personalen e tij; atë të poetit të vetmuar, të përmalluar, që di të flasë gjuhën e dhimbjes. Por përtej këtij imazhi të ngrirë, Rreshpja përbën një univers më kompleks, shumëdimensional. Ai nuk ishte vetëm poet i përhumbur në trishtim, por edhe shkrimtar me ndjeshmëri të hollë për botën e fëmijëve, për brishtësinë dhe metafizikën e pafajësisë. E pikërisht kështu e kujtojmë sot Frederik Rreshpjen, jo vetëm si poetin e trishtimit, por si shkrimtarin përtej tij.

Një tjetër Rreshpje: zëri i butë i letërsisë për fëmijë.

Në një lexim më të kujdesshëm të korpusit letrar që shkrimtari na ka lënë pas, na shfaqet edhe një Rreshpje tjetër, më pak i njohur: Rreshpja si autor i letërsisë për fëmijë. Ndonëse pjesa më e madhe e vëmendjes kritike është përqendruar tek lirika e tij melankolike, më pak janë ndalur tek përrallat e tij apo tregimet për fëmijë, që ndonëse nuk i kanë shpëtuar universit tematik popullor, mbartin në vetvete tipare të poetikës së veçantë të shkrimtarit.

"Eranda ishte një vajzë e vogël, por trime, një arbëreshë e vërtetë, e cila jetonte diku mes maleve të Matit. Historianët nuk thonë asgjë për ngjarjet e këtij tregimi. Po është një këngë e lashtë që tregon për këtë. Është aq e lashtë sa gjyshërit nuk dinë të rrëfejnë se kush e thuri."[1]

"Eranda" është më shumë sesa thjesht një tekst për fëmijë. Ajo është një rrëfenjë e brishtë, e mbështjellë magjishëm me copëza nga folklori ynë, që mbart struktura klasike të ndërtimit të përrallës, por përmes një gjuhe të kristaltë, fëmijërore dhe ndjeshmërisë që - për lexuesin besnik të Rreshpjes - është prekja e tij. Ç'vlerë ka për ne fakti se një shkrimtar si Rreshpja, i përndjekur nga vuajtja dhe përjashtimi i kohës shkruan për botën e fëmijëve? Tregimi është botuar në vitin 1968, shumë më përpara se ai të dënohej e arrestohej. Pikërisht këtu nis të çahet miti i poetikës së tij të trishtimit të përhershëm. "Eranda" nuk përbën thjesht një përjashtim nga pjesa tjetër e krijimtarisë së tij, por një zgjatim të saj, një dëshmi se motivet letrare janë të kontekstualizueshme.

Është e rëndësishme të kuptojmë se për Rreshpjen, fëmijëria nuk është vetëm një fazë e jetës, por një territor poetik. Edhe në poetikën e tij, fëmija, nëna, kujtimet e para, ato janë të vijueshme. Kështu, edhe "Eranda" nuk është një largim nga poezia e tij, por një tjetërsim i saj në një regjistër tjetër. Ai e rikthen fëmijërinë jo vetëm si përfytyrim, por edhe si një formë ligjërimi.

Frederik Rreshpja është padyshim një nga figurat më të vështira për të guxuar ta përmbledhësh në një kategori të vetme. Poeti i përmalluar, romantiku i vonë, melankoliku i poezisë moderne shqiptare; ndonëse të vërteta, këto nuk janë të mjaftueshme. Ai dinte dhe mundi të shkruante edhe për dritën, përmes vëllimeve si "Aventura e fundit e Gishtos" apo "Trofta hutaqe", për botën e fëmijëve, të njihte dhe vlerësonte naivitetin letrar fëmijëror, ta rafinonte gjuhën e tij drejt përshtatjes, duke na ftuar edhe në *tejkohësinë* e tij për rilexim, për reflektim dhe një kontakt të ri me një fragment të beftë të krijimtarisë së Rreshpjes, atë për fëmijë.

"*Këtu kënga mbaron. Ndoshta kënga qe më e gjatë, por vargjet humbën nëpër mote.*"[2]

[1] "Eranda", Frederik Rreshpja, fq. 1, Biblioteka e Fatosit, Tiranë, 1968.

[2] "Eranda", Frederik Rreshpja, Biblioteka e Fatosit, Tiranë, 1968.



IMRI DEMISAI

një thirrje e largët

NJË THIRRJE E LARGËT

*-Nënës heroinë Lutfie Labënishti**

Vdiq një grua, një nënë, një motër;
Si erë e lehtë vrapo në korije.
Në Ladorisht e kishte gjithë botën,
Thellë në zemër një sëmbim lirie,

Kishte dy orë për ta matur kohën,
Dritën e burgut dhe hijen e lisit;
Ishin të rrallë ata që s'e njohën,
Për krenarinë dhe emrin e fisit.

Dje vdiq një grua, ashti siç vdiset,
I mblodhi pranë zogjtë shtegtarë;
E dinte mirë se duhet të niset,
Të fluturojë larg, sa më parë.

Sa gjatë e priti atë komisari,
Ai që thirrjes kurrë s'i bëri lak;
Sot paska dalë ta takojë i pari,
Pas kaq vitesh të çmallen pak.

Ta pyesë, bletët a janë shtuar,
Si do jetë mjalti në qershor.
Grerat s'qenkan egërsuar,
S'ka autoblinda në oborr.

(Goteborg, 27 Maj 2025)

GRUA E PANJOHUR

Grua e panjohur, me tërë atë nur,
Kush të pikturoi, të vari në mur?
Nga degët e fisit të rëndon një hije,
E ke dhe bekimin, dritë dashurie.

Të shoh të menduar. Shikimin përdhe,
Çfar' ke përjetuar, mua m'i rrëfe.
Grua e panjohur e shkrirë në vaj,
Përse rri kështu si e zënë në faj?

A thua sërish me burrin je grindur,
A e qanë dështimin, barrën e palindur?
Ndoshta yt shoq të ka prek' në sedër,
Të ka lënë mënjanë, ka gjetur një tjetër?

Grua e panjohur, e bukur si hënë,
Uroj të kesh fatin, të jesh edhe nënë.
Paskëtaj, të lutem, mos mërzitesh kurrë,
Se ti je dyfish më shumë se një burrë.

Në një atelie, më çoi fati mua,
Të joshem papritur nga hiret e tua.
Grua e panjohur, kudo që të jesh,
Që sot ne e kemi një lidhje mes nesh.

NËNË E BIR

Lëshomë mami, lëshomë!
Ty në zemër do të t'mbaj.
S'jam më i mitur, bekomë,
Se babait dua t'i ngjaj.

Më rriti gjiri yt i ngrohtë
Me aq shumë dashuri,
Tani, fati më ndihmoftë
Ta gjej një nuse si ti.

Unë për jetë do të t'ua,
Me ty nuk shpaguhem kurrë,
Po tani lëshomë mua,
Nëse do të bëhem burrë.

-Të kuptoj, o shpirt i mamit,
Vogëlushi mendjemprehtë.
Ti i di trillet e babit,
Kjo që thua s'është e lehtë.

Nuk ma do zemra
Të të shohë katandisur si ai.
Mbrëmjeve mezi e njoh,
Te parku kur pi raki.

Nuk kam dashur të mërzitesh,
S'të kam lënë ta takosh vetë.
Prit edhe pak sa të rritesh,
Vitet ikin shpejt e shpejt.

Bekomë, mami, se ika
Dhe nuk ke për të më gjetur.
Nëse më ndalon nga frika,
Do të vijë një ditë i dehur.

Do trokas te porta jote,
Do të shaj si shan Ai
Dhe nga helmi i asaj gote
Do të bëj të pish dhe ti.

Ta kuptosh se çdo të thotë
Deg' e gjakut për një djalë.
Nuk ka tjetër gjë në botë,
As nuk thuhet dot me fjalë.

Biri im, e paç uratën,
Ty të priftë fat i ndritur.
Të më ndjesh mua të ngratën,
Unë këtë s'e kisha ditur.

Qoftë i nderuar yt atë,
Atë s'do ta shaj më kurrë.
Prit të të jap një dhuratë,
Se ti sot u bëre burrë.

SHËNIM I POETIT RESUL SHABANI

*) Vdekja tinëzare nuk priti as edhe 60 ditë, që Nëna e Madhe Lutfie Labënishti (21 Korrik 1940-26 Maj 2025), bashkë me familjarët e saj, ta kremtonte 85 vjetorin e lindjes. Mbase me këtë rast do t'i kujtonte dhe do t'ia kujtonin momentet e gëzuara, por edhe ato të trishtuara të jetës së saj. Nëna Luftie do t'i sillte ndërmend çastet e lumtura, por edhe të trishta me bashkëshortin e saj, veprimtarin dhe të burgosurin politik, Kadri Labënishti; luftën e saj për emancipimin e femrës shqiptare të këtyre anëve; kujdesin e veçantë për familjen e nëpërkëmbur e të përndjekur nga shoqëria; përkujdesjen për veprimtarët e çështjes kombëtare, duke shndërruar shtëpinë e saj në vatër të ngrohtë e të sigurt për luftëtarët e lirisë dhe të barazisë. Ishte kjo Nëna Heroinë që më 15 Qershor të vitit 1992, doli në mbrojtje të pragut dhe familjes së saj me ç'kishte në dorë, para 1200 policëve maqedonas, të cilët, me pretekstin e ndalimit të hapjes së shkollës së mesme në gjuhën shqipe në Ladorisht, mbollën tmerr në tërë fshatin, duke bastisur, plaçkitur e shembur edhe shtëpitë, siç ishte rasti me shtëpinë e poetit Lebit Murtishi, veprimtarit Verdat Kolonja, etj. Nga mllefi, të shoqëruar nga gjashtë autoblinda, arrestuan tërë familjen e Nënës Luftie, bile edhe foshnjën 5 javësh. Bashkë me tmerrin, lanë edhe dy gjurmë plumbash në portën e oborrit dhe u larguan si "triumfatorë", për të vazhduar "misionin" antishqiptar edhe në Biti Pazar të Shkupit, në Gostivar et., etj., Dhe populli i Ladorishtit, Strugës dhe më gjerë, ia shpërbleu këtë kontribut kësaj Nëne me pjesëmarrjen masovike në përcjellën për në banesën e fundit. Kujtimin dhe respektin për të popullata shqiptare do ta ruajë deri në amshim. Ka shumë të ngjarë që ky sulm barbar mbi familjen Labinishti, rrënjët do t'i ketë tek mllefi dhe vreri i grumbulluar për hakmarrje, shumë më herët, meqë njëri nga kryefamiljarët, Murat Labënishti (1909-1946), ishte një patriot, intelektual, filozof, student i Sorbonës, politikan, komandant i çetave të forcave të rezistencës kombëtare të Strugës, që për ideal kishte Shqipërinë Etnike. Në kohën e Mbretërisë ishte nëpunës i lartë në Nënprefekturën e Peqinit, kurse më 1944, ishte kryetar i Nënprefekturës së Strugës. Gjyqi Ushtarak i Maqedonisë e dënoi me 101 vjet burg, kurse ai i Beogradit me vdekje. Dhe për ironi të fatit – e vrasin komunistët shqiptar të Lumës. Murati është poeti i parë i Strugës, nëse nuk e pranojmë hipotezën e poetit dhe profesorit Latif Berisha, i cili thotë se poeti arbëresh Zef Serembe, ka prejardhje strugane.

Poeti dhe mjeku strugan Imri DEMISAI, i cili e njihte së afërmi Nënë Luftien, nuk mund ta qetësonte ndryshe shpirtin lirik, pa i kushtuar poezinë NJË THIRRJE E LARGËT, të cilën e sjellim këtu për lexuesin shqiptar.

ARTUR BAKU

Zero absolute

Tregim

Ora 23.30, 31 dhjetor. U ul i vetëm në tavolinë me një fletë të bardhë dhe laps në dorë. Dritat e rrugës reflektonin brenda kthinës së apartamentit. Edhe këtë fundviti bëri ritualin e përvitshëm: bilancin financiar! Filloi të shkruante një listë me shpenzimet që kishte bërë gjatë gjithë atij viti. Ato që për një buxhet si i tij quhen shpenzime luksi.

Filloi me udhëtimin në Paris. Një qytet që kishte ëndërruar ta vizitonte prej vitesh. Kishte kaluar disa ditë duke zbuluar rrugët, kafenetë në lagjet e Montmartre-it, duke u ndalur për një croissant në mëngjes, për një gotë verë në mbrëmje buzë Senës. Çdo cep mbante peshën e shekujve. (Lexuesi mund të thotë: është frazë klishe. Edhe klishetë janë pjesë e jetës, i dashur lexues. Ndiq rrëfimin, të lutem). Numëroi biletat e muzeve Luvri, Orsay, Pompidou, kafenetë dhe restorantet që kishte frekuentuar, shpenzimet për hotelin. Mendoi: vlera e Parisit nuk qëndronte thjesht në faturat; ishte ajo ndjesi e veçantë që ta mbushte shpirtin me një lëndë të padukshme dhe mendja kthehej mbrapa në kohë. Shënoi një shifër të rrumbullakosur.

Kaloi te pika e dytë e listës së shpenzimeve: një pelegrinazh në një vend të shenjtë. Kishte kaluar orë të tëra në rresht, mes mijëra njerëzve, duke pritur të shprehte lutjet e tij. Kishte ndier një paqe të brendshme, një ndjenjë se ishte pjesë e diçkaje më të madhe, më të thellë, që shkonte përtej tij. Sa vlerë kishte kjo? A mund të këmbehej ajo paqe në para? Sa vlente në kursin ditor të këmbimit një lutje ku njeriu i dorëzohet një force madhore? U përpoq të maste minutat që kishte kaluar në heshtje dhe në lutje, në gjunjë, në atë vend të shenjtë. Në fund, ia doli duke i dhanë atij momenti një vlerë. Një çmim të rëndësishëm për shpirtin... një shtatë me disa zero pas...

Lista vazhdonte me një shfaqje teatri që kishte parë para ca muajsh. Kishte marrë avionin nga qyteti i tij për në qytetin e teatrit. Kishte mbërritur një ditë para premierës së dramës The Flick, me autore Annie Baker. Subjekti i shfaqjes ishte minimalist: tre të rinj punojnë në një kinema të vjetër që po i afrohet fundit të epokës së filmave me rrotulla. Gjatë orëve të gjata të punës së tyre të zakonshme, pastrimit të sallës, drejtimit të projektorit, rregullimit të audios, ata ndajnë momente të heshtura, tensioni në përpjekje për të kuptuar njëri-tjetrin. Si ndikojnë ndryshimet teknologjike në ndjenjat e tyre... Atë mbrëmje, ulur aty, në errësirë, kishte ndier emocione të një vepre që ngjante me fragmente nga jeta e tij. Përpiqej të bënte llogaritë: çmimi i biletës, shpenzimet për transport, orët e kaluara në pritje, kthimi. Mbi të gjitha, pyeste veten: sa vlen kjo? Sa mund të kushtojë galdimi i një momenti, apo dhimbja e një skene që ngjall kujtime të fjetura? Në fund, vendosi një numër...

Galeria e artit ishte shpenzimi i radhës. Një ekspozitë që e kishte lënë pa frymë. Ngjyrat, format, idetë e fiksuara në piktura dhe skulptura. Kishte shpenzuar para për biletë, për katalogun, madje edhe për një suvenir të vogël. Përpiqej të kuptonte diçka më të thellë: sa vlen një eksperiencë që të zhbirilon mendjen dhe të detyron ta shohësh botën ndryshe? Sa mund të kushtojë një moment i tillë? Këto pyetje i vinin pa përgjigje të qarta. Gjithsesi, e vendosi një numër. Sa më e gjatë bëhej lista, aq më të gjata bëheshin vargjet e zerove.

Kaloi te ndeshja e futbollit. Ulur në stadium, mes mijëra tifozëve, duke brohoritur ndërsa ndjehej pjesë e diçkaje përtej sportit. Llogariti biletën, ushqimet, pijet, kohën që kishte humbur apo fituar duke u argëtuar. Ishte një llogari që mund të bëhej lehtë pa dert. Nuk e kishte të vështirë; për një ndeshje futbolli e vendosi një shifër pa pishman.

Në fund, erdhi ajo: përpiqej të llogariste atë që kishte ndierë. Sa vlente ajo dashuri? Sa vlenin bisedat e pafundme në darkë? Sa vlente secili moment i puthjeve, i buzëqeshjeve, i dhimbjes? Mëtonte të llogariste sa kohë kishte kaluar duke e menduar, duke ndjerë mungesën e saj. Sa zero mund ta mbushnin atë hon që tani derdhej thik mes tyre?

Sytë i mbetën të fiksuar mbi fletën e bardhë, lapsi i rëndonte në dorë. Filloi të shkruante një nëntë me disa zero që e ndiqnin si vagonë treni. Shtoi zero..., zero..., zero..., zero..., zero..., zero..., zero të tjera, filloi kryeradhën me zero derisa kaloi në faqen tjetër ku gjithçka ishte e bardhë pa asnjë shenjë... ngriti kokën. Dritat e qytetit kishin filluar të zbeheshin. Nga dritarja që shihte atë pjezës qielli që i kishte rënë për hise, shqoi një yll që pulsonte. Një pikë drite që kishte miliarda vite që ndriçonte falas mbi botë... Një pikë drite që ajgëtonte paq mbi vetminë e botës... si zero absolute.

Një nga gazetat më të mëdha italiane, "Avvenire", e dates 14 qershor 2025, në penën e Gianni Santamaria, kryeredaktor i suplementit letrar, shkruan për romanin "Në emër të nënës dhe të birit".

Në emër të nënës dhe të birit – Rrëfim i Besnik Mustafaj

Nga Gianni Santamaria

Kjo është historia e një gruaje – jo në kuptimin figurativ, por në kuptimin e parë të fjalës.

Ngjarja fillon në vitin 1959. S. është një grua malësore, pa arsimim, që jeton në veri të Shqipërisë, pranë kufirit me Jugosllavinë. Ajo nuk merret me politikë; jeta e saj përqendrohet në shtëpinë ku jeton me vjehrrin dhe djalin e porsalindur.

Një ditë, një përfaqësues i partisë komuniste shfaqet në derën e saj, e quan "shoqja S." dhe i dorëzon një ftesë për t'u paraqitur në zyrën e Sekretarit të Parë të Komitetit Krahinor të Partisë. E hutuar dhe e shqetësuar, ajo mendon se mos vallë ka bërë diçka gabim, apo ndoshta ka lidhje me burrin e saj që ndodhet në Tiranë për studime partiake.

Pas dy netësh me ankth, mësohet arsyeja: ajo është thirrur për duart e saj të arta. I kërkohet të realizojë një palë opinga – këpucë tradicionale shqiptare të zbukuruara me qëndisma me grep. Ajo ka vetëm dy ditë kohë për t'i përfunduar dhe duhen të jenë më të bukurat që janë parë ndonjëherë – një dhuratë për një figurë të rëndësishme, emri i të cilit nuk bëhet i ditur.

E habitur, ajo pyet se si mund të bëjë këpucë pa ditur masën e këmbës së atij që do t'i veshë. I thuhet se nuk do të vishen – janë një dhuratë për Nikita Hrushovin, liderin sovjetik, që pritej të vizitonte Shqipërinë.

Ato këpucë do të ndryshojnë rrënjësisht jetën e saj. Kjo histori, e vërtetë, është rrëfimi i nënës së autorit Besnik Mustafaj, i përshkruar në romanin "Në emër të nënës dhe të birit", fitues i një çmimi kombëtar në vitin 2019 dhe i botuar së fundmi në Itali nga shtëpia botuese Castelvecchi.

Mustafaj ndërton mbi episodin e opingave një pasqyrë të jetës nën regjimin komunist – një jetë e mbushur me sekrete, me frikë, me retorikë boshe dhe me pushtet që imponon respekt dhe tmerr njëkohësisht.

Në sfond është përçarja midis Shqipërisë së Enver Hoxhës dhe Bashkimit Sovjetik pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të BRSS. Hoxha mbeti besnik ndaj kultit të Stalinit, edhe kur Hrushovi kishte nisur denoncimin e krimeve të tij.

Personazhet janë të ndërtuar me kujdes: Selmani, një ish-partizan i dëshpëruar që bie në fatkeqësi pasi guxon të festojë martesën në kohën kur vendi ishte në zi për vdekjen e Stalinit; Gjyshi, vjehrri i mirë dhe i urtë, por që jeton me frikën në bark. Përfaqësues të pushtetit, si Sekretari i Parë Krahinor apo Presidenti i Presidiumit të Partisë, paraqiten si fytyra të paternalizmit të ftohtë komunist.

Roli i grave është i theksuar: Drita, e përjashtuar për shkak të lidhjes me një "armik të popullit"; Rushe dhe Kumrie, funksionare që sundojnë dhe "rrinë veshur me pantallona".

Shoqja S. futet në një rrugëtim të papritur: bëhet figurë publike, ftohet të flasë në tribunë, botohet në gazetën e partisë dhe më pas përfshihet në një program edukimi për gratë. Por përvoja zgjat pak, pasi përballet me përçmimin e grave të qytetit dhe me një letër anonime që denoncon një skandal moral.

Për tridhjetë vjet, ajo mbart një peshë të rëndë shpirtërore: Rushe i thotë se opingat e saj ishin ato që Hrushovi përplasi mbi foltore në OKB më 12 tetor 1960 – një akt që turpëroi komunizmin botërisht. S. nuk di ç'të besojë dhe kjo e bre tërë jetën.

Megjithatë, në qendër të librit është dashuria e nënës për të birin. Kur nuk ka mbështetje nga burri apo kur përballet me absurditetet e regjimit, ajo i rrëfehet foshnjës së saj, sepse një fëmijë nuk i tregon sekretet.

Kur Besnik Mustafaj bëhet diplomat dhe minister i jashtëm pas rënies së regjimit komunist, nëna e lut që të zbulojë të vërtetën e atyre opingave. Autori lë që lexuesi ta zbulojë vetë përfundimin, por ky kërkim i nënës bëhet një shkëndijë që zgjon tek ai nevojën për të shkruar. Fundi i librit është një dialog i dhimbshëm me nënën e ndjerë, një ndërgjegjësim mbi fuqinë e kujtesës dhe të shkrimit.

Mustafaj kishte hezituar për vite ta shkruante fillimin e romanit, i cili përmbledh thelbin e veprës:

"Herën e parë që nëna ime vuri këmbën në një zyrë shtetërore ishte kur u martua. Por në një zyrë të vërtetë të pushtetit – aty ku hija e shtetit ndihet si një frikë që të hyn në palcë – ajo hyri vetëm në moshën njëzet e katër vjeç. Që nga ajo ditë, zyrat e shtetit për të do të mbeteshin vende të rrezikshme."

As në zyrën e djalit nuk pranoi të hynte: "Kam frikë se pastaj nuk do të të dua më si më parë. Kam frikë se do të humbas djalin tim."

A mund të ndikojë pushteti deri në këtë pikë? Përtej frikës së saj, ky roman është një mohim i fuqishëm i asaj ndjesie.

Përktheu dhe përgatiti për botim:
Amarildo G. Veizi

DHURATA HOTI

Befasia e ditëlindjes

Tregim

Lena kishte përgatitur çdo gjë javë më përpara, edhe pse ishte befasi, ajo nuk donte të linte asgjë në mëshirën e rastësisë. Ajo kishte porositur pijet, ushqimet dhe zbukurimet dhe ishte kujdesur që Jani të mos i vërente me një fshehtësi që ndonjëherë frikësohej se mos do të dukej sikur po e tradhtonte, ndonëse në thellësi e dinte që ai, kishte aq shumë besim në të, sa edhe po ta shihte me një burrë tjetër nuk do të dyshonte. Dashuria e tyre ishte e qetë, lidhja e tyre ishte pa konflikte e drama. Ajo e shijonte këtë qetësi e besim në lidhjen e tyre që tashmë po bënte vitin, me një krenari prej një nëne që shikon rezultate të shkëlqyeshme në dëftesat shkollore të fëmijës së saj. Pas lidhjeve të trazuara që kishte pasur, dashuria me Janin i dukej si ajër i pastër që i mbushte mushkëritë me frymë. Lena kurrë nuk i kishte dashur dramat, ajo që prej adoleshencës kishte dashur një lidhje të qetë me një burrë të mirë, me të cilin mund të ndërtonte një jetë. Tani që e kishte ishte e lumtur dhe e merrte si shpagim për vuajtjet e kaluara. Sikur Jani të ishte trofeu që i vinte pasi kishte duruar pa bërë zë shuplakat e jetës që nuk besonte se i kishte merituar.

Pa orën, kishte kohë mjaftueshëm, Janin e kishte marrë shoku i tij, sipas porosisë së saj dhe nuk supozohej të vinte edhe nja dy orë. Gjithçka është gati, i përsëriti vetes për ta qetësuar si ndonjë mantra, gjithçka do të shkoj mirë. Mirëpo diku në trup ndjente një ngërç, një lloj rezistence, që sikur po e përgatiste për më të keqen, por tentoi të zbuste mendimet duke i thënë vetes që ishte një ankth i zakonshëm para ngjarjes me të cilën po merrej me entuziazëm të madh.

Të gjithë arritën në kohë, pavarësisht frikës së Lenës se nuk mund të arrinte të mblidhte 30 veta pa u vonuar askush. Ja komplimentuan dekorimet, bile disa prej shokëve të tij edhe ja konfirmuan që prej se ishte me të, Jani kishte filluar të bënte një jetë më të shëndetshme dhe më të ekuilibruar. Fytyra e Lenës sikur ishte e paaftë të mos buzëqeshte, sikur një gëzim në formë të një drite po i vinte prej zemrës dhe i kalonte nëpër shtyllën kurrizore duke e bërë trupin e saj të ndihej sikur pluskonte në ajër. Gjithsesi ngërçi ishte aty, ajo e dinte se nuk duhej injoruar, por a nuk ishte gjithmonë një pjesë e saj që frikësohej kur ishte e lumtur, sikur të mos e meritonte gëzimin e plotë. E kishte paralajmëruar edhe psikologia, brenda mendjes tonë, ekziston një trup emocional që ushqehet me ndjenjat negative, njëjtë sikur trupi ynë fizik, ai ka nevojë për ushqim dhe ankthi është një prej atyre ushqimeve. Sa herë që je e lumtur, ky trup jofizik do të kërkoj të gjej pakënaqësi e dhimbje, sepse pa to nuk mund të mbijetoj. Ajo e paramendoi këtë trup si një krimb i madh, me ngjyrë të kaftë, i mbuluar nga jargë duke e thithur ankthin e saj prej trupit e duke u kapërdirë. Krimbi trashet ndërkohë që ajo shkon duke u tkurrur brenda trupit të saj derisa shndërrohet në diçka që i ngjan një lëvoreje të thare molle. Tund kokën sikur të donte t'i nxirrte jashtë gjithë këto vizualizime të mendimeve të saj të padobishme.

Tashmë të gjithë ishin fshehur duke pritur nga një minutë në tjetrin Janin të hynte. Kur dera u hap dhe ata u ngritën dhe i kënduan këngën e ditëlindjes, Lena edhe njëherë i konfirmoi vetes se frika e saj kishte qenë e pabazuar. Ai e perqafoi fort dhe ajo ndjeu erën e lehtë të parfumit të tij që iu duk sikur i rikujtoi momente nga fëmijëria, kur ishte e frikësuar dhe babai i saj e merrte në krahë për ta qetësuar. Iu deshtën pak çaste për të arritur të çlirohej nga përqafimi i tij, sikur jeta të mos kishte kuptim tjetër për të, pos këtij momenti. Ai e shikon në sy, është pak i hutuar por edhe ai i duket i lumtur, por a mund të jenë dy njerëz të lumtur në të njëjtën kohë, pyet veten Lena dhe me një lloj ngadhënjimi i thotë atij krimbit që ushqehej me dhimbje, që jeta ndonjëherë është thjesht e mirë. Dëgjoi një zë burri nga pas, ishte Andi një shok tjetër i Janit që kishte ardhur ta uronte. Ajo u shkëput dhe bëri një shëtitje për të parë nëse gjithçka ishte në rregull me mysafirët.

Kur u kthye nuk po arrinte të gjente Janin. Iu duk kohë pak si e gjatë për të mos e parë tek sillej diku nëpër apartamentin e tyre jo shumë të madh. Ta kërkonte u bë shqetësimi i saj i radhës. E pa sapo doli në korridor, në fillim i dëgjoi vetëm zërin e ngazëllyer, barkun ia përshkoi një shpim që nuk e la të regjistronte fjalët që e dëgjoi të thoshte. Ishte bashkë me një vajzë në fillim të njëzetave, bionde me një bluzë të kuqe dhe buzëkuq të ndezur. Ajo i ishte hedhur në përqafim dhe po gajaseshin së qeshuri. Lena mori frymë thellë dhe tentoi ti përkujtonte vetes mantrën e mëhershme, por nuk iu kujtua asgjë, në fakt i erdhi të bërtiste. Jani e ktheu kokën, me faqet e skuqura e fytyrën e qeshur, e pa dhe asaj iu duk sikur për pak sekonda ai u pre dhe fytyra e tij mori një shprehje të dikujt që është zënë në faj. Mirëpo shpejt e mori veten dhe e prezantoi, ishte Ada. Natyrisht, ishte dashur t'ia merrte mendja. Në Instagram i ishte dukur më pak e bukur. Në realitet ajo ishte rrëzëllitëse. Iu afrua dhe e përqafoi me ngrohtësi, i vinte një erë e mirë që Lena do të pëlqente ta kishte vetë. Paramendoi se sa ngashënjyese mund të ishte për Janin, se sa i joshur mund të ndihej edhe ai prej saj, ose ndoshta burrat nuk tërhiqeshin nga një erë e tillë. Por kur ktheu dhe pa buzëqeshjen e tij dhe atë zërin me një ngjyrë kënaqësie që e kishte kur flirtonin në fillim, nuk kishte mëdyshje. Ai ende e dëshironte.

-Kur të kam folur për Adën, sigurisht që të kam treguar që është përplot me surpriza. Ja pra, ajo vendos të më vizitoj pas 3 viteve që nuk e kam parë, pa pritur.

-Është ditëlindja jote, po e planifikoja në fakt, por doja të të befasoja. E kur Tina për më tregoi për festën…

-Po vërtet, ishte befasi e mrekullueshme, tha Jani me ngazëllim, e pastaj u kthye ka Lena. Një ditë me plot surpriza për mua. Unë po prisja një pasdite të qetë e të mërzitshme.

Lena mendoi nëse pasditja e qetë e e mërzitshme nënkuptonte që ai të rrinte vetëm më të. Jani sikur e vërejti.

-Hajde, shikoje se çfarë feste më ka bërë Lena, e tërhoqi për dore ai Adën dhe Lena shkoi pas tyre.

Ia mbushi vetes një gotë me verë të kuqe dhe filloi të scroll nëpër telefon kot, sepse i dukej sikur të tjerët mund të ja vërenin ankthin që e kishte kapluar. I piu edhe disa hurba verë shpejt, ata po rrinin pak më tutje, të rrethuar me miq, ajo vetëm, duke tentuar të dehet. Ndoshta duhet të ikte, të gjente një arsyetim sikur nuk ishte mirë, ajo me të vërtet nuk po ndihej aspak mirë, kështu do t'ia merrte vëmendjen Adës, por do të dukej e dëshpëruar.

Sa e relaksuar dukej ajo. Athua ishte vërtetë ashtu, apo shumë e aftë të pretendonte. Gjithçka te ajo dukej aq e natyrshme, e freskët, sikur sapo kishte dalë prej një vaske të mbushur me ujë të ngrohtë e vajra esencial. Edhe mënyra se si ishte veshur. Si mund të dukej dikush aq tërheqëse dhe në të njëjtën kohë kaq rehat. Lena kishte veshur një fustan të zi të gjatë e të ngushtë që tani, më shumë se më parë po i zinte frymën e shtrëngonte barkun. E kishte blerë para 3 ditësh me entuziazmin më të madh, e tani po i dukej shumë pa shije, i zakonshëm, si një tub, sidomos krahasuar me bluzën e kuqe prej pambuku të tejdukshëm të Adës, materiali i butë dhe prerja e të cilës sikur përqafonin format e trupit si sirenë, sidomos pjesa e poshtme e xhinseve që vinte e bëhej më zgjeruar prej gjunjëve e poshtë, që i jepte iluzionin e bishtit të një sirene. Ada me bluzën e kuqe dhe xhinset blu të errët, me buzëkuqin e ndezur dhe rimelin e hollë e preciz, dukej kaq cool, aq joshëse sa Lena dëshironte të ishte si ajo. Madje erdhi në përfundim që ajo shkonte me Janin, shumë më shumë se sa vetë ajo. Të dy ishin biond, me sy të gjelbërit, dukeshin kaq mirë së bashku, sikur të kishin dal nga një reklamë e Nivea-s. Vrau mendjen se nëse zjarri do të përfshinte apartamentin e tyre dhe ai mund të shpëtonte vetëm një person, kë do të zgjidhte. Ishte e sigurtë se do të zgjidhte Adën. Iu duk sikur ndjeu dhimbje nga thithjet e krimit imagjinar. Mendimet ia ndërpreu Tea, e dashura e një kolegu të Janit, me të cilët dilnin shpesh.

-Ke bërë një festë të mrekullueshme. Duhet të jesh munduar shumë.

Lena u sforcua të dukej e lumtur.

-Ah, mund të ishte edhe më mirë…

-Mos u bëj kaq modeste. Gjithsesi, duhet ta shijosh edhe vetë, i tha ajo me një ton nënkuptues.

Lena e pyeti veten nëse shqetësimi i saj për Adën ishte kaq i dukshëm

-Ti e di se si jam, dua që gjithçka të shkojë mirë, u shfajësua Lena, duke shpresuar që ajo nuk e kishte fjalën për brengën e saj të vërtetë.

-E di, por nuk të bën mirë, nuk e sheh që të gjithë janë duke u argëtuar, tha Tea duke bërë me kokë kah njerëzit. Tani Ada ishte duke i folur në vesh Janit dhe Lena mendoi se çfarë po i thoshte. Si duket Tea e vërejti.

-Mos u brengos për ish të dashurat. Po të kishte qenë e përshtatshme për të, do të ishin ende bashkë.

-Uh, jo. Nuk brengosem, tha Lena, pa qenë aspak e bindshme. Por ai flet për të me aq adhurim,- nuk u përmbajt më në fund ajo.

- Po, është një kujtim i bukur për të, dhe kjo është në rregull. Por ai ka vuajtur shumë për shkak të saj, më ka treguar Taulanti. Grindeshin gjatë gjithë kohës. Nuk ishte aspak lidhje e shëndetshme, sikur kjo që ka me ty.

Lena pohoi me kokë, por nuk ishte aspak e bindur. Tea e vërejti këtë.

- Shko pra, mos rri këtu me mua. Boll i le të rrinë bashkë, mos e lejo të ta prish mbrëmjen. Lena i premtoi, por në gjysmë të rrugës, u pendua dhe u nis në tualet. Nuk ndihej e gatshme të përballej. Kishte frikë që do ta mbërthente vaji.

U pa në pasqyrë. Iu duk se e kishte tepruar me grim, lagu pak duart me të cilat e përshkroi fytyrën duke tentuar ta zbuste pak pudrën, por nuk iu duk se u bë më mirë. Nuk kishte më shpresa që ajo natë të përmirësohej në favor të saj. I dashuri i saj ishte harruar në shoqërinë e ish të dashurës së tij, në festën që ajo i kishte përgatitur. Po ta donte sado pak ai do të ishte duke e kërkuar. Por a nuk ishte kjo ditëlindja e tij, u përpjek ta arsyetonte një mendje tjetër e saj, duhet ta lë të e shijoj natën. Por, jo, ajo ishte ish e dashura e tij, që e kishte lënë një ditë prej ditësh pa pikë paralajmërimi, duke i thyer zemrën e shkatërruar besimin, kështu i kishte thënë ai vetë. Por a nuk ishte kjo mënyra e duhur për ta bërë dikë të paharrueshëm? Ndoshta kështu duhej të bënte edhe ajo, të zhdukej përnjëherësh, mirëpo kurrë nuk kishte qenë e aftë për të ndërmarrë veprime të tilla, ajo nuk ishte lloji i gruas së paharrueshme ndoshta dhe do ti duhej të pajtohej me këtë fakt. Ada nuk besonte që do të rrinte gjatë, Jani do të ishte prapë vetëm me të. Iu duk sikur u qetësua. Mori frymë thellë disa herë dhe vendosi të mos shihej në pasqyrë. Nuk do të mendonte se si dukej. Donte vetëm ta përfundonte këtë natë dinjitetshëm. Le të ishte e dashura pak naive që iu dhimbset pak të tjerëve. Ndoshta kështu është dashuria e vërtetë.

Kur doli, ata ishin ulur në një kënd, duke parë njëri tjetrin me atë lloj vështrimi, që Lena do të preferonte më mirë ti shihte duke u puthur, se sa ky gjakim pafund që dukej në ajër dhe kishte përfshirë krejt dhomën. E mori një cigare, gotën bashkë me një shishe pothuajse përgjysmë me verë dhe doli në ballkon. Jashtë ishin dy shoqe të saj dhe një djalë i panjohur. Ajo nuk e dalloi erën në fillim dhe kur ai ia zgjati jointin, ajo u bë gati të thotë jo, por ndërroi mendje. E thithi gjatë dhe e mbajti frymën. E përsëriti këtë disa herë. Ndjeu trupin ti rëndohej dhe pa se cigarja i ishte djegur. Djali tani i zgjati një cigare prej paketimit të tij dhe ajo e mori duke menduar që ai dukej sikur kishte gjithçka që ajo kishte nevojë. I erdhi për të qeshur dhe djali si duket e mori si sinjal për flirt dhe tentoi të hapte një bisedë. Lena filloi të inkuadrohej në bisedë, mirëpo sapo e përfundonte ai fjalinë, harronte se për çfarë kishte qenë duke folur dhe përfundoi duke buzëqeshur e tundur kokën si debile. Kishte kohë që nuk kishte tymosur bar, e kishte kapur më shumë se sa që kishte pritur. Ndërkohë në ballkon kishin mbetur vetëm ata të dy dhe ajo filloi të mendonte se ndoshta duhej të bënte dashuri me të, të paktën le të ishte ajo që do të ndihej në faj. I dukej se më lehtë do ta duronte ndjesinë e fajit, se sa të viktimës.

Iu afrua dhe e puthi, në sekondat e para u ndez prej idesë që po bënte diçka të tillë, por shumë shpejt ai filloi ti dukej sikur nuk ishte më njeri por një gjuhë e stërmadhe që po tentonte të futej në gojën e saj. Ajo u sforcua të relaksohej, mirëpo me çdo tendencë i dukej sikur ajo bëhej më e vogël, ndërkohë që gjuha

rritej. U çlirua prej tij duke i kërkuar falje me mirësjellje.

Ada ishte tash në kuzhinë, ku e kishin rrethuar një grup që po dëgjonte me vëmendje se si ajo po tregonte takimin e saj të parë me Janin. Lenës iu duk se po i përzihej stomaku. Ajo e kishte dëgjuar tashmë këtë histori, disa herë.

Shumica e mysafirëve po iknin, kishin mbetur vetëm dy shok të Janit. Kur edhe ata vendosën të iknin, Ada e falënderoi Lenën dhe e përqafoi shtrëngueshëm Janin.

- Sonte të gjithë vëmendjen ja dhashë Janit, i tha Ada duke marrë xhaketën, por të dëshiroja shumë të njiheshim më shumë Lena, ndoshta të pimë kafe nesër në mëngjes të tre së bashku?

- Mëngjesi i Adës fillon pas orës 12, tha Jani duke qeshur dhe e pyeti se ku do të flinte.

- Kam harruar të rezervoj por do të gjej diçka besoj, tha ajo si duke u shfajësuar.

- Ti nuk ke ndryshuar aspak, je e tmerrshme, tha Jani duke tundur kokën me mosaprovim. E dashur, po shkoj me të ta përcjell, i tha Lenës ai.

- Po pse nuk rri tek ne sonte?, dëgjoi zërin e saj Lena. Pse e kishte thënë këtë? Ndoshta sepse kishte frikë që diçka do të ndodhte mes tyre kur të mbeteshin vetëm. Gjithsesi, tashmë nuk mund të kthehej mbrapsht. Ada e pa me dashamirësi.

- Lena, faleminderit. Je e sigurt që nuk do të ju pengoj?

- Jo aspak, përkundrazi, tha Lena. Ne e kemi një dhomë të lirë gjithsesi.

Ada e përqafoi dhe Lenës iu duk sikur era e saj e mirë i shpoi zemrën. U mllefos me paaftësinë e saj për të reaguar ashtu sikur ndihej, të paktën njëherë në jetë. Do të donte të bërtiste dhe ti kërkonte Janit të mos e takonte më kurrë Adën. Por në vend të kësaj u tha se po shkonte të bënte gati dhomën dhe u largua.

Ada hyri në dhomë kur ajo ishte duke bërë gati shtratin. Zbutësi i rrobave me aromë kajsie e mbushi ajrin dhe i kujtoi Lenës momente të lumtura, në të cilat e lëshoi vetën aq shumë, sa nuk e kishte dëgjuar Adën që i ishte afruar pranë. Ajo e falënderoi me buzëqeshjen e saj rrëzëllitëse, ndërsa Lena do të dëshironte t'i uronte të vdiste në gjumë. Në vend të kësaj e dëgjoi veten duke e pyetur nëse kishte pizhame.

-Preferoj të flej e zhveshur, i tha Ada. Rrobat më bezdisin në gjumë.

Lena tundi kokën në përpjekje për të gjetur fjalët që i duheshin për të ikur prej dhomës. Era e Adës, era e çarçafëve sikur po i ngushtonin dhomën dhe asaj po i dukej sikur do të alivanosej. Nuk e priti aspak kur Ada u afrua dhe e puthi lehtas në buzë. E ndjeu fytyrën tek i skuqej, tëmthat i pluskonin dhe duart i shponin si kur i mpiheshin. Nuk e kuptoi si e mori guximin dhe e tërhoqi Adën pas vetes, duke i dhënë një puthje të gjatë, me një agresivitet që nuk e kishte përjetuar kurrë. Kjo puthje kishte intensitetin e njëjtë, me urrejtjen që ajo ndjente. Nuk e dinte se sa zgjati derisa vërejti se Ada me mirësjellje por prerë, po tentonte të çlirohej prej përqafimit.

Lena u largua, tmerrësisht e turpëruar. Ada i buzëqeshi me diçka që iu duk si mëshirë.

-Lena, unë… Ndoshta më keqkuptove, por nuk e ke ti fajin. Unë ndonjëherë e teproj, por nuk e kisha seriozisht. Më fal… Unë… Mua vetëm më pëlqen ti puth njerëzit në buzë në vend të faqes, ndonjëherë, - qeshi pafajsishtë ajo. Lena provoi të bënte si e shkujdesur, por mezi po përmbahej të mos qante. Duhej të ikte shpejt, mirëpo trupi nuk po i bindej, derisa lotët iu lëshuan faqeve. Sikur poshtërimi i parë të mos mjaftonte, Ada po e shihte edhe duke qarë. Më në fund arriti ta bënte trupin të lëvizte dhe doli prej dhomës.

Kur Jani u zgjua në mëngjes, në anën e shtratit ku flinte Lena, gjeti një krimb të mbështjellë në jargë. Me kujdes e jo pa neveri e hoqi bashkë me çarçaf dhe shkundi prej ballkonit. Mendoi se Lena me siguri, kishte dalë për të marrë espresso prej lokalit ku pinin kafen e mëngjesit, që ndodhej në afërsi.

Triptik *nga* Sadedin Mezuraj



1. Shpendi mbi shkëmb

Askush nuk mbante mend kur ishte shfaqur aty. Shumica e njerëzve besonin se së pari ishte shfaqur shkëmbi i kuq dhe më pas, kur dielli doli nga eklipsi, mbi shkëmb u pa të qëndronte një shpend i zi, me krahët e hapur. Kushedi pse i mbante ashtu – ndoshta në pritje të ndonjë stuhie të re, ose thjesht të mbetur pezull mbi shkëmb, si për ta mbrojtur atë nga një shi që s'kishte pushuar prej një mijë vjetësh, në atë tokë me male të thepisur dhe lumenj të tërbuar, të zemëruar me detin, ku forca e tyre e egër qetësohej dhe identitetet e tyre shuheshin në atë masë të pafundme ujore.

Të tjerë mendonin se shpendi i zi kishte dalë nga zemra e shkëmbit pikërisht pas përmbytjes së madhe dhe prej aty nuk do të lëvizste, deri kur të ndodhte eklipsi i dytë, ai që sipas astrologëve do të sillte humbjen e kujtesës të vetë shpendit mbi shkemb dhe atij pra, të panjohurit që qëndronte para shkëmbit, me shpinën e kërrusur mbi një libër të trashë, ku thuhej se kërkonte një enigmë më të lashtë se sa shkëmbi i kuq dhe vetë shpendi i zi që qëndronte përherë krahëhapur mbi të.

Shirat kishin pushuar dhe lumenjtë ishin kthyer në shtratin e vet. Toka ishte ende e lagësht kur një mëngjes, duke ecur nëpër rrugën e madhe me pellgje me ujë dhe llucë të verdhë, i panjohuri shpalli kumtin se koha do të ndalej kurse hapsira do të zgjerohej.

Askush nuk ishte në gjëndje të shpjegonte nëse ky ishte një lajm i mirë apo i keq. Sepse e mira dhe e keqja nuk mund të përcaktoheshin apriori, jashtë dhe përtej përvojës.

Ankthi të panjohurës qëndronte pezull në hapsirat e mendjeve të mjegulluara nga pikëpyetjet dhe pasiguritë.

2. Kështjella

Pas shumë kohësh, kur njerëzit pothuaj kishin harruar që fundi i tij mund të vinte, një lajm tronditës përshkoi të gjitha kthinat e kështjellës dhe rrethinat e saj më të largëta – në ato skaje ku çdo njoftim, për mirë apo keq, merrte trajta dramatike: *Prijësi i Madh*, themeluesi dhe mbrojtësi i kështjellës së fundit në atë shkretëtirë ranore, kishte ndërruar jetë.

Kasnecët, më të shpejtë se era, shpallën anembanë lajmin e kobshëm dhe zinë e madhe dyzet ditore.Prijësi mbylli sytë – shikimi dhe kujtesa e kishin lënë prej kohësh – një mëngjes prilli, kur lulet e portokajve sapo kishin çelur dhe zogjtë në parkun me pemë shekullore këndonin përvajshëm,sikur të parandjenin gjëmën që po afronte. Në të vërtetë, zogjtë këndonin sipas ligjeve të tyre misterioze, por ishte mendja e Kryeshoqëruesit ajo që këngës së tyre neutrale i jepte një tingull profetik, të pikëlluar. Ai, që tashmë e dinte se fundi i Prijësit ishte i afërt, i shikonte me neveri edhe lulet e sapoçelura, sepse një ditë, në një qoshe, të trurit, një grimë kohe i vetëtiu një gjysmë mendimi, i veshur me dritë të errët: *Ato janë lulet e mortit...*

Pranverë-mort, mendoi ai…Pikërisht në atë kështjellë, ku pranvera si simbol i parajsës mbi tokë, ishte kryemetafora e rapsodive të lahutarëve të punësuar në shërbim të Prijësit.

Pas ritualeve të zisë dyzetditore, dy pasardhësit –Aliu dhe Atosi -pretenduan të drejtën e sundimit mbi kështjellën. Këshilli i të Urtëve, sipas së drejtës së re, vendosi ndarjen: Aliu do të qeveriste anën e djathtë të Kështjellës, Atosi – anën e majtë.

Jo izolimi por hapja ndaj botës do të ishte mënyra e të qenurit në epokën e re. Muret rrethues nisën t'i shembnin me mllef dhe shpejtësi. Arkitektët e modernizimit –ose të shkatërrimit krijues-filluan punën, duke hapur porta të reja dhe ngritur ura mbi llagëmet ndarëse rrotull kështjellës. Por një pjesë e banorëve, të lodhur nga roli i dyfishtë – roje dhe të rrethuar – u larguan, duke ikur shumë larg nga ai vend, ku gurët po humbisnin rëndesën dhe ku mbrojtësit ishin bërë shkatërruesit më të mëdhenj.

Edhe pse larg, ata ndienin një vorbull përthithëse, që mendonin se vinte nga Kështjella e braktisur – por në të vërtetë, vatra e saj ishte brenda qenies së tyre.

3. Horizonti

Më në fund, ata dolën nga guva ku ishin ngujuar që nga një kohë që askush s'e mbante mend. Drita ishte verbuese, liria marramendëse. Donin të linin gjithçka pas, por nuk e kuptonin se ajo që kërkonin të harronin ishte tashmë brenda tyre – e pashkatërrueshme.

Pas daljes nuk pati kohë për festë. Menjëherë shpërtheu debati: *A ishte dalja një* **çarje** *në kohë apo hapje në hapësirë?*

Të gjithë kalendarët matnin kohën, por askush nuk kishte menduar ndonjëherë të krijonte një kalendar të hapësirës. Sepse gjithë rrjedha e kohës depozitohej në hapësirë – me gjurmë e shenja të pashkatërrueshme. Një etimolog i ri kujtoi se fjala *hapësirë* vinte nga fjalët pellazge *hap dhe sir***ë** - dhe nënkuptonte daljen nga magjia – ose *hap sytë* – gërma *t* ishte dëbuar për shkak të rotacizmit të hershëm.

E qeshuroi kumboi e pazëshme në kokat që miratonin përulësisht por pyetja mbeti pezull: *Nga* **çfarë** *po dilnin? Dhe ku po shkonin?*

Një mëngjes, mbi malin mitik, Prijësi (i Riu) shtriu dorën drejt horizontit dhe tha: *"Do të shkojmë atje ku qielli puqet me tokën. Fundi i udhëtimit do të jetë fillimi ynë i ri."*

Marshimi i madh filloi me fanfara dhe muzikë. Ec e ec –dhe si në përralla-rruga nuk kishte të sosur. Horizonti, për shkak të trilleve të motit ose mjegullnajës që pllakoste mendjet e tyre ontologjikisht skeptike, herë dukej më afër e herë u humbiste nga sytë. Më në fund e kuptuan se ndodheshin para një paradoksi : sa më shumë t'i afroheshin horizontit, aq më shumë ai largohej. Fanfarat heshtën. Entuziazmi u tret. E megjithatë, ata ecnin. Sepse ecja ishte kthyer në një obsesion drejt një finishi që nuk vinte.

Orakulli, tashmë i verbër, kur nisi stina e shirave të mëdha, kujtoi legjendën e shpendit të zi mbi shkëmbin e kuq dhe profecinë e njeriut mbi librin e trashë : *Koha do të ndaloj***ë** *dhe hapësira do të zgjerohet..*Apokalipsi kishte ardhur. Jo si përmbytje por si boshllëk i pafund. Jo si kumt i ri por si fundi i të gjitha kuptimeve.

KLARA KODRA

Fjala që s'u tha

Çasti ikën dhe asnjë s'mund ta ndalë.
Na mungoi dashuria apo guximi?
Asnjë nga ne të dy s'e tha atë fjalë
Që do të ndryshonte fatin tënd e timin.

Shohim njëri-tjetrin në sy, pa qeshje e lot
Rëndon pesha e fjalës që s'u tha:
"Sikur të thotë "jo", më sheh si motër!
"Sikur të thotë "jo" më sheh si vëlla!

Miqësi të jetë kjo, a dashuri vallë?
Ngjajnë aq shumë! Do mbetet fshehtësi?
Ç'është vallë dashuria? Një perlë e rrallë.
Jo të gjithë guackat e fshehin. Nga ta di?

Na pëlqente as shumë të shkëmbejmë fjalë!
Ti erdhe të më shohësh pranë detit.
T'u duka e bukur në atë sfond me valë
E prapë fjalën që duhej nuk e gjete.

A mund ta thotë vajza fjalën e parë?
Po fjala "jo" e rëndë është si përgjigje
I takon djalit. Ai hesht. Ç'të them unë vallë?
Pra, buza hesht e brenda zemra digjet.

Sytë e tu janë të errët e të thellë.
Çfarë kanë brenda vallë? Sikur ta di!
Sytë e tu më të errët janë se një shpellë.
Cila shtrigë na ka lidhur me magji?

Sikur të ta shtroja udhën me buzëqeshje!
Sikur të dija të ta shkelja syrin!
.....

Koha ikën vrullshëm si një lumë me valë.
Na mungoi dashuria apo guximi?
Asnjë nga ne të dy s'e tha atë fjalë
Që do t'ndryshonte fatin tënd e timin.



EDGAR ALLAN POE

Zemra rrëfyese

Tregim

Përktheu: Noel Boci



Evërtetë! I shqetësuar, tmerrësisht i shqetësuar kam qenë dhe vijoj të jem; por pse *thoni* që jam i çmendur? Sëmundja m'i kishte forcuar shqisat, nuk m'i kishte shkatërruar e as nuk m'i kishte zbehur ato. Mbi të gjitha, shqisën e dëgjimit e kisha jashtë mase të mprehtë. Dëgjoja gjithçka që ndodhte në parajsë e në tokë. Shumëçka dëgjoja në ferr. E si pra mund të jem i çmendur? Dëgjoni me kujdes! Vëreni sa me qartësi, sa me qetësi mund t'jua tregoj tërë historinë.

Është e pamundur të thuhet se si më lindi fillimisht ajo ide, por sapo u formësua, më përndiqte ditë e natë. Nuk ekzistonte asnjë qëllim. Asnjë mllef. E doja plakun. Nuk më kishte bërë kurrë asgjë të keqe. Asnjëherë nuk më kishte fyer. Për pasurinë e tij nuk kisha fare lakmi. Mendoj që ishte syri i tij! Po, kjo ishte! Njëri prej syve të tij i ngjante syrit të një shpendi grabitqar – një sy në ngjyrë blu të zbehtë, i mbuluar nga një perde e turbullt. Sa herë më vështronte më ngrihej gjaku, e kështu, hap pas hapi, e ndava mendjen t'i merrja jetën plakut, e kështu të shpëtoja veten nga ai sy njëherë e përgjithmonë.

Këtu pra qëndron thelbi. Ju më merrni për të çmendur. Të çmendurit nuk dinë asgjë. Por ju duhet të më kishit parë *mua*. Duhet të më kishit parë me ç'mençuri veprova; me ç'kujdes, me ç'largpamësi, me ç'tinëzari e kreva këtë vepër! Nuk jam treguar kurrë aq i dashur me plakun sesa tërë atë javë përpara se ta vrisja. Dhe çdo natë rreth mesnatës ktheja dorezën e derës së tij dhe e hapja; oh, sa me butësi e hapja! Kur hapësira ishte e mjaftueshme për të futur kokën time, fusja një kandil të errët, plotësisht të mbuluar, në mënyrë që të mos depërtonte asnjë grimë drite prej tij, e më pas fusja kokën. Oh, do të qeshnit po të shikonit me ç'dinakëri e fusja brenda! E lëvizja ngadalë, shumë ngadalë, në mënyrë që mos t'ia prishja gjumin plakut. Më duhej plot një orë të fusja tërë kokën brenda asaj hapësire aq sa të mund ta shikoja atë të shtrirë mbi krevat. Hah! A do arrinte një i çmendur të tregohej kaq i mençur? Dhe pasi më në fund e fusja plotësisht kokën brenda në dhomë e zbuloja me kujdes; oh, me kaq kujdes (pasi këmbëzat kërcitën) e zbuloja, aq sa një fije fare e vogël e asaj drite të binte mu në atë sy grabitqari. Dhe këtë gjë e bëra për shtatë net të gjata, çdo natë mu në mesnatë, por syri qëllonte përherë i mbyllur, ndaj dhe ishte e pamundur ta kryeja punën, pasi nuk ishte plaku ai që më acaronte, por Syri i tij i Lig. Dhe çdo mëngjes, sapo zbardhte dita, hyja me guxim në dhomën e tij dhe i flisja me vendosmëri, duke e thirrur në emër me një ton të ngrohtë, duke e pyetur si e kishte kaluar natën. Siç e kuptoni ai do të kishte qenë një plak vërtet shumë i mprehtë, po të dyshonte që çdo natë, mu në orën dymbëdhjetë, e vëzhgoja teksa flinte.

Natën e tetë u tregova më i kujdesshëm se zakonisht kur po hapja derën. Edhe akrepi i minutave të një ore do të lëvizte më shpejt. Kurrë më parë, deri atë natë, nuk i kisha ndjerë plotësisht fuqitë e mia, mprehtësinë e mendjes sime. Me zor e përmbaja ndjesinë e fitores. E ta mendosh që unë isha aty, duke hapur derën pak e nga pak, kurse ai as në ëndrra nuk do mund t'i shihte veprimet dhe mendimet e mia të fshehta. Qesha me zë të ulët, dhe mbase ai më dëgjoi, pasi lëvizi papritmas në shtrat si të qe trembur. Mund të mendoni se u tërhoqa, por jo. Dhoma ishte sterrë e zezë nga tërë ajo errësirë e dendur (ngaqë grilat qenë mbyllur nga frika se mos hynin hajdutët), ndaj e dija që ai nuk e shihte dot derën që po hapej, dhe vazhdova ta shtyja atë dalë e ngadalë.

Kisha futur tashmë kokën brenda dhe po bëhesha gati të zbuloja kandilin kur gishti më rrëshqiti mbi kapësen prej teneqeje, dhe plaku u çua në krevat dhe bërtiti, "Kush është aty?"

Ndenja në vend pa lëvizur dhe nuk thashë asgjë. Për plot një orë nuk lëviza as muskulin më të vogël, dhe ndërkohë nuk e dëgjova plakun të shtrihej. Vazhdonte të qëndronte ulur në shtrat, duke dëgjuar; ashtu siç kam bërë unë natë për natë duke dëgjuar rrahjet e vdekjes në mur.

Papritmas dëgjova një rënkim të lehtë, dhe e kuptova që ishte rënkimi i një tmerri vdekjeprurës. Nuk ishte rënkim dhimbjeje apo pikëllimi; oh, jo! Ishte ai tingull i ulët, i mbytur, që buron nga thellësia e shpirtit të mbushur me frikë. E njihja mirë atë tingull. Shumë net, mu në mesnatë, teksa e gjithë bota flinte, ky tingull kishte shpërthyer edhe nga kraharori im, duke u thelluar, me jehonën e tij të tmerrshme, me ankthet që më shpërqendronin. Po, e njihja shumë mirë atë tingull. E dija çfarë ndjente plaku, dhe ndjeja keqardhje për të, ndonëse në shpirt gëzohesha. E dija që po qëndronte i shtrirë zgjuar që nga ajo zhurma e parë dhe e lehtë në çastin kur qe kthyer në shtrat. Frika kishte nisur të përforcohej brenda tij. Përpiqej të bindte veten se ajo frikë ishte e pabazë, por nuk ia dilte dot. Thoshte me vete, "Nuk është asgjë veçse era në oxhak, është vetëm një mi që po ecën në dysheme," ose "Është thjesht një bulkth që ka cingëruar vetëm një herë." Po, po përpiqej të ngushëllonte veten me këto hamendësime; por e kuptonte se ishte e kotë. *Gjithçka ishte e kotë*, sepse Vdekja, teksa i afrohej, ecte përpara tij me hijen e saj të zezë, duke e mbështjellë me të viktimën. Dhe ishte pikërisht ky ndikim i zymtë i hijes së padukshme që e bënte të ndjente, edhe pse nuk shihte dhe nuk dëgjonte, të *ndjente* praninë e kokës sime brenda në dhomë.

Pasi prita gjatë e me shumë durim pa e dëgjuar të shtrihej, vendosa ta zbuloja pak, shumë, shumë pak, kandilin. Kështu që e zbulova; nuk mund ta imagjinoni dot sa tinëzisht e zbulova, derisa më në fund një rreze e zbehtë, si filli i merimangës, doli nga ajo pak hapësirë dhe ra mbi syrin prej grabitqari.

Ishte i hapur, krejtësisht i hapur, dhe u tërbova teksa e shikoja. E pashë krejt qartë: i gjithi blu i zbehtë, mbuluar me një perde të neveritshme që më ngrinte palcën e kockave, por nuk shikoja dot asgjë tjetër nga fytyra apo nga trupi i plakut, sepse e kisha drejtuar rrezen e dritës, thuajse instinktivisht, pikërisht mbi atë vend të mallkuar.

A nuk ju thashë se ajo që ju e ngatërroni për çmenduri nuk është veçse mprehtësi e theksuar e shqisave? Atëherë në veshët e mi arriti një tingull i ulët, i mbytur, i shpejtë, si ai që bën një orë kur është e mbështjellë me pëlhurë pambuku. Edhe atë tingull e njihja mirë. Ishte rrahja e zemrës së plakut. Ajo e shtonte tërbimin tim, ashtu siç e nxit një ushtar tingulli i daulles të tregohet i guximshëm.

Megjithatë u përmbajta dhe qëndrova pa lëvizur. As frymë thuajse nuk merrja. Kandilin e mbaja pa e lëvizur fare. Po përpiqesha ta mbaja sa më drejt rrezen ndriçuese mbi syrin e tij. Ndërkohë, rrahjet djallëzore të zemrës po shtoheshin. Bëheshin gjithnjë e më të shpejta, gjithnjë e më të zhurmshme, çdo sekondë. Plaku *duhet* të ketë qenë i tmerruar për vdekje. Bëheshin më të zhurmshme, po ju them, më të zhurmshme në çdo çast! Më kuptuat mirë? Jua thashë që jam i shqetësuar: dhe jam vërtet.

Atëherë, në errësirën e asaj mesnate, mes heshtjes së tmerrshme të asaj shtëpie të vjetër, një zhurmë kaq e pazakontë më ngjalli një frikë të pakufi. Megjithatë, u përmbajta dhe qëndrova në vend edhe për ca minuta. Por rrahjet po bëheshin akoma më të forta! Mendova se mos zemra do të shpërthente. Në atë çast më kaploi një tjetër ankth: poterja mund të dëgjohej nga ndonjë fqinj. Plakut i erdhi koha! Me një britmë të fortë, zbulova me forcë kandilin dhe u hodha brenda në dhomë. Ai bërtiti vetëm një herë. E tërhoqa menjëherë zvarrë në dysheme dhe i hodha krevatin e rëndë sipër. Pastaj buzëqesha i gëzuar, teksa pashë se vepra pothuajse ishte kryer. Por për minuta me radhë zemra vijoi të rrihte me një tingull të mbytur. Kjo, ama, nuk më shqetësoi; nuk mund të dëgjohej përtej murit. Më në fund pushoi. Plaku kishte vdekur. E hoqa mënjanë krevatin dhe shqyrtova kufomën. Po, trupi ishte i pajetë. Ia vura dorën mbi zemër dhe e mbajta aty për një kohë të gjatë. Nuk kishte asnjë rrahje. Përfundimisht kishte vdekur. Syri i tij nuk do të më shqetësonte më.

Nëse akoma më merrni për të çmendur, këtë tashmë do e hiqni njëherë e mirë nga mendja sapo t'ju përshkruaj masat paraprake që mora për të fshehur trupin. Nata po kalonte, dhe unë punoja me nxitim, por në heshtje.

Hoqa tri dërrasa nga dyshemeja dhe e fsheha trupin midis trarëve. Pastaj i vendosa dërrasat sërish aq mjeshtërisht, aq dinakërisht, saqë asnjë sy njeriu, madje as i tiji, nuk do të mund të dallonte asgjë të dyshimtë. Nuk kishte asgjë për të pastruar; asnjë njollë çfarëdo, as edhe një pikë gjaku. Isha treguar më se i kujdesshëm nga kjo anë.

Kur përfundova, ora kishte shkuar katër; errësira mbizotëronte si të ishte mesnatë. Teksa kambana ra për të shënuar orën, u dëgjua një trokitje në derën e jashtme. Zbrita për ta hapur pa ndjerë kurrfarë frike; e për se duhet të kisha *tani* frikë? Hynë tre burra, të cilët u prezantuan, në mënyrë shumë të sjellshme, si oficerë të policisë. Një britmë qe dëgjuar nga një prej komshinjve gjatë natës; dyshohej të ishte kryer një krim i rëndë; kallëzimi ishte bërë në zyrën e policisë, dhe ata (oficerët) ishin caktuar për të kontrolluar terrenin.

Buzëqesha; fundja, për *se* duhet të kisha frikë? Zotërinjve u urova mirëseardhjen. Britma, u thashë, kishte qenë imja teksa shikoja një ëndërr. Plaku, shtova, ishte larguar në fshat. U tregova vizitorëve tërë shtëpinë. U thashë të kërkonin; të kërkonin *mirë*. I çova pastaj, së fundi, në dhomën *e tij*. U tregova sendet e tij të çmuara, të paprekura, të sigurta. Në kulmin e vetëbesimin tim, solla ca karrige në dhomë dhe i ftova të çlodheshin *këtu*, ndërkohë që unë vetë, me paturpësinë më të madhe që më buronte nga triumfi i padiskutueshëm, e vendosa karrigen time mu mbi vendin ku prehej trupi i viktimës.

Oficerët ndiheshin të kënaqur. *Sjellja* ime i kishte bindur. Ndihesha krejtësisht i qetë. Ata ndenjën ulur, dhe teksa u përgjigjesha me gjallëri, ata bisedonin mbi gjëra të zakonshme. Por, pas pak, ndjeva se po zbehesha dhe dëshiroja që ata të largoheshin. Më dhimbte koka dhe më dukej sikur dëgjoja një zhurmë në vesh; ata ndërkohë vazhdonin të rrinin e të bisedonin po aty. Zhurma u bë më e qartë; bëhej gjithnjë e më e dallueshme. U mundova të flisja më me lirshmëri për t'u shpëtuar ndjesive, por zhurma vijonte të bëhej akoma më e dëgjueshme, derisa, më në fund, zbulova se zhurma *nuk* ishte vetëm brenda veshëve të mi.

Tashmë pa dyshim isha zbehur krejt në fytyrë; megjithatë u përpoqa të flisja më rrjedhshëm dhe me zë më të ngritur. Prapëseprapë, zhurma po shtohej; çfarë mund të bëja? Ishte *një tingull i ulët, i mbytur, i shpejtë, si ai që bën një orë kur është e mbështjellë me pëlhurë pambuku*. U mundova të mbushesha me frymë; ama oficerët akoma nuk dëgjonin gjë. Nisa të flisja akoma më shpejt, më me vrull; por zhurma vazhdonte të shtohej pandërprerë. U çova në këmbë dhe fillova të grindesha për kotësi, me një ton të lartë dhe me gjeste të dhunshme; por zhurma shtohej. Pse nuk *po* largoheshin? Ecja lart e poshtë nëpër dysheme me hapa të rëndë, si i tërbuar nga vërejtjet e burrave, por zhurma vazhdonte pa pushim. O Zot! Çfarë *mund* të bëja? Shkumoja, çmendesha, shaja! Mora karrigen ku isha ulur pak më parë dhe e fërkova mbi dërrasat e dyshemesë, por zhurma tejkalonte gjithçka dhe vazhdonte të shtohej. Po bëhej përherë e më e fortë, më e fortë, *më e fortë*! Ndërsa burrat ende vazhdonin të bisedonin dhe të buzëqeshnin tërë kënaqësi. Ishte vallë e mundur të mos e dëgjonin? Zot i Gjithëpushtetshëm; jo, jo! Ata e dëgjonin! Dyshonin! *E dinin*! Po talleshin me tmerrin tim! Këtë mendoja dhe akoma e mendoj. Por gjithçka ishte më e lehtë se kjo dhimbje! Çdo gjë do ishte më e përballueshme se kjo përqeshje! Nuk i duroja dot më ato buzëqeshje hipokrite! E ndjeva që duhet o të ulërija, o të vdisja!... dhe pastaj... sërish!... dëgjojeni! Më e fortë! Më e fortë! Më e fortë! *Më e fortë*!

"Të poshtër" bërtita, "mjaft u shtirët! E pranoj krimin! –Shkulini dërrasat! Këtu! Mu këtu! Janë rrahjet e zemrës së tij të neveritshme!"

Besimi në utopinë socialiste e çoi fillimisht Kinmasa Katsunon (1901 – 1983) në Paris, pastaj në Moskë, e më pas në Siberi si i burgosur pa asnjë të drejtë. Ndryshe nga dhjetëra mijëra të burgosur të tjerë të Gulagut, Katsuno mbijetoi dhe u bë ndër të parët që i tregoi botës për tmerrin e makinës staliniste të represionit.

«SOLZHENICINI JAPONEZ»: Si mbijetoi komunisti japonez në Gulag

Nga Oleg Jegorov

Represioni shtetëror në Bashkimin Sovjetik gjatë sundimit të Stalinit në vitet 1930-1950 pati një ndikim të madh mbi shoqërinë sovjetike: sipas vlerësimeve më modeste, mbi 786 mijë persona u bënë viktima të terrorit shtetëror, ndërsa rreth 3.8 milionë kaluan nëpër burgje dhe kampe.

Çuditërisht, një ndër njerëzit e parë që publikuan libra me dëshmi dokumentare për Gulagun ishte japonezi Kinmasa Katsuno. Librat e tij, *«Permafrost – Shënime nga kampet e përqendrimit stalinist»* dhe *«Ditari i arratisjes nga Rusia komuniste»*, u botuan në Japoni gjatë viteve 1930, pasi Katsuno, i mbijetuar nga vite të tëra punë skllavëruese në kushte çnjerëzore, u kthye në atdheun e tij. Por si përfundoi ai në Bashkimin Sovjetik?

«I çmenduri» nga prefektura Nagano

Katsuno, i lindur në vitin 1901 në prefekturën Nagano, që në moshë të re mbrojti interesat e njerëzve të thjeshtë. Qysh në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare mbajti në klubin e fshatit një fjalim mbi padrejtësitë e sistemit shtetëror. «Dy ditë më vonë më arrestoi policia dhe kalova dy ditë në qeli. Historia u bë e njohur në fshatin tonë – doli një artikull në gazetën lokale, ku më quanin "i çmendur"», – kujtonte ai në «Autobiografinë» e shkruar në vitin 1934 në një kamp sovjetik.

Natyrisht, i riu nuk ishte i çmendur, por më shumë një entuziast me një ndjenjë të fortë drejtësie, i magjepsur nga idetë marksiste. Katsuno refuzonte çdo kompromis, çka bëri që ai të gjendej vazhdimisht në situata të pakëndshme. Për shembull, në vitin 1918 e përjashtuan nga universiteti «Nihon» pasi shkroi një artikull ku kërkonte demokratizimin e arsimit.

Studenti këmbëngulës dhe i talentuar u regjistrua në një universitet tjetër, «Waseda». Atje ai gjeti bashkëmendimtarë, me të cilët botoi revista të afërta me partitë e majta, mori pjesë në protesta dhe u arrestua dy herë. Ndërsa Japonia militarizohej gjithnjë e më shumë, qeveria bëhej gjithnjë e më e pamëshirshme ndaj të majtëve. Kështu, në vitin 1924, Katsuno largohet nga Japonia për në Francë.

Drejt shokëve jashtë atdheut

Në Paris, për aktivistin japonez gjithçka filloi nga e para: jetesa në varfëri, studimet (këtë herë në Sorbonë), njohjet me komunistët vendas, protestat. «Në Paris shpesh zhvilloheshin demonstrata. Një herë një vajzë komuniste më kapi për dore duke më thënë: "Hej japonez, hajde edhe ti!" Ende e kujtoj entuziazmin që ndjeva atë çast. Pas hyrjes në Partinë Komuniste Franceze mora pjesë në organizimin e grevave të punëtorëve. Kishim ndjenjën se revolucioni botëror do të ndodhte së shpejti,» – kujtonte më vonë Katsuno.

Ashtu si në Japoni, as autoritetet vendase nuk ishin entuziaste për aktivitetin e Katsunos: në vitin 1928 ai u dëbua. «Revolucioni mund të bëhet kudo, por jo në Francë,» – shënoi Katsuno fjalët e policëve francezë. Nëpërmjet Gjermanisë, me ndihmën e Kominternit – lëvizjes ndërkombëtare të komunistëve – ai u nis drejt Bashkimit Sovjetik. Dukej se aty një aktivist i majtë nuk do të kishte kurrfarë problemi.

Kurthi i Moskës

Gjithçka filloi mirë: në Moskë, Katsunos i dha mbështetje Sen Katayama, veteran i luftës politike në Japoni dhe figurë e rëndësishme e Kominternit. Katsuno punonte si sekretar i Katayama-s, jepte mësim në Institutin e Orientalistikës, shkruante shumë – si në gazetat sovjetike, ashtu edhe në botimet ilegale japoneze që shtypeshin me ndihmën e Kominternit.

Me sa duket, Katsuno kishte ndërmend seriozisht të qëndronte në «vendin e punëtorëve dhe fshatarëve»: ai mësoi gjuhën, mori shtetësinë sovjetike dhe madje një pseudonim rus – Aleksandër Ivanoviç. Por shumë shpejt, këtë emër iu desh ta nënshkruante në procesverbalet e arrestimit të tij.

Sipas shpjegimit të punonjësve të Muzeut të Historisë së Gulagut në Moskë, Katsuno ra në vështirësi për shkak të konfliktit të brendshëm në seksionin japonez të Kominternit: kundërshtarët politikë të mësuesit të tij, Katayama-s, akuzuan fraksionin e tij për tradhti, dhe shumë komunistë japonezë, përfshirë edhe Katsunon, përfunduan pas hekurave.

«Në fund të tetorit 1930, po qëndroja në një stacion tramvaji. Fytyrën ma përkëdhelnin butësisht flokët e ftohtë të borës që binin. Pikërisht atë çast, dikush më kapi fuqishëm prej krahu. E pashë veten të shtrënguar mes dy burrash trupmëdhenj me kapele. Më dërguan në godinën qendrore të OGPU-së (Drejtoria e Bashkuar Politike Shtetërore) në Lubjankë,» – përshkruante Katsuno ditën e arrestimit të tij. Atij iu ngrit akuza për spiunazh në favor të një shteti të huaj.

Në kantierin e madh stalinist

OGPU-ja nuk kishte asnjë provë për fajësinë e Katsunos: siç tregojnë protokollet e marrjes në pyetje, ai pyetej pse komunikonte me shkencëtarë dhe ushtarakë, duke u akuzuar pa prova për dërgimin e të dhënave në Japoni. «E konfirmoj kategorikisht absurditetin e plotë të akuzës ndaj meje për spiunazh», shkruante punonjësi i Kominternit. Gjatë tetëmbëdhjetë muajve që kaloi në burg, ai shpalli dy herë grevë urie, duke kërkuar ose ekzekutimin, ose lirimin e tij.

Në vend të kësaj, ai u dënua me pesë vjet punë të detyruar dhe fillimisht u dërgua në një kamp siberian pranë Mariinskut në rajonin e Kemerovës, ndërsa më vonë – në ndërtimin e kanalit të Detit të Bardhë–Detit Baltik. Ishte ky një projekt i përmasave gjigante dhe çnjerëzore i epokës staliniste – mbi njëqind mijë të burgosur duhej të hapnin një kanal 227 kilometra të gjatë mes Detit të Bardhë dhe liqenit Onega, brenda njëzet muajsh, pa përdorur asnjë mjet teknike, vetëm me lopata dhe karroca dore.

«Ishte qetësi që të kallte tmerrin. Pas horizontit të netëve të bardha zgjatej një ditë e turbullt, pa dritë. Këtu u dërguan turma njerëzish. Të gjithë këta njerëz ishin skllevër», kujtonte kampin Katsuno. Çdo ditë, nga ora 5 e mëngjesit deri në mesnatë, ata duhej të thyenin gurë dhe të transportonin dhera. Nuk kishte asnjë ditë pushimi, asnjë moment pushimi; atyre që nuk realizonin normën ditore, u shkurtohej racioni i ushqimit.

Katsuno mbijetoi në mënyrë të mrekullueshme – pas një dëmtimi serioz që pësoi gjatë punës, u transferua në qendrën mjekësore, ku mbeti deri në fund të dënimit, duke ndihmuar mjekët. Ky ishte një fat i rrallë për të burgosurit e kampit BelBaltlag – sipas të dhënave të ndryshme, gjatë ndërtimit të kanalit humbën jetën nga 12 deri në 50 mijë persona.

Lamtumirë, Bashkimi Sovjetik

Në qershor të vitit 1934, Katsuno u lirua para kohe. Pas asaj që kishte parë dhe provuar në kampet e përqendrimit, ish-aktivisti ishte zhgënjyer qartë nga komunizmi. Në Moskë, pa pritur arrestimin e radhës, ai u drejtua menjëherë në ambasadën japoneze dhe prej andej u kthye në atdhe.

"

Që në verën e vitit 1934, në gazetat japoneze u botuan artikuj mbi «iluzionet e humbura» ndaj «Rusisë së kuqe», me dëshmi të Katsunos mbi përvojat e tij në kampet sovjetike; qeveria i përdori këto për propagandë antikomuniste. Megjithatë, Katsuno – të cilin e quajtën «Solzhenicini japonez», në analogji me shkrimtarin rus që tregoi për Gulagun në prozën e tij – preferoi të qëndronte larg politikës. Ai botoi kujtimet e tij, u mor me biznesin familjar në industrinë e drurit dhe bamirësinë, dhe pati një jetë të gjatë. Ai vdiq në vitin 1983, trembëdhjetë vite përpara se qeveria ruse ta rehabilitonte plotësisht «Aleksandër Ivanoviçin», qytetarin japonez të Bashkimit Sovjetik.

© ExLibris

AGNES RAVATN

Gjyqi i zogjve

Fragment nga romani

Përktheu nga origjinali në dialektin nynorsk të norvegjishtes: Aristidh Shqevi

Të rrahurat e pulsit m'u përshpejtuan teksa këmbët e ronitura vazhdova t'i tërheq zvarrë përmes pyllit, ku s'pipëtinte asgjë. Herë-herë, dëgjohej çirrma e një zogu, por veç saj, syri të kapte vetëm pemë gjetherënëse të përhirta, kryekëput të zhveshura, fidanë druri, që sapo kishin nxjerrë degë, si dhe një dëllinjë të çuditshme jeshile, e cila nën rrezet e zbehta të diellit të prillit, shndërrohej thuajse në blu. Aty ku monopati i ngushtë vinte rrotull një shkëmbi të madh, u shfaq një rruginë e lënë pas dore, që kufizohej me mështekna të bardha e të drejta. Çdo mështekën kishte një ndërlikje degësh në majë, që ngjasonte me një fole zogjsh në ndërtim e sipër. Në fund të rruginës ndodhej një rrethojë e zbërdhulët dhe një portë me kangjella. Përtej portës: shtëpia. Një vilë e moçme dhe një çati mbuluar me plloça.

Mbylla portën me kangjella pas meje, kalova sheshin e vogël dhe ngjita shkallët e pakta deri te dera e jashtme. Trokita në derë, por askush nuk e hapi; vetvetiu lëshova një psherëtimë. Vendosa çantat mbi shkallë, zbrita poshtë dhe ndoqa pllakat e gurta, që formonin një lloj rrugine rreth shtëpisë. Mbi ballinën e saj, shpalosej një peizazh i mrekullueshëm. Male ngjyrë vjollcë, mbuluar vende-vende nga dëbora, shtriheshin në anën tjetër të fjordit, ndërsa shtëpia ishte e rrethuar nga shkurre dhe gëmusha në të dy anët e saj.

Ai po rrinte në kopsht pranë një rreshti me pemë, trungjet e të cilave ishin tepër të hollë. Shpina e gjatë, i mbulohej nga një pulovër e leshtë ngjyrë blu të errët. Ai u hodh përpjetë, sapo i bëra shenjë me kokë. Ktheu trupin, më përshëndeti me njërën dorë dhe filloi të ecë drejt meje, duke u çapitur me çizmet e tij të rënda përmes tokës, që kishte marrë një nuancë bluje në të verdhë. U mbusha me frymë. Fytyra dhe trupi i një mashkulli rreth të dyzetave, që nuk të jepte as shenjën më të vogël, se kishte nevojë për ndihmë. Habinë time e fsheha pas një buzëqeshjeje, pas së cilës ndërmora disa hapa drejt tij. Ai ishte i thukët në shtat dhe i zeshkët në fytyrë. Teksa shtriu dorën për të më takuar, iu shmang vështrimit tim, duke parë në një drejtim të pacaktuar.

"Sigurd Bagge."

"Allis Hagtorn," thashë unë, duke ia shtrënguar dorën lehtas.

Asgjë në fytyrën e tij nuk më dha të kuptoj, se mund të më kishte parë diku. Pas gjithë gjasave, ai ishte thjesht një aktor i mirë.

"Ku i ke çantat e udhëtimit?"

"Mbrapa shtëpisë."

Kopshti, që dukej pas shpatullave të tij, ishte tragjedia e një dimri të zymtë, me protagonistë shkurret e vyshkura, kashtën e qullur dhe ferrishtat. Me ardhjen e pranverës, kopshti do të kthehej në një xhungël të vërtetë. Ai shqoi shqetësimin në fytyrën time.

"Po. Këtu ka nevojë për shumë punë."

Unë buzëqesha dhe miratova me kokë.

"Kopshti është projekt i time shoqeje. Ajo ka ikur në një udhëtim të gjatë, gjë që shpjegon edhe nevojën time për ndihmë."

E ndoqa teksa i ra përqark shtëpisë. Ai mori një çantë në secilën dorë, dhe pak më vonë, u fut në sallonin e shtëpisë.

Me hapa të rëndë, që përplaseshin mbi shkallët e vjet-ruara, më çoi në katin e dytë. Dhoma ime ishte e mobiluar shumë thjesht, një shtrat i vogël, një komo dhe një tavolinë shkrimi. Vinte erë pastërti. Shtrati ishte i rregulluar, por ajo që binte në sy ishin çarçafët me lule.

"Dhomë e bukur."

Ai u kthye në krahun tjetër pa thënë asnjë fjalë, uli kokën dhe doli nga dhoma. Pas një çasti, bëri me kokë nga banja, zbriti shkallët, gjë që bëra edhe unë, pastaj doli nga shtëpia, kaloi cepin e saj, përshkoi sheshin përpara dhe iu drejtua barakës. Një gërvimë e thatë u dëgjua teksa ai hapi derën dhe tregoi faqen e murit përballë: sfurk, lopatë e gjerë, qysqi.

"Për barin e lartë duhet të përdorësh kosën, gjithmonë, di ta përdorësh?"

Pohova me kokë, duke u gëlltitur.

"Këtu ke për t'i gjetur të gjitha veglat e nevojshme, nëse në një farë mënyre, i njeh. Për shembull, gërshërët e mëdha për punime në kopsht," vazhdoi ai. "Sistemimi i gardhit do të më kënaqte jashtë mase. Më njofto, nëse mungon ndonjë vegël e posaçme, pasi aty për aty, do t'i marrësh paratë për ta blerë.

Ai më foli, pa e marrë mundimin të më shikonte në sy. Unë isha shërbëtorja e tij, ndaj duhej mbajtur njëfarë distance, që në krye të herës.

"Ishin të shumtë ata që iu përgjigjën njoftimit tuaj në gazetë?" pyeta unë padashur.

Ai më hodhi një shikim të shpejtë nën tufën e flokëve të zinj, që i derdhej mbi ballë.

"Po, një numër goxha i konsiderueshëm."

Arroganca e tij dukej e shtirë, por unë nga ana ime, nuk i dhashë të kuptojë asgjë. Isha prona e tij, kësisoj ai mund të bënte çfarë të donte. Vazhduam t'i biem përqark shtëpisë, zbritëm në kopsht, dhe pastaj kaluam përballë shkurreve me pemla dhe pemë frutore, në të dy anët e rruginës së vogël, shtruar me pllaka guri. Ajri ishte aq i pastër, sa të shponte hundët. Kudo përqark vinte erë vlagë dhe bari të vruguar e të kalbur. Ai kaloi përmes një porte prej hekuri të derdhur dhe u kthye nga unë. "Ka zënë ndryshk," tha ai, "ndoshta mund të bësh diçka edhe për këtë." Shkallë të rrëpirëta e të larta të çonin drejtpërsëdrejti nga qoshja e kopshtit te fjordi, që shtrihej më poshtë. Numërova të gjitha shkallët një për një, deri në fund. U ndala ekzakt te numri njëqind. Tanimë, qëndronim në një mol të vogël ndërtuar me gurë, me një hangar për barka në anën e djathtë, tepër të vjetruar, si dhe një vend të posaçëm për sigurinë e tyre. Muret shkëmborë të fjordit formonin një gjysmërrethi, që ia bllokonin pamjen molit në të dy anët e tij. E gjitha kjo, më solli ndër mend vendin ku kisha mësuar të notoja, thuajse tridhjetë vite më parë, pranë një shtëpie pushimi, të cilën prindërit e mi e kishin marrë me qira nga dikush.

"Sa bukur që qenka këtu!"

"Them që një ditë ta prish hangarin e barkave," tha ai pa shikuar nga unë. Era, që frynte nga fjordi, i shpupuriti flokët.

"Keni barkë?"

"Jo," u përgjigj ai prerazi. "Atëherë. Këtu nuk kemi se ç'bëjmë më shumë. Gjithsesi, edhe këtë e pe."

Ai ktheu trupin dhe nisi t'u ngjitet shkallëve.

Dhoma e tij e gjumit ndodhej në katin përdhes, përballë kuzhinës dhe dhomës së ngrënies, ndërsa dritaret, shikonin nga kopshti. Përbrenda ajo komunikonte drejtpërsëdrejti me studion e tij.

"Pjesën më të madhe të ditës e kaloj aty. Ke për të më parë rrallë, madje do të preferoja që të shqetësohesha sa më pak që të ishte e mundur."

Miratova me kokë, një herë të vetme, për të treguar se e kisha kuptuar seriozitetin e çështjes në fjalë.

"Për fat të keq, makinë nuk kam, por kam biçikletë me dy shporta për ushqime dhe gjëra të tjera. Dyqani ndodhet dy kilometra në veri të rrugës kombëtare. Mëngjesi shërbehet në orën tetë: dy vezë të ziera mirë, harengë të tymosur, dy feta bukë thekre, dhe një kafe të zezë," saktësoi ai.

"Në fundjavë, parimisht je e lirë, por meqenëse do të jesh gjithsesi këtu, mëngjesin mund ta përgatitësh një orë më vonë se zakonisht. Dreka është në orën një. Darka në gjashtë, dhe menjëherë pas saj, një kafe dhe një gotë me konjak."

Kësisoj ai u fut në studion e tij, ndërsa mua m'u dha mundësia për t'u njohur më mirë me kuzhinën. Shumica e pajisjeve ishin të përdorura, por gjithsesi në gjendje shumë të mirë. Hapa sirtarët dhe dyert e rafteve, duke u munduar të bëja sa më pak zhurmë. Në frigorifer kishte fileto merluci, që do t'i ndanim mes nesh për drekë.

Mbulesat e tavolinave i gjeta të palosura në sirtarin e poshtëm të kuzhinës, zgjodha njërën prej tyre, dhe e shtrova në tavolinën e bukës, thuajse në qetësi të plotë. Në orën gjashtë fiks, ai doli nga dhoma e gjumit, tërhoqi karrigen dhe u ul në krye të tavolinës. Priti. Pjatën e madhe me peshk e vendosa në mes, ndërsa tasin me patate, ia vura përballë. Më pas, tërhoqa karrigen tjetër për t'u ulur, por ai më ndaloi me një lëvizje të prerë të dorës.

"Jo. Ti do të hash mbasi të kem mbaruar unë."

Shikimin e mbajti përpara.

"Faji është i imi. Ndoshta nuk u shpjegova qartë."

M'u mblodh një nyjë në grykë, rrëmbeva pjatën time dhe u shpërngula tek banaku i kuzhinës, pa nxjerrë asnjë tingull nga goja, me kokën ulur, një gjatoshe e mjerë.

Teksa ai hante, unë mbusha lavamanin me ujë, lava tenxheren dhe bashkë të edhe garuzhdën. Ai rrinte ulur, trupin e mbante drejt, mbllaçiste pa zhurmë, por sytë nuk i ngriti asnjëherë lart. Me përpjekje të plogështa, përgatita kafenë, mora konjakun nga rafti me xhama mbrapa shpinës së tij, dhe pastrova tryezën, pikërisht në çastin që ai kishte mbaruar së ngrëni. Mbusha filxhanin me kafe, gotën e vogël me konjak, i vendosa të dyja në një tabaka, dhe duke m'u dredhur këllqet, ia çova atij. Pak më vonë, me t'u ngritur në këmbë, ai më falënderoi për ushqimin dhe u fut sërish në studion e tij; unë u ula në tavolinë për të ngrënë racionin tim, tashmë të vakët, dhe hodha gjalpin gjysmë të shkrirë mbi patatet e mbetura. Më pas, lava pjatat, pastrova tavolinën bashkë me banakun e kuzhinës dhe mora drejtimin për nga dhoma ime. Pa vonesë, boshatisa çantat e udhëtimit, sistemova rrobat, çorapet dhe të brendshmet në sirtarët e komosë, ndërsa librat i stivova mbi tavolinën e shkrimit. Pastaj, kontrollova celularin, për t'u siguruar se e kisha fikur, dhe e lashë në sirtarin e vogël të tavolinës. Nuk kisha ndër mend ta ndizja, me përjashtim të ndonjë rasti të jashtëzakonshëm. U ula në heshtje të plotë, nga frika se mos bëja zhurmë. Nga kati i poshtëm nuk dëgjohej asnjë psherëtimë. Më në fund, pas një vizite të shpejtë në banjë, rashë në shtrat për të fjetur.

* * *

Tehu i kosës duhej të ishte topitur. Unë nëma barin e lagur dhe të zverdhur, që i bënte bisht kosës, pavarësisht forcës që ushtroja mbi të dhe zhdërvjelltësisë me të cilën e përdorja. Qielli ishte i zënë, ajri i lagësht. Pas mëngjesit, ai ishte futur menjëherë në studion e tij. Teksa po dilja, i hodha vetes një shikim të shpejtë në pasqyrë. Vura re se isha veshur çuditshëm. Me pantallonat që kisha lyer shtëpinë e prindërve të mi, në stinën e verës, rreth pesëmbëdhjetë vite më parë. I kisha gjetur në dollapin e shtëpisë sime, bashkë me këmishën e spërkatur me bojë, dy mbrëmje para se t'i paketoja teshat, për të ardhur këtu. Të nesërmen në mëngjes, kur dola nga shtëpia për të marrë autobusin, prindërit e mi, të lehtësuar, më përshëndetën dhe më uruan rrugë të mbarë.

Fillova ta ndiej lodhjen në shpinë. Këmisha më ishte bërë qull në djersë. Insekte të vogla, që zukatnin rrotull, herë më uleshin mbi flokë, herë mbi ballë, duke më shkaktuar kësisoj, kruajtje të mëdha. Gjatë gjithë kohës isha e detyruar ta ndërprisja punën, t'i hiqja dorezat, dhe ta kruaja fytyrën. Tufëzat e gjata e të zverdhura të barit, më vinin në lojë, sa herë që i sulmoja me fuqinë maksimale, me kosën shtrënguar në duar.

"Në vendin tënd, do të përdorja sfurkun."

Rrotullova trupin. U shtanga, përballë kisha Bagge-n. Duhet t'i jem dukur si një e çmendur, me fytyrën të përflakur, dhe me rrecka pesëmbëdhjetëvjeçare në trup. Tufën e flokëve, që më ishte ngjitur në ballë, e largova instinktivisht, por vendin e tyre e zunë menjëherë disa cikla balte.

"Kur bari është i lagur, kosa nuk hyn dhe aq shumë në punë."

"Jo." Disi e përulur u përpoqa të buzëqesh.

"Mos harro drekën," tha ai teksa goditi lehtazi kyçin e dorës, si për të ma kujtuar, se

për pak orë, dreka duhej shtruar. Ai më ktheu kurrizin dhe u largua. Në atë çast, i hodha nxitimthi një sy shtëpisë, në të vërtetë, më tepër dritares sesa studios. Ai ishte ndalur pranë saj dhe më kishte vëzhguar teksa bëja përpjekje të dëshpëruara, për t'u marrë me kopshtari, derisa më në fund, nuk kishte duruar më dhe kishte zbritur poshtë. E ndjeva veten si në gjemba. Rrëmbeva kosën, e çova në depo dhe e vara në faqen e murit nga ku e kisha marrë. Më pas, me sfurkun në dorë u ktheva në kopsht. Me dhëmbët e tij krova sipërfaqen e tokës thuajse moçalore, ndërsa sasinë e barit të kalbur, që të shkiste nga dora, e hodha në karrocën e dorës.

* * *

Biçikleta ishte mbështetur tek qoshku i druve, pikërisht mbrapa depos së veglave. Ishte një *Peugeot* e vjetër, e shpejtë, ngjyrë gri, me rrota të vogla dhe timon të kthyer nga brenda. Për të shkuar deri tek dyqani, m'u deshën më pak se dhjetë minuta. Ishte një dyqan bakalli, në një bërryl rruge. Përballë urës, i harruar nga koha. Teksa hapa derën, u dëgjua tingëllima e një zileje. Klientë të tjerë nuk kishte. Një grua e moshuar, që qëndronte prapa banakut, mezi iu përgjigj përshëndetjes sime me kokë. Në dyqan kishte ushqim të paketuar, peceta, qirinj, bukë, bulmetra, një frigorifer dyqani, si dhe fruta dhe perime, të cilat, çdo klient duhej t'i peshonte vetë.

Teksa u enda mes radhëve të rafteve gjysmë të zbrazura, shitësja syshqiponjë, më ndoqi me vështrimin e saj pandërprerë. Ishte një vështrim kritik dhe domethënës. Ajo më kishte njohur. Ndjeva një rëndim në stomak; me lëvizje të plogëta, zgjodha disa ushqime nga raftet dhe i vendosa në shportë, edhe pse doja që asaj të mos ia hidhja më sytë dhe të largohesha njëherë e më parë nga dyqani. Më në fund, iu afrova për të paguar dhe lashë mallrat mbi banak, pa e parë në sy. Pa kurrfarë shprehie në fytyrë, ajo regjistroi çmimin e çdo malli. Duar dhe fytyrë me rrudha, dhe një gojë që varej në të dy anët e saj; kështu ishte ajo, mendova me vete e lehtësuar, teksa ngisja biçikletën drejt shtëpisë. Sjellja e saj nuk kishte asnjë lidhje me mua, ajo thjesht ishte e tillë.

Biçikleta ishte me goma të holla, por gjithsesi, e shpejtë, ndaj rrita shpejtësinë, duke pasur fjordin në krahun e majtë dhe faqen shkëmbore të malit në krahun e djathtë. Shkëmbi, ishte i lagur nga shirat, kishte ngjyrë të zezë, por çuditërisht, shndriste. Mallrat e blera ishin në koshin e biçikletës, mbi rrotën e pasme, ndërkohë makinat më parakalonin në rrugën, që lidhte dy qytetet fqinjë. Më pas, zbrita në rruginën e pjerrët shtruar me zhavorr, kalova mes pyllit, dhe së fundi, futa biçikletën brenda qoshkut të druve. Zhavorri krakëlliti nën peshën e hapave të mi; pas pak, u futa në sallon dhe vazhdova të ec përgjatë dyshemesë. Në këtë shtëpi kishte shumë gjëra, që nuk shkonin. Nuk ishte e mundur, që një çift të jetonte kësisoj, pa u kujdesur për kopshtin, pa makinë, me burrin e shtëpisë të mbyllur gjithë ditën në studion e tij, dhe gruan të ikur. Sendet e blera i vendosa në vendin e tyre, dhe më pas, nisa ta përgatis vaktin kryesor të ditës.

* * *

Isha bllokuar thuajse plotësisht. Trupin e ndieja të mpirë dhe të rëndë si porta e ndryshkur prej hekuri të derdhur. Për një copë herë qëndrova pa lëvizur, duke shikuar gungat e tavanit të drunjtë, pastaj rrotullova trupin në dyshek, derisa përfundova në dysheme. Çfarë idiotësie! Kur ishte hera e fundit që kisha bërë punë fizike? Herë të fundit nuk kishte, pasi me punë të tillë nuk isha marrë kurrë. Të paktën, jo më parë se të filloj ta mbledh barin me krehër dhe ta punoj tokën e ngurtë me shat, për orë të tëra.

Duke u tundur sa majtas-djathtas dhe me fytyrë të ngrysur, kalova nga kuzhina te tavolina e bukës, për t'i shërbyer mëngjesin atij. Më pushtoi njëfarë stepjeje dhe turpi; isha e vetëdijshme se lëvizjet e mia të plogëta e kishin nervozuar. Teksa u bëra gati që t'ia mbushja kupën me kafe, lëshova një ofshamë të thellë; ishte e vështirë ta përcaktoje, se cili prej nesh mendonte se ishte brengosur më shumë.

"Dje sikur e teprova pak me punën që bëra në kopsht," thashë unë, duke u munduar të shfajësohem.

Ai pastroi fytin dhe hoqi sytë nga unë.

Pas mëngjesit, ai u kthye në dhomën e tij pa thënë asnjë fjalë. Më pas, teksa pija kafenë e hidhur vetëm fare, e ndjeva se rashë nga gjendja shpirtërore. Një ditë më parë, isha ndier krenare për veten teksa pastroja kopshtin nga bari i kalbur, duke shpresuar në të njëjtën kohë, se ai patjetër që duhej të më kishte parë nga dritarja. Shpina më ishte mpirë keq.

Dita e nesërme shkoi akoma më për ibret. Të bëja thjesht një hap përpara, më shkaktonte dhimbje të tmerrshme. Gjithë ditën nuk u ula fare, pasi e dija, se nuk do të isha në gjendje të ngrihesha sërish në këmbë. Entuziazmi im për kopshtarinë kishte zgjatur vetëm një ditë. Kësisoj ndodhte gjithmonë. I përvishesha punës me një frymëzim të lartë, por mbillja misër e korrja tallë. Më mungonte ngulmi për t'i çuar gjërat deri në fund, ndaj gjithnjë korrja e nuk lidhja. Nuk kisha as këmbëngulje, as vijueshmëri. Kisha shpresuar, se pikërisht këto dy tipare, forcën e vullnetit dhe disiplinën e hekurt, do t'i ndryshoja. Problemi ishte se për ta kultivuar forcën e vullnetit, nevojitej forcë vullneti. Njeri më i qëndrueshëm, kjo ishte ajo çka duhej të bëhesha. Ishte gjithashtu e domosdoshme, që të formoja, një karakter më të fortë. O tani, o kurrë. Këtu kisha gjithçka që më nevojitej, vetminë, ditët e gjata dhe do detyrime të parashikueshme; përpos kësaj, ndihesha e çliruar nga vëzhgimet bezdisshme dhe llomotitjet e të tjerëve, dhe për më tepër, kisha një kopsht, që më përkiste i tëri.

* * *

Në mbrëmjen e ditës së shtatë, me të vendosur tabakanë, xhezven, filxhanin e kafes dhe gotën e konjakut në tavolinën e bukës, u bëra gati të largohesha, por befas ai më ndali me një lëvizje të dorës. Ishte e martë. Kisha një javë që i gatuaja për të ngrënë, por idetë, se ç'mund t'i gatuaja më tej, më kishin shteruar. Sot: pulë me estragon. Të hënën: fileto merluci me qepë të verdhë. Të dielën: mish viçi të pjekur në furrë. Të shtunën: mish kau të pjekur. Të premten: fileto trofte të pjekur me sallatë trangulli. Të enjten: salsiçe të skuqura me salcë kosi. Të mërkurën: fileto merluci të zier.

"Allis."

Ishte e hera e parë që e dëgjoja të më thërriste në emër.

"Po?"

"Më sill një filxhan dhe një gotë tjetër, dhe më pas, eja ulu këtu."

Veprova ashtu siç më urdhëroi. Me një dorë të sigurt, ai mbushi me kafe gotën prej porcelani të brishtë.

"U bë një javë që ke ardhur," tha ai, me shikimin nga cepi i tavolinës.

Unë heshta.

"Ndihesh e lumtur këtu?" Ai i ngriti sytë lart.

"Po."

"Si e ke syrin, a do të mund të qëndrosh pak më gjatë?"

"Po, sigurisht. Faleminderit."

"Pagën do ta marresh në fund të muajit. Në rregull?"

Miratova me kokë.

"Ke ndonjë pyetje?"

Për një çast ngurrova.

"A mund të më thuash sa kohë do të kem mundësi të punoj këtu?"

"Për aq kohë sa gruaja ime do të vazhdojë udhëtimet e saj, do të kem nevojë për ndihmë në shtëpi dhe kopsht. Si për fillim, gjithë pranverën dhe verën."

"Për mua, më mirë se kaq nuk bëhet."

Ai mbushi me konjak gotën time të vogël prej xhami dhe e ngriti lart në drejtimin tim.

"Atëherë, le të ngremë një dolli."

Pa u menduar gjatë, unë ngrita gotën time dhe me shumë kujdes e kërcëllova me gotën e tij, duke shkaktuar kësisoj një tringëllimë të lehtë. Kaluan disa çaste në heshtje. Pas kësaj, ai nuk shfaqi asnjë dëshirë për të folur, por nën cullufet e zeza, balli iu rrudh. Unë piva kafenë, zbraza gotën e konjakut, dhe para se ai të mbaronte, u largova nga tavolina dhe nisa të laj enët. E dëgjova që tërhoqi karrigen mbrapa, mori skërkat dhe u fut në dhomën e tij. Mendimi m'u turbullua disi nga fakti, që tashmë gjithçka ishte përcaktuar, unë do të qëndroja aty. Gjithsesi, për të njëjtën arsye, ndjeva ngrohtësi në zemër. Tani kisha një bazë, ku mund të qëndroja, dhe nuk isha e detyruar të kthehesha mbrapsht. Në këtë shtëpi, mund të jetoja në paqe.

* * *

Pas disa ditëve me diell, lagështira e kopshtit filloi të avullojë. Më në fund, kosës ia kisha marrë dorën, dhe kësisoj, mbrapa shpinës lashë një vazhdë bari të kositur. Edhe pse ajri ishte i ftohtë, filluan të më dalin bula djerse. Ndriçimi i zbehtë i diellit të pasdites, po strukej mbrapa maleve. Trupin nuk e ndieja nga lodhja. Gjithsesi, hodha një vështrim rreth e rrotull. Aty këtu, syri të kapte lule pranvere. Një ditë kishte pasur një stuhi me borë të imët, ndërsa të nesërmen, fare papritur, një flutur ishte ulur diku aty pranë. Moti ende nuk ishte stabilizuar. Krehrin e barit e tërhoqa me forcë mbi truall, mblodha kashtën dhe barërat e këqija, dhe pastaj i çova në fund të kopshtit me ndihmën e karrocës së dorës. Lehe të vjetra lulesh, prej dheu të ngjeshur e të errët, kishin nisur të shfaqeshin nën barërat e këqija. Ende nuk i kisha prekur, por sipas gjasës aty mund të kishte bulbe qepësh ose hudhrash, fara, madje dhe vetë jetë, që ishin në pritje për të shpërthyer në sipërfaqen e tokës. Nganjëherë, qëllonte që, në punë e sipër, ta ktheja trupin dhe ta hidhja shikimin nga shtëpia, dhe syri ta kapte Bagge-n kalimthi prapa xhamit të dritares. Ai largohej menjëherë, gjë që e bënte të pamundur ta përcaktoja, nëse kishte kohë që më vështronte apo thjesht ishte duke lëvizur nëpër dhomë.

Veglat e punës i ktheva në depo, çizmet i përplasa tek muri poshtë verandës, për t'ua hequr dheun që kishte mbetur në to, dhe më pas, u ngjita lart në banjën time. Mbusha vaskën me ujë, rrëshqita butë brenda saj, pastrova të gjitha çiklat e dheut, që më kishin rënë në trup, dhe ndjeva një ngazëllim të thellë për mundësitë, që më ofronte ekzistenca e re. Puna nën një qiell të hapur, ndjesia që ma përshkonte trupin, mbushja e mushkërive me ajër të pastër. Nuk e kisha besuar kurrë, se tek unë mund të ndodhte një ndryshim si ky. Një gjë të tillë nuk e kisha çuar kurrë ndër mend. Jo, asnjëherë. Herë pas here, ai kishte qenë thjesht një mendim lehtësues, por edhe brengosës në të njëjtën kohë, ndaj dhe nuk kisha besim. Po tani, ç'mund të thoja? Po angazhohesha: për të bërë punë në kopsht. Ta pastroja dhe t'i krijoja kushtet, që aty të kultivoja diçka. Shpëtimin mund ta gjeja pikërisht në atë kopsht dhe po aty mund të krijoja një identitet koherent, i cili nuk do të përmbante asgjë nga e kaluara ime. Aty mund të laja çdo mëkat, ta pastroja ndërgjegjen nga çdo lloj faji dhe të nisja një jetë të re me zemër të çiltër. Largova tapën plastike nga vaska dhe vura re nivelin e ujit që filloi të bjerë. Shpëlava trupin dhe flokët nën kokën e dushit dhe dola nga vaska. Dëgjova hapat e Bagge-s mbi dyshemenë e katit të mëposhtëm. Po ai, ishte i pastër? U fshiva me peshqir, u vesha dhe u futa në dhomën time. Nga dritarja e dhomës pashë Bagge-n teksa kalonte nga avllia në kopsht, ndoshta për të bërë aty ndonjë inspektim. Kërçepët e tharë të kashtës kërcitën nën këpucët e tij të mëdha dhe pas një çasti, vura re shpinën e tij që lëvizi përmes drurëve frutorë, poshtë shkallëve dhe më tej drejt molit të vogël. Ndjeva një dridhje në stomak. Sa të bukur që janë burrat, thashë me vete. Disa prej tyre. Zëri, shpatullat. Dola rrëmbimthi nga dhoma dhe provova të hap derën e dhomës përballë dhomës sime në sallon. Ishte e mbyllur. U ndala në krye të shkallëve. Për një çast, gati sa nuk zbrita poshtë, por u mjaftova me një vështrim rreth e rrotull. Teksa rrahjet e zemrës m'u shtuan nën kraharor, hoqa dorë nga ideja.

ARTI DHE IMITIMI I NATYRËS

Nga Prof. as. dr. Anton Papleka

Dy bukuritë

Ajo që ka thënë Platoni për të bukurën, vazhdimisht i ka shtyrë njerëzit të mendojnë. Gjithashtu, ai ka dalluar dy tipa të bukurisë: bukurinë që kapet nga shqisat dhe bukurinë që kapet nga intelekti. Ai ka thënë se bukuria që kapet nga shqisat është një grackë, sepse, që bukuria të ketë kuptim, duhet që kuptimi t'i paraprijë bukurisë, me qëllim që t'ia hapë rrugën. Mirëpo kur sundon shqisorja, kur kuptimin e prodhon shqisorja, asnjë kuptim nuk është në gjendje që të vijë e të hedhë dritë mbi bukurinë, meqenëse mund të prodhojë kuptim çdo formë e shqisores, me kusht që ajo të jetë shqisore. Gjithashtu nuk duhet ta keqinterpretojmë Platonin. Duke thënë se bukuria që kapet nga intelekti, qëndron më lart se bukuria që kapet nga shqisat, Platoni nuk është nisur nga urrejtja ndaj shqisores, por ka dashur të shpëtojë këtë të fundit. Ilustrim i këtij qëndrimi është shkalla e bukurisë te *Banketi.* Sa më shumë që shtohet kuptimi, aq më shumë shtohet dehja nga bukuria. Kjo provon, se mendimi jo vetëm nuk e zhduk pasionin, por përkundrazi i jep mundësi të shpërthejë më me vrull. Mendimtarët që erdhën pas Platonit, nuk kanë gabuar lidhur me këtë çështje. Tek ideali platonian, ata nuk kanë parë një arratisje në një botë të çmishëruar, por përkundrazi kanë parë forcën lëvizëse të pasionit. Kjo gjë shpjegon rëndësinë që pati platonizmi në kulturën oborrtare (khr. Denis de Rougemont, *Dashuria dhe Perëndimi,* Plon, 1970*)* (ashtu dhe në humanizmin e Rilindjes.

Bertrand Vergely

Platoni (427 – 347 para Krishtit)

Nga *REPUBLIKA*

Tani a dëshiron që, duke u mbështetur në këta shembuj, të kërkojmë të marrim vesh se çfarë mund të jetë imituesi?

Po deshe, tha ai.

Kështu, ka tri lloje shtretërish: një shtrat që ekziston në natyrën e gjërave dhe për të cilin mund të themi, mendoj, se Zoti është autori i tij, përndryshe kush do të ishte?...

Sipas mendimit tim, nuk do të ishte askush tjetër.

Një shtrat i dytë është ai që bën marangozi.

Po.

Dhe një i tretë është shtrati që bën piktori, apo jo?

E zëmë se është kështu.

Kështu, piktori, marangozi, Zoti janë tre persona që kanë në dorë krijimin e këtyre tri lloje shtretërish.

Po, tri lloje.

Dhe Zoti, qoftë se nuk ka dashur të veprojë ndryshe, qoftë se ka qenë i detyruar nga ndonjë domosdoshmëri për të bërë në natyrë vetëm një shtrat, ka bërë vetëm atë që realisht është shtrati, por dy shtretër të kësaj natyre apo disa shtretër, Zoti nuk i ka prodhuar kurrë dhe nuk do t'i prodhojë.

Përse? Pyeti ai.

Sepse po të bënte vetëm dy, prej tyre do të shfaqej një i tretë, forma e të cilit do të riprodhohej nga ata dy të tjerët dhe shtrati real do të ishte pikërisht ky, nuk do të ishin dy të tjerët.

Ke të drejtë.

Mendoj se Zoti duke e ditur këtë gjë dhe duke dashur të jetë realisht krijuesi i një shtrati real dhe të mos jetë fabrikuesi i një shtrati të veçantë, ka krijuar këtë shtrat unik për nga natyra.

Me sa duket po.

Pra, a dëshiron ta quajmë Zotin krijuesin e natyrshëm të këtij objekti apo të quajmë me ndonjë emër tjetër të ngjashëm?

Kjo do të jetë e drejtë, tha ai, sepse Zoti ka krijuar natyrën e këtij objekti dhe të të gjitha gjërave të tjera.

Po marangozin? A do ta quajmë atë punëtorin që bën shtratin apo jo?

Po.

Po piktorin, a do ta quajmë punëtorin dhe krijuesin e këtij objekti?

Aspak.

ARTI ËSHTË INTENSIFIKIM I REALES

Kur u dha autonomi shkencës, moralit dhe estetikës, Kanti zhvilloi një filozofi të kulturës, duke synuar që të tregonte se kishte disa mënyra për ta trajtuar realitetin. Kur e bëri këtë gjë, ai krijoi një konceptim të ri për unitetin e mendjes njerëzore, duke u bazuar te ndryshimi dhe vuri në dukje se kultura që i diferencon aftësitë e ndryshme të njeriut, është gjithashtu ajo që i bashkon. Ernst Cassirer-i që e quan veten si trashëgimtar të Kantit, e vazhdoi projektin e tij për ta konsideruar filozofinë si mendim për kulturën. Kjo gjë e shtyn të bënte dallimin midis mitit, artit, ligjërimit dhe shkencës. Kështu, artin dhe shkencën i ndan një hendek, meqenëse shkenca kërkon ta abstragojë botën reale, përkundrazi, që të mund ta njohë atë, arti kërkon ta bëjë sa më të kapshme nga shqisat, me qëllim që t'i japë një ndjeshmërie kolektive. Sidoqoftë, ndonëse janë të kundërt, arti dhe shkenca bashkohen me njëri-tjetrin, sepse të dy eksplorojnë një botë reale që nuk është as vetëm abstrakte, as vetëm e vetëm konkrete, sepse para së gjithash dhe kurdoherë ajo duhet të zbulohet, duhet të eksplorohet, duhet të imagjinahohet. Këtu e ka burimin e vërteta e veçantë e artit, e cila qëndron te ndihma që na jep për të deshifruar realen përmes intensifikimit që i bën asaj.

B. Vergely

Ernst Cassirer (1874-1945)

Nga *ESE PËR NJERIUN*

Si të gjitha format e tjera simbolike, arti nuk është riprodhim i thjeshtë i një realiteti të dhënë, të gatshëm. Ai është një nga rrugët që të shpien te një vizion objektiv për gjërat dhe për jetën njerëzore. Ai nuk është imitim, por është zbulim i realitetit. Megjithatë natyra që zbulojmë përmes artit, nuk është ajo për të cilën na flet dijetari. Ligjërimi dhe shkenca janë dy mënyrat kryesore që na japin mundësi të krijojnë dhe të përcaktojmë konceptet tona për botën e jashtme. Ne duhet t'i klasifikojmë perceptimet e shqisave dhe t'i mendojmë në formën e nocioneve të përgjithshme dhe të rregullave universale, me qëllim që t'u japim një domethënie objektive. Një klasifikim i tillë është rezultat i një përpjekjeje të vazhdueshme drejt thjeshtëzimit. Në të njëjtën mënyrë vepra e artit parakupton një veprim të tillë kondesimi dhe përqëndrimi (koncentrimi). Kur Aristoteli deshi të përkufizonte atë që e dallonte realisht poezinë nga historia, ai ngulmoi te metoda. Ai thotë se një dramë paraqet një aksion unik (mia praxis) që formon në vetvete një tërësi të plotë, që ka tërë unitetin organik të një krijese të gjallë; kurse historiani nuk duhet të shikojë me vërejtje një aksion të vetëm, por duhet të shikojë me vërejtje një periudhë të vetme dhe të gjitha ngjarjet që u kanë ndodhur një njeriu të vetëm apo disa njerëzve gjatë kësaj periudhe, sado të pavarura që mund të kenë qenë ato ngjarje.

Në këtë kuptim, si e bukura ashtu dhe e vërteta mund të karakterizohet me të njëjtën formulë klasike dhe të thuash se ato janë "një unitet brenda diversitetit". Por në të dy rastet, nuk vihet theksi mbi të njëjtin aspekt. Ligjërimi dhe shkenca janë paraqitje të përmbledhura të botës reale. Arti është intensifikim i reales. Ligjërimi dhe shkenca mbështeten tek i njëjti proces abstragimi. Artin mund ta paraqesim si një proces të vazhdueshëm konkretizimi. Përshkrimi shkencor i një objekti të dhënë niset nga një numër i madh vëzhgimesh që në pamje të parë formojnë një konglomerat të paqëndrueshëm faktesh të shpërndara. Por sa më shumë që të shkojmë përpara, aq më shumë këto dukuri të veçanta kanë prirje për të marrë një formë të përcaktuar dhe për të ndërtuar një të tërë sistematike. Shkenca kërkon tiparet thelbësore të një objekti të dhënë, nga të cilat mund të nxirren cilësitë e tij të veçanta. Në qoftë se një kimist di numrin atomik të një elementi, ai zotëron një tregues që i jep mundësi të njohë me saktësi strukturën dhe përbërjen e tij. Nga ky numër, ai mund të nxjerrë të gjitha veçoritë karakteristike të elementit. Mirëpo arti nuk e njeh këtë lloj thjeshtëzimi konceptual dhe këtë lloj përgjithësimi deduktiv. Ai nuk kërkon cilësitë apo shkaqet e gjërave, por na jep mundësi që me intuitën tonë të marrim me mend format. Megjithatë nuk është fjala për një përsëritje të thjeshtë të diçkaje që tashmë ka ekzistuar. Arti është një zbulim i vërtetë, autentik.

Përktheu: Anton Papleka



IRWIN SHAW

Vajzat me fustane verore

Zgjodhi dhe përktheu: Rudolf Marku

Irwin Shaw është një shkrimtar amerikan, që ka vdekur në moshën 70 vjeçare, në vitin 1984.

Dramaturg, skenarist,romancier dhe tregimtar, është autor, librat e të cilit, sa qe gjallë, janë shitur në mbi 15 milion kopje.

Ndër veprat më të njohur të tij mbeten romanet 'Luanët e rinj' - bërë film me të njëtin titull, 'Young Lions' ku lozin krahas të tjerëve, Marlon Brando dhe Montgomery Clift, si dhe romani 'Të Varfër, të Pasur'-një miniserial televiz tepër popullor i fundviteve '70.

Personalisht mua më pelqejnë sidomos tregimet e këtij shkrimtari. Për herë të parë në shtypin shqiptar, kam botuar, me përkthimin dhe zgjedhjet e mia, në revistën 'Nëntori' dhe në gazeten 'Drita', andej nga vitet 1986-1988, tre tregime të Irwin Shaw-it, të cilat u patën pritur shumë mirë nga lexuesit. Mes këtyre tre tregimeve është dhe ky që po botoj sot për lexuesit e ExLibris, duke qënë i bindur se ky tregim do të pëlqehet prapë, në mos më tepër, po aq sa para 40 vitesh! (R.Marku)

Avenjuja e Pestë shkëlqente në diell kur ata dolën nga Brevoort dhe filluan të ecnin drejt Washington Squar-it. Dielli ishte i ngrohtë, edhe pse ishte Nëntor, dhe gjithçka dukej si mëngjes i së dielës - autobusët dhe njerëzit e veshur mirë që ecnin ngadalë në çifte dhe ndërtesat e qeta me dritaret e mbyllura.

Majkëll e mbante krahun e Frensis fort, ndërsa ecnin drejt Washington Square në dritën e diellit. Ecnin lehtë, pothuajse duke buzëqeshur, sepse kishin fjetur gjatë dhe kishin ngrënë një mëngjes të mirë, dhe ishte e diel. Majkëll e çkopsiti pallton dhe e la të valëvitej rreth vetes në erën e butë. Ecnin pa folur, mes njerëzve të pashëm e të rinj, të tillë që dukeshin se përbënin pjesën më të madhe të kësaj qosheje të New Yorkut.

"Kqyr rrugën," tha Frensis teksa po kalonin Avenjunë e Tetë. "Do të thyesh qafën." Majkëll qeshi dhe Frensis qeshi me të.

"Nuk është edhe aq e bukur," tha Frensis. "Sidoqoftë, jo aq e bukur sa për të rrezikuar të thyesh qafën."

Majkëll qeshi përsëri. "Si e kuptove që po e shikoja?"

Frensis e anoi kokën në njërën anë dhe i buzëqeshi burrit të saj që poshtë strehës se kapelës. "Majk, i dashur," tha ajo.

"O.K.," tha ai. "Më fal."

Frensis ia përkëdheli lehtë krahun dhe e tërhoqi pak më shpejt drejt Washington Square.

"Të mos takojmë asnjëri sot," tha Frensis. "Thjesht të rrimë bashkë. Ti dhe unë. Gjithmonë jemi deri në fyt me njerëz, duke pirë uiskin e tyre ose tonin; ne e shohim njëri-tjetrin vetëm në shtrat...

-Vendi më i madh i takimit-tha Majkëll-mjafton të rrish paksa më gjatë në shtrat, dhe çdokush që të njeh do të shfaqej në atë vënd

- Ta pret mëndja!-tha Frensis- Po flas seriozisht

-Atëherë po të dëgjoj seriozisht!

- Dua të dal gjithë ditën me burrin tim. Dua që ai të flasë vetëm me mua dhe të më dëgjojë vetëm mua."

"Kush na pengon?" pyeti Majkëll.- kush janë ata që do të më pengonin të rri me gruan time vetëm për vetëm në Ditën e Djelë? Kush janë ata njerëz?

"Stivensonët. Duan që ne të kalojmë rreth orës një dhe do të na çojnë me makinë në fshat."

"Stivensonët leshko," tha Majkell. "Të tejdukshmit. Dijnë të fishkëllojnë. Mund të shkojnë vetë për shetitje në fshat. Gruaja ime dhe unë do qëndrojmë kokë më kokë në Njy York derisa ta mërzitim njëri-tjetrin.

"Marrëveshje?"

"Marrëveshje."

Frensis u përkul dhe e puthi në anë të veshit.

"E dashur," tha Majkëll, "kjo është Avenjuja e Pestë."

"Lërmë të bëj një program," tha Frensis. "Një e Dielë e planifikuar në Nju Jork për një çift të ri që kanë para për të shpenzuar."

"Merre ngadalë!."

"Fillimisht të shkojmë në Muzeun Metropolitan të Artit," sugjeroi Frensis, sepse Majkëll i kishte thënë gjatë javës se donte të shkonte atje. "Nuk kam qenë atje prej tre vitesh dhe ka të paktën dhjetë filma që dua t'i shoh përsëri. Pastaj mund të marrim autobusin për në Radio City, dhe të shikojmë ata që patinojnë. Dhe më vonë do të shkojmë tek Kavanagët dhe do të hamë një biftek sa përparësja e një farkëtari, me një shishe verë, dhe pas kësaj është një film francez në Filmarte për të cilin flasin të gjithë hej, më dëgjon, apo jo?"

"Po," tha ai. Ia hoqi sytë vajzës pa kapele me flokë të errët të një valltareje, prerë si një helmetë, e cila po kalonte pranë tij.

"Ky është programi i ditës," tha Frensis ftohtë. "Apo ndoshta doje vetëm të ecje lart e poshtë në Avenjun e Pestë?."

"Jo," tha Majkëll. "Aspak."

"Ti gjithmonë i shikon femrat e tjera," tha Frensis. "Kudo. Në çdo vend ku shkojmë."

"Jo, e dashur," tha Majkëll, "unë shikoj gjithçka. Zoti m'i dha sytë dhe unë shikoj gra dhe burra në metro, në filma dhe shoh dhe lulet e vogla të fushës. Unë inspektoj rastësisht Universin."

"Duhet ta shihje vështrimin në sytë e tu," tha Frensis, "kur inspektoje rastësisht Universin në Avenjun e Pestë."

"Unë jam një burrë i lumtur në martesë." Majkëll ia shtrëngoi bërrylin me butësi. "Shembull për gjithë shekullin e njëzet - zoti dhe zonja Majk Loomis. Ej, të pimë nga një gotë," tha ai, duke ndaluar.

"Ne sapo hëngrëm mëngjes."

"Tani dëgjo, e dashur," tha Majk, duke zgjedhur fjalët me kujdes, "është një ditë e bukur dhe të dy ndiheshim mirë dhe s'ka arsye pse duhet ta prishim. Të kalojmë një të diel të këndshme."

"Mirë. Nuk e di pse e nisa këtë. Ta lëmë. Ta kalojmë mirë."

Ata u kapën dorë për dore me vetëdije dhe ecën pa folur mes karrocave të foshnjave dhe burrave të vjetër italianë me rrobat e së dielës dhe grave të reja me qen të racës Skoc në Parkun e Washington Square.

"Të paktën një herë në vit secili duhet të shkojë në Muzeun Metropolitan të Artit," tha Frensis pas pak, me një ton që imitonte mirë tonin që kishte përdorur gjatë mëngjesit dhe në fillim të shëtitjes. "Dhe është bukur të dielave. Ka plot njerëz që shikojnë piktura dhe kjo të jep ndjesinë se ndoshta Arti nuk është në rënie në New York City, megjithatë."

"Do të të them diçka," tha Majkëll shumë seriozisht. "Nuk kam prekur asnjë grua tjetër. Asnjëherë. Gjatë këtyre pesë viteve."

"Mirë," tha Frensis.

"E beson këtë, apo jo?"

"Mirë."

Ata ecën mes stolave të mbushura, nën pemët e rralla të parkut të qytetit.

"Përpiqem të mos e vë re," tha Frensis, "por më shtrëngon diçka brenda, në stomak, kur kalojmë pranë një gruaje dhe ti e shikon dhe unë e shoh atë vështrim në sytë e tu, dhe është i njëjti vështrim që pate kur më pe mua për herë të parë. Në shtëpinë e Alice Maxwell. Aty në dhomën e ndenjjes, pranë radios, me një kapele të gjelbër dhe me gjithë ata njerëz."

"E mbaj mend kapelen," tha Majkëll.

"I njëjti vështrim," tha Frensis. "Dhe kjo më bën të ndihem keq. Më bën të ndihem në mënyrë të tmerrshme."

"Sh-h-h, të lutem, e dashur, sh-h-h."

"Mendoj se tani do të doja një pije," tha Frensis.

Ata u drejtuan drejtë një bari në Avenjunë e Tetë, pa thënë asgjë, me Majkëll që instinktivisht e ndihmonte të kalonte bordurat dhe e drejtonte t'i shmangej makinave. U ulën pranë një dritareje në bar dhe dielli hynte brenda, ndërsa në oxhak digjej një zjarr i vogël dhe i gëzueshëm. Një kamarier japonez, shtatvogël erdhi, vendosi disa pasta dhe u buzëqeshi me kënaqësi.

"Çfarë pihet pas mëngjesit?" pyeti Majkëll.

"Konjak, ndoshta," tha Frensis.

"Courvoisier," i tha Majkëll kamarierit. "Dy Courvoisier."

Kamarieri solli gotat dhe ata filluan të pinin konjakun nën dritën e diellit. Majkëll e

piu gjysmën e tij dhe pastaj piu pak ujë.

"Unë i shikoj gratë," tha ai. "Saktë. Nuk them që është e gabuar apo e drejtë. I shikoj. Nëse kaloj pranë tyre në rrugë dhe nuk do t'i shikoja, atëherë do të mashtroja ty, dhe do mashtroja dhe veten time."

"Ti i shikon sikur i dëshiron," tha Frensis, duke luajtur me gotën e konjakut. "Çdo njërën prej tyre."

"Deri diku," tha Majk, duke, duke folur me zë të ulët dhe jo drejtpërdrejt me gruan e tij, "është e vërtetë. Nuk bëj asgjë për këtë, por është e vërtetë."

"E di. Prandaj ndjehem keq."

"Një konjak tjetër," thirri Majkëll. "Kamarier, dy konjakë të tjerë."

Ai psherëtiu, mbylli sytë dhe i fërkoi butë me majat e gishtave. "E dua mënyrën si duken gratë. Një nga gjërat që më pëlqen më shumë te Nju Jorku janë batalionet e grave. Kur erdha për herë të parë në Nju Jork nga Ohio, ishte gjëja e parë që vura re, miliona gra teper të bukura, gjithandej në qytet. Ecja përqark i mrekulluar."

"Fëmijë," tha Frensis. "Është ndjenja e një fëmije."

"Mendo edhe një herë," tha Majkëll. "Mendo edhe një herë. Tani jam më i madh. Jam një burrë që po i afrohet moshës së mesme, me pak dhjamë në trup, dhe përsëri më pëlqen të eci përgjatë Avenjus së Pestë në orën tre pasdite në anën lindore të rrugës, mes Rrugës Pesëdhjetë dhe Pesëdhjetë e Shtatë. Të gjitha dalin atëherë, për të bërë pazare, me palltot prej peliçeje dhe kapelat e tyre të çuditshme, gjithçka e përqendruar nga e gjithë bota në shtatë blloqe - peliçet më të mira, rrobat më të mira, gratë më të bukura, që dalin për të shpenzuar para dhe ndihen mirë për këtë."

Kamarieri japonez solli dy pijet, duke buzëqeshur me një gëzim të madh.

"Gjithçka në rregull?" pyeti ai.

"Gjithçka është e mrekullueshme," tha Majkëll.

"Nëse është thjesht puna për disa peliçe," tha Frensis, "dhe kapela prej dyzet e pesë dollarësh."

"Nuk janë peliçet. Apo kapelat. Ato janë thjesht peizazhi për ato lloje të veçantë grash. Kuptoje," tha ai, "nuk ke pse të më dëgjosh."

"Dua të të dëgjoj."

"Më pëlqejnë vajzat nëpër zyra. Të rregullta, me syzet e tyre, të zgjuara, të gjalla, që dinë gjithçka. Më pëlqejnë vajzat në Rrugën Dyzet e Katër në kohën e drekës, aktoret, të veshura në menyren me te thjeshtë, që jetojnë me fare pak pará në javë. Më pëlqejnë shitëset në dyqane, që të kushtojnë vëmendje ty të parit vetëm sepse je burrë, duke i lënë klientet femra të presin. Kam gjithë këto gjëra të grumbulluar brenda meje, sepse..."

"Kam dhjetë vjet që mendoj për këtë dhe tani që ti e kërkove, ja ku është."

"Vazhdo," tha Frensis.

"Kur mendoj për qytetin e Nju Jorkut, mendoj për të gjitha vajzat që parakalojnë nëpër qytet. Nuk e di nëse është diçka e veçantë me mua apo nëse çdo burrë në qytet ecën me të njëjtën ndjesi brenda vetes, por unë ndjehem sikur jam në një piknik në këtë qytet. Më pëlqen të ulem pranë grave në teatro, bukuroshet e famshme që kanë kaluar gjashtë orë duke u bërë gati që si e si te duken si të tilla. Edhe vajzat e reja në ndeshjet e futbollit, me faqet e kuqe, dhe kur vjen moti i ngrohtë, vajzat me fustanet e verës." Ai e mbaroi pijen. "Kjo është historia."

Frensis e mbaroi pijen duke gëlltitur dy a tri herë më tepër.

"Ti thua që më do?"

"Të dua."

"Edhe unë jam e bukur," tha Frensis. "Po aq sa çdo njëra prej tyre."

"Je e bukur," tha Majkëll.

"Jam e mirë për ty," tha Frensis, me lutje. "Kam qenë një grua e mirë, një shtëpiake e mirë, një shoqe e mirë. Do të bëja çdo gjë për ty."

"E di," tha Majkëll. Ai zgjati dorën dhe ia kapi të sajën.

"Ti do të doje të ishe i lirë për to," tha Frensis.

"Sh-h-h."

"Thuaje të vërtetën." Ajo tërhoqi dorën nga e tija.

Majkëll goditi lehtë buzën e gotës me gisht.

"Në rregull," tha me butësi. "Ndonjëherë ndjej që do të doja të isha i lirë."

"Mirë," tha Frensis, "kur të thuash ti, mund te jesh i lirë."

"Mos u sill si budallaqe." Majkëll e rrotulloi karrigen pranë saj dhe ia përkëdheli kofshën.

Ajo filloi të qante në heshtje duke mbajtur një shami, e përkulur mjaftueshëm që askush tjetër në bar të mos e vërente.

"Një ditë," tha ajo, duke qarë, "ti do ta bësh tenden."

Majkëll nuk tha asgjë. Ai po shikonte kamarierin që qëronte ngadalë një limon.

"A nuk do ta bësh?" pyeti Frensis ashpër. "Hajde, thuaje. Fol. A nuk do?"

"Ndoshta," tha Majkëll. E tërhoqi përsëri karrigen pas. "Nga e di unë?"

"E di," nguli këmbë Frensis. "A nuk e di?"

"Po," tha Majkëll pas pak, "e di."

Frensis ndaloi së qari. Fshiu hundën dy-tri herë me shami dhe e futi në çantë, dhe fytyra e saj nuk tregonte asgjë për askënd.

"Të paktën më bëj një nder," tha ajo.

"Sigurisht."

"Mos fol më se sa e bukur është kjo apo ajo. Sytë e bukur, gjinjtë e bukur, trupi i hijshëm, zëri i mirë." Ajo e imitoi zërin e tij. "Mbaji për vete. Nuk më intereson."

Majkëll i bëri shenjë kamarierit.

"Do t'i mbaj për vete," tha ai.

Frensis fshiu cepat e syve.

"Një konjak tjetër," i tha kamarierit.

"Dy," tha Majkëll.

"Po zonjë, po zotëri," tha kamarieri, duke u tërhequr mbrapa.

Frensis e vështroi Majkëll-in me qetësi përtej tavolinës.

"Do që t'i telefonoj Stivenson-ëve?" pyeti ajo. "Do të jetë bukur në fshat."

"Sigurisht," tha Majkëll. "Telefonoji."

Ajo u ngrit nga tavolina dhe eci përmes dhomës, drejt telefonit. Majkëll e ndoqi me sy teksa ecte, duke menduar: *sa vajzë e bukur që është, dhe çfarë këmbësh të mrekullueshme që ka.*

Albert Kamy, një klasik i madh, një artist modern

Nga Andre Morua

Nga të gjithë shkrimtarët bashkëkohorë, ai ka ndoshta fatin më të habitshëm letrar. Krejt i ri ende, ai nuk u bë një "sundimtar i mendimeve" (kjo shprehje e bënte të qeshte), por një pasqyrë e gjallë e tërë një brezi. Lexuesit jashtë Francës e pritën me aq mirësi, saqë ai fitoi Çmimin Nobel në një moshë kur të tjerët vetëm ëndërrojnë më kot për çmimin Gonkour.

Më kujtohet që në vitin 1946, kur udhëtova nëpër të dyja Amerikat, të gjithë studentët më pyesnin për Sartrin dhe Kamynë. Po në çfarë baze qëndronte kjo famë botërore? Një roman i shkurtër, "I huaji", drama "Kaligula" dhe disa ese, përfshirë "Mitin e Sizifit". Po ku qëndronte atëherë shkaku i vërtetë? Pikërisht në faktin se Kamy shprehu hamendjet e turbullta të rinisë së kohës së luftës dhe pas luftës.

Albert Kamy lindi në Algjeri. Njeri i diellit dhe i gëzimit, ai u përball që në fëmijëri me varfërinë, dhe në adoleshencë me vetminë. Nga përsiatjet e rinisë së tij lindi "Miti i Sizifit", për Sizifin që ishte dënuar përjetësisht nga perënditë të shtyjë një shkëmb të madh në majë të malit, nga ku ky shkëmb, për shkak të peshës së vet, rrëshqiste sërish poshtë. Ky mit është simboli i jetës njerëzore. Çfarë bëjmë ne në tokë, nëse jo një punë të pashpresë? Kur më në fund, me mund të madh, arrijmë të ngremë gurin në majë, sëmundja apo lufta e rrokullisin sërish në fund, dhe sido që të jetë, jeta përfundon gjithsesi me vdekjen, me një rënie përmbyllëse. Të kuptosh kotësinë e kësaj rendjeje do të thotë të zbulosh absurditetin e fatit njerëzor.

Në këtë botë, ku nuk ka shpresë, nuk ka iluzione, njeriu e ndien veten si "i huaj". Po ku është shpëtimi? Vetëvrasja? Shpresa për të mbijetuar përmes veprave, krijimeve të tij? Jo. Në çastin kur shqiptoj këto fjalë, hija e Kamysë më detyron ta ndiej me gjithë qenien time se jam i shtrënguar mes mureve të absurdit. Po, për çfarë të shkruash? Përse gjithë këto përpjekje të dështëruara, nëse sidoqoftë jam i dënuar të vdes nesër? Për lavdi? Ajo është e dyshimtë, dhe, nëse rastësisht më mbijeton, unë s'do ta di kurrë. Vetë lloji i shoqërisë që mund të tregojë interes për vepra të tilla është kalimtar, do të zhduket, ashtu siç do të zhduket një ditë edhe vetë Toka. Atëherë përse?

Që fëmijë jemi rritur me të ardhmen. "Nesër... Më vonë... Do rritesh dhe do kuptosh." Por nesër – është varri. Një ditë të bukur njeriu e kupton se është mashtruar, dhe indinjata që e pushton në atë çast është vetë absurdi.

Po çfarë na ofron Kamy? Fëmijë i diellit, ai nuk e pranon dështërimin. E ardhmja nuk ekziston? Le të jetë kështu – të shijojmë të tashmen. Të bëhesh sportist apo poet, ose të dyja njëherësh. Ideali i njeriut absurd është kënaqësia e çastit. Sizifi është i vetëdijshëm për fatin e tij të rëndë, dhe në këtë kthjelltësi të vetëdijes qëndron garancia e fitores së tij.

Këtu Kamy bie dakord me Paskalin. Madhështia e njeriut qëndron në dijen se ai është i vdekshëm. Madhështia e Sizifit qëndron në dijen se shkëmbi do të rrokulliset sërish poshtë. Dhe ky vetëdijësim e kthen fatin në një çështje që lidhet me dorën e njeriut, që duhet zgjidhur mes njerëzve.

Duhet imagjinuar se çfarë përshtypjeje bëri mbi të rinjtë francezë një libër i tillë, kur u shfaq në vitin 1942. Asnjëherë më parë bota nuk ishte dukur më absurde. Lufta, pushtimi – që dukeshin si një triumf i qartë i dhunës dhe padrejtësisë – e hodhën poshtë në mënyrën më të egër idenë e një universi të rregulluar racionalisht.

Në fillim të shekullit, Sizifi, pra njeriu, kishte arritur ta ngjiste shkëmbin mjaft lart në të tatëpjetën fatale. Para Luftës së Parë Botërore, sigurisht jo gjithçka ishte e mirë, ende ishte larg përkryerjes, por sidoqoftë, të paktën në Francë, shumëçka ishte përmirësuar. Fjalët "shpresë", "progres" kishin kuptim. Por për katër vjet, gjatë luftës së madhe, guri u rrokullis larg poshtë, dhe Sizifi mori me guxim përsëri mbi vete punën e tij të përjetshme.

Lufta e Dytë Botërore e shkatërroi çdo shpresë. Gjithçka u shtyp nën një shkëmb të rëndë. Sizifi – i varrosur nën rrënoja, i rraskapitur dhe i dështëruar. Dhe pikërisht atëherë u dëgjua një zë i ri që tha: "Po, është e vërtetë; po – bota është absurde; po – nga perënditë nuk ka ç'të pritet. Dhe megjithatë, duhet, duke i parë në sy fatit të pamëshirshëm, ta kuptojmë atë, ta përbuzim dhe, në masën që është në fuqinë tonë njerëzore, ta ndryshojmë."

Është e kuptueshme që këtij zëri iu kushtua vëmendje. Nuk kishte mbetur gjë tjetër, veçse kjo – ose asgjë. Ja një shkrimtar i ri, i cili që në hapat e parë depërtoi në zemrën e botës moderne. Roli i tij, për ta thënë troç, ishte të bënte këtë botë të pranueshme për një riní të dështëruar – pa mohuar në asnjë çast se për dështërimin ekzistonin të gjitha arsyet.

"I huaji" është realizimi jetësor i "Mitit të Sizifit" – një njeri i dënuar me vdekje për një krim absurd dhe i shpëtuar pikërisht nga ajo që e kishte shkatërruar. "Murtaja" luan, për sa i përket ekzistencës kolektive, të njëjtin rol që "I huaji" luan për ekzistencën individuale. Ashtu si Merso zbulon bukurinë e jetës përmes një tronditjeje që zgjon në të protestën, edhe një qytet i tërë – Orani – zgjohet në vetëdije kur gjendet i izoluar, i pushtuar nga një murtajë vdekjeprurëse.

Por diptiku i Kamysë ka edhe një pjesë

të dytë: është "Njeriu që kundërshton". "Unë besoj se nuk besoj në asgjë, – thotë Njeriu që kundërshton, – POR nuk mund të dyshoj se protestoj." Njeriu që kundërshton është njeriu që thotë "jo", por ai nuk mund të thotë "jo" ndaj ekzistencës pa thënë një "po" për diçka tjetër. Për çfarë thotë ai "po"?

Përfundimi i librit tingëllon me guxim: Kamy nuk heq dorë nga rebelimi, nuk përbuz veprimin. Por mbi gjithçka ai vë ndjenjën e masës.

"Evropa jonë e copëtuar ka nevojë jo për mungesë tolerance, por për punë dhe mirëkuptim të ndërsjellë."

"Bujaria e vërtetë ndaj së ardhmes qëndron në dhënien e gjithçkaje për të tashmen."

Këtu, sot, menjëherë – ja ku duhet të punohet. Do të jetë e vështirë. Me padrejtësinë nuk mund të mbarohet kurrë, por njeriu gjithmonë do të ngrihet kundër saj. Është Djalli ai që na thotë: Eritis sicut dei ("Do të jeni si perëndi"). Që të jesh njeri sot, duhet të heqësh dorë nga të qenët perëndi.

Kamy nuk i përsërit fjalët e Volterit: "Duhet të kultivojmë kopshtin tonë." Ai, më saktë, propozon – sipas meje – të ndihmojmë të përulurit të kultivojnë kopshtin e tyre.

"Artisti vërtet i angazhuar – është ai që, pa hequr dorë nga beteja, refuzon të rreshtohet në një ushtri të rregullt; dua të them – një snajper i lirë."

Kjo është shfaqja e fundit e Kamysë, dhe nuk duhet harruar se nga të gjithë pjesëmarrësit në luftë, snajperi i lirë është më i pambrojturi.

Kamysë nuk i pëlqente aspak kur e shihnin si predikues morali, qoftë individual apo shoqëror.

"Unë nuk jam një njeri i virtytshëm," - thoshte ai. Dhe besoj se me të vërtetë kishte disa "mëkate". Për fat të mirë. Një artist i madh është para së gjithash një dashnor i jetës.

Kamy kishte shënuar në "Fletoren e tij" katër kushtet e lumturisë, sipas mënyrës se si i kuptonte Edgar Poe:

1. Të jetosh në natyrë;
2. Të jesh i dashur;
3. Të heqësh dorë nga ambiciet madhore;
4. Të krijosh.

Një program i mirë – dhe, sipas meje, Kamy e ndoqi atë.

E nderuan dhe e qortuan.

"Po filloj të çlirohem nga ndjeshmëria ndaj gjykimeve që të tjerët kanë për mua," – shkruante në "Fletoret".

Trashëgimia krijuese e Kamysë është e habitshme për koherencën dhe pastërtinë e saj formale. Ai ishte një klasik i madh dhe njëkohësisht një artist modern, i lidhur ngushtësisht me kohën e vet.

Dhe mbetet një shembull i shkrimtarit që nuk u dorëzua kurrë.

Përktheu: B. Hudhri

Tetë arsye për të (ri)lexuar "Lehtësia e padurueshme e qenies" nga Milan Kundera

nga Gloria Maria Ghioni

(Marrë nga IlLibraio.it)

"Lehtësia e padurueshme e qenies", një shitës i gjatë nga Milan Kundera i shkruar në vitin 1982 dhe botuar për herë të parë në Francë dy vjet më vonë, këtë herë duket se ka pushtuar edhe audiencën e #BookTok. Këtu janë një numër arsyesh për të (ri)zbuluar këtë roman, që tani konsiderohet një klasik i letërsisë

Këtu janë tetë arsye për të (ri)zbuluar këtë roman, të cilin tani mund ta konsiderojmë një klasik të letërsisë.

1.Do t'i bëni vetes shumë pyetje gjatë dhe pas leximit

Tashmë nga titulli dhe faqet e para, Lehtësia e padurueshme e qenies ka një bukuri magnetike: janë pyetjet që jehojnë në të, shumë me një sfond filozofik dhe ekzistencial, që na përfshijnë menjëherë. Është nga historia e protagonistëve që ne nxjerrim një mijë pyetje, duke e vënë veten në linjë me siguritë tona dhe duke e lënë narrativën t'i zhbështesë ato ose të paktën t'i vërë në krizë. Dialektika midis rëndësisë dhe lehtësisë hap romanin dhe na bën të pyesim, së bashku me autorin: duke pasur parasysh kalimtësinë dhe papërsëritshmërinë e jetës sonë, "çfarë duhet të zgjedhim, atëherë? Rëndim apo lehtësi"? As rileximi i romanit nuk do të gjejmë një përgjigje, sepse komploti shkakton lojëra të vazhdueshme pasqyrash midis personazheve dhe lexuesve, të destinuara të mos përfundojnë me fundin e librit.

2) Lehtësi apo rëndim në dashuri?

Personazhet kryesore të Lehtësisë së padurueshme të qenies, Tereza dhe Tomáš, përfaqësojnë dy të kundërta që nga fillimi i historisë së tyre të dashurisë: Tomáš, një neurokirurg i njohur, nuk ka ndërmend të lidhet përsëri pas divorcit dhe frekuenton partnerë të panumërt seksualë me "lehtësi"; përkundrazi, Tereza, një kamariere dhe fotografe aspirante, dëshiron një burrë që e kap veçantinë e saj, një partner jete, duke ndjerë "peshën" e kësaj lidhjeje. Po kështu, piktorja Sabina, një artiste e talentuar, mike e sinqertë dhe dashnore e rastësishme e Tomásit, nuk dëshiron një lidhje ekskluzive, por diçka duket se ndryshon tek ajo kur takon Franz, një profesor universiteti, i cili imagjinon jetën e tij me Sabinën, me koston e lënies së gruas dhe fëmijëve. Këto mënyra të ndryshme të të jetuarit të marrëdhënies, në letër të papajtueshme, në vend të kësaj gjejnë kontakte, kompromise, fërkime, distanca, në një dinamikë që nga ana tjetër është plot kontradikta. Dhe, nga ana tjetër, a nuk janë historitë e dashurisë thellësisht komplekse?

3) Një narrator që komenton

E gjithë historia vëzhgohet nga rrëfimtari, i cili përkon me Milan Kundera: është ai që mban fort fijet e një rrëfimi të çrregullt kronologjikisht, i gatshëm të zbulojë ngjarje vendimtare në jetën e personazheve dhe më pas të rifillojë rrëfimin sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Sepse? Sepse historia e katër protagonistëve tani analizohet nën mikroskop, tani lihet të rrjedhë lirshëm, pa ndërhyrje. Të gjitha sipas gjykimit të rrëfimtarit. Refleksionet metanarrative janë të shpeshta dhe shpesh zbulojnë mekanizma të rrëfimit që janë themelorë për të parashikuar kryqëzimet e ardhshme të romanit ose për të kuptuar idenë e autorit për letërsinë. Për shembull, në kapitullin e pesëmbëdhjetë të pjesës së pestë lexojmë: "Personazhet në romanin tim janë mundësitë e mia që nuk janë realizuar. Kjo është arsyeja pse i dua të gjithë në të njëjtën mënyrë dhe të gjithë në të njëjtën mënyrë më frikësojnë: secili prej tyre e ka kaluar një kufi që unë vetëm e kam anashkaluar". Nëse nga njëra anë është Kundera ai që na udhëheq nëpër histori, nga ana tjetër zëri i tij ndërhyn vetëm aty ku është e nevojshme, për të na kujtuar të mbajmë zgjuar vëmendjen tonë kritike.

4) Sharmi i joshjes

Tomáš dhe Sabina shpesh preken nga pasioni erotik: pavarësisht ndjenjave që kanë për partnerët e tyre të jetës, serialiteti duket themelor për ekuilibrin e tyre. Edhe qoftë vetëm për të toleruar të qenit në çift. Dhe kështu fjala "tradhti" risemantizohet, për ta humbet dënimin e saj etik "të rëndë" dhe përfaqëson mënyrën e vetme për të ndjekur "lehtësinë e qenies". Në vend të kësaj, me një ndjenjë të thellë faji Tereza mendon për tradhtinë, sepse ajo ka qenë e qartë që në fillim të historisë së saj me Tomáš se nuk dëshiron të jetë "një nga shumë". Cilado qoftë pika fillestare e personazheve të ndryshëm, është në seks që krijohen ura ose grumbullohen përvoja të pakomunikueshmërisë: Kundera duhet vetëm të ndryshojë këndvështrimin për të na bërë të ndiejmë se si i njëjti moment përjetohet dhe interpretohet në mënyra shumë të ndryshme nga dy të dashuruarit. Dhe në roman gjejmë pasazhe të shumta të prerjes së pastër: "Ata të dy shkuan drejt distancave që dëshironin. Ata ishin të dehur nga tradhtia që i liroi. Franz hipi në Sabina dhe tradhtoi gruan e tij, Sabina hipi në Franz dhe tradhtoi Franz."

5) Personazhet që e lënë veten të ndryshojnë nga koha dhe historia

Një aspekt tjetër themelor i romanit Lehtësia e padurueshme e qenies përfaqësohet nga skena politike në Çekosllovakinë e atëhershme të vitit 1968 dhe në vitet në vijim: në Lehtësia e padurueshme e qenies gjejmë një vështrim të zhgënjyer si në Pranverën e Pragës ashtu edhe në pushtimin pasues sovjetik, i cili gjithashtu i dha fund iluzioneve të shumë banorëve të Pragës. Personazhet, të cilët shohin pritshmëritë e tyre për të ardhmen të shemben dhe vënë në dyshim bindjet e tyre politike, duhet të zgjedhin se në cilën anë të jenë, nëse do të largohen nga vendi i tyre apo do të qëndrojnë; nëse të heshtësh dhe të jetosh diku tjetër apo të hapësh gojën dhe të vuash pasojat e zgjedhjes së tij, duke i qëndruar besnik vetes. Katër personazhet në fakt do të marrin rrugë të ndryshme dhe të paparashikueshme, të cilat është mirë të mos i zbulohen.

6) "Pesha" e pasojave

Asgjë dhe askush nuk kalon rastësisht: ashtu si zgjedhjet politike dhe civile çojnë në pasoja që janë veçanërisht të dëmshme për liritë e dikujt, ashtu edhe marrëdhëniet me të tjerët formojnë personazhet. Tomáš dhe Tereza në fillim të tregimit të tyre, në Pragë, janë thellësisht të ndryshëm nga mënyra se si i gjejmë në fshat; njerëzit me të cilët kalojnë kohën e tyre si çift i formojnë ata, shpesh pavarësisht vetes; dhe bashkëjetesa gjithashtu i formëson të dyja duke u përpjekur të parashikojë se çfarë dëshiron tjetri ose si do të reagojë tjetri. Si ata ashtu edhe dy personazhet e tjerë pyesin veten se çfarë kompromisesh janë të gatshëm të bëjnë, për të qenë çift, dhe në fakt do të gjejnë përgjigje të ndryshme.

7) Një lidhje prekëse ndërmjet... qeni dhe pronarët

Krahas historive të dashurisë për të cilat kemi folur, ka një që nuk vihet kurrë në dyshim dhe që, përkundrazi, rritet me kalimin e kohës pa lot: është ndjenja që lidh Terezën dhe Tomásin me qenin e tyre, Karenin. Në veçanti, është gruaja ajo që kujdeset për kafshën, e cila e shoqëron atë në momente të veçanta të historisë së saj me Tomáš, ritmon kohën e ditëve të saj dhe e siguron me pamje adhurimi të thellë. Kujdesi në këmbim të dashurisë së painteresuar dhe besnike: shëmbëlltyrja ekzistenciale e Kareninit nuk është shumë larg asaj të padronëve të saj, por ju do të jeni ata që gradualisht do të zbuloni referenca dhe ushqim për mendim.

8) Një film i mirë i bazuar në libër

Nëse jeni pjesë e grupit të lexuesve që, pas përfundimit të romanit, nuk mund të braktisin personazhet dhe historinë, dijeni se një film me të njëjtin emër me regji të Philip Kaufman u realizua lirisht nga Lehtësia e padurueshme e qenies: është një prodhim amerikan i vitit 1988, i cili ishte i suksesshëm veçanërisht në Evropë dhe mori nominime të shumta për Oscars dhe Golden Globes në 1989. Ndër interpretuesit, përmendim të paktën Daniel Day-Lewis në rolin e Tomáš dhe Juliette Binoche në ato të Terezës. Mbetet pjesërisht mister se sa aktive ishte pjesëmarrja e Milan Kundera: dihet mirë se disa ndërhyrje që devijojnë nga libri janë autorale, por në vende të ndryshme autori ka argumentuar se romanet e tij, sipas mendimit të tij, nuk janë të përshtatshme për t'u transpozuar në ekranin e madh.

© ExLibris



Karikatura nga Arben Meksi